



Abuzimi i Adoleshentëve dhe të Rinjve në Shqipëri

Një analizë e thelluar

Nëntor 2020



ABUZIMI I ADOLESHENTËVE DHE TË RINJVE NË SHQIPËRI

Një analizë e thelluar

Nëntor 2020

Raporti “Abuzimi i adoleshentëve dhe të rinjve në Shqipëri. Një analizë e thelluar” u mbështet nga Zyra e UNFPA-së në Shqipëri në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara “Fund Dhunës ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri”, financuar nga Qeveria Suedeze dhe zbatuar nga UNDP, UN Women dhe UNFPA, në partneritet me Qeverinë Shqiptare dhe u koordinua nga fondacioni Nesmark, një partner zbatues i UNFPA-së. Opinionet, gjetjet dhe pikëpamjet e shprehura në këtë raport janë vetëm të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të UNFPA-së, Agjencive të Kombeve të Bashkuara ose Qeverisë së Suedisë.

Përgatitur nga: Genc Burazeri, Gentiana Qirjako, Irida Agolli, Monika Kocaqi

Kontribuoi: Elsona Agolli, Maaïke van Adrichem, Majlinda Nesturi

@ Fondacioni “Nesmark” dhe zyra e UNFPA-së në Shqipëri
Tiranë, Nëntor 2020

Ndalohet shitja ose përdorimi i këtij raporti për qëllime fitimi.

Citim i sugjeruar: Raporti “Abuzimi i adoleshentëve dhe të rinjve në Shqipëri. Një analizë e thelluar”, mbështetur nga Zyra e UNFPA-së në Shqipëri dhe financuar nga Qeveria e Suedisë. (Nëntor, 2020)

ISBN: 978-9928-290-69-4

Printuar në shtëpinë botuese “Botimet Barleti”

Koordinuar nga:



PËRMBAJTJA

MIRËNJOHJE	5
SHKURTIME	6
I. HYRJE	7
II. QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E RAPORTIT	9
METODOLOGJIA.....	9
III. KUADRI LIGJOR I MBROJTJES DHE RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË SHQIPËRI	11
3.1. KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR.....	11
3.2. KUADRI LIGJOR KOMBËTAR.....	13
3.3. POLITIKAT KRYESORE KOMBËTARE.....	24
3.4. MEKANIZMAT KËSHILLIMORË INSTITUCIONALË PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS.....	25
IV. RISHIKIMI I RAPORTEVE EKZISTUESE	29
V. ANALIZA E THELLUAR (SEKONDARE) E TË DHËNAVE	43
5.1 SJELLJET E SHËNDETSHME TEK FËMIJËT E MOSHËS SHKOLLORE, 2017-18 (HBSC)	43
5.2 PREVALENCA E PËRVOJAVE NEGATIVE GJATË FËMIJËRISË (PNF) NË SHQIPËRI, 2011-12.....	60
5.3 MIRËQENIA DHE SIGURIA E GRAVE, 2018.....	74
5.4 DHUNA NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE NË SHQIPËRI.....	85
REKOMANDIME	97
BIBLIOGRAFIA.....	103

MIRËNJOHJE

Raporti *“Abuzimi i adoleshentëve dhe të rinjve në Shqipëri. Një analizë e thelluar”* u hartua nga katër ekspertë me një përvojë të gjatë në fushën e shëndetit publik dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Prof. Genc Burazeri dhe Prof. Gentiana Qirjako realizuan analizën e thelluar të katër studimeve kombëtare të përfshira në raport; MA. Monika Kocaqi bëri një përmbledhje të bazës ekzistuese ligjore dhe dokumenteve strategjike kombëtare që mbrojnë fëmijët dhe të rinjtë nga të gjitha format e dhunës, ndërsa Prof. Asc. Irida Agolli paraqiti gjetjet kryesore të raporteve të botuara tashmë mbi abuzimin dhe keqtrajtimin e adoleshentëve dhe të rinjve të kryera në Shqipëri gjatë dekadës së fundit.

Autorët e vlerësojnë shumë mbështetjen e dhënë nga INSTAT-i dhe OSBE-ja, që mundësuan kryerjen e analizës së thelluar mbi situatën e abuzimit të adoleshentëve dhe të rinjve duke siguruar akses në bazat e të dhënave të dy studimeve kombëtare, përkatësisht: *“Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri”*, INSTAT 2019 dhe *“Mirëqenia dhe Siguria e Grave”*, OSBE 2019.

Në fund, autorët e këtij raporti dëshirojnë të shprehin mirënjohjen e tyre për Zyrën e UNFPA-së në Shqipëri për mbështetjen teknike dhe financiare, si dhe veçanërisht për Znj. Elsona Agolli, për kontributin e saj në raport, si dhe për komentet e vlefshme.

Nëntor 2020

SHKURTIME

ADHS	Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
AWEN	Rrjeti i Fuqizimit të Gruas Shqiptare
DhNG	Dhuna ndaj Grave
DhNGV	Dhuna ndaj Grave dhe Vajzave
GTN	Grupi Teknik Ndërsektorial
KDF	Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës
KKDMF	Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
HBSC	Sjelljet e Shëndetshme të Fëmijëve të Moshës Shkollore
MPL	Modeli i Përgjithshëm Linear
NJMF	Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OJF	Organizata Joqeveritare
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PMF	Punonjësi i Mbrojtjes së Fëmijës
PNF	Përvojat Negative gjatë Fëmijërisë

I.

HYRJE



Keqtrajtimi i fëmijëve dhe të rinjve vazhdon të jetë një problem shqetësues i shëndetit publik në të gjithë botën, me pasoja jo vetëm shëndetësore, por edhe sociale e financiare. Parandalimi i keqtrajtit të fëmijëve është pjesë e disa agjendave të rëndësishme të politikave në fushën e shëndetit. Kështu, *“Investimi tek Fëmijët: Plani Evropian i Veprimit për Parandalimin e Keqtrajtit të Fëmijëve 2015-2020”* synon të zvogëlojë me 20% keqtrajtimin e fëmijëve në të gjithë rajonin Evropian¹.

Gjithashtu, parandalimi i keqtrajtit të fëmijëve është pjesë e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) përmes disa synimeve që adresojnë dhënien fund të dhunës ndaj fëmijëve (Objektivat 5.2, 5.3, 16.1 dhe 16.2), ndërsa dokumenti *“Shëndeti 2020: kuadri i politikës evropiane për shëndet dhe mirëqenie”*, thekson rëndësinë e përfshirjes së disiplinave të ndryshme (shëndetësia në të gjitha politikat) për parandalimin e dhunës².

Vdekjet përfaqësojnë vetëm një pjesë të vogël të problemit të keqtrajtit të fëmijëve. Çdo vit miliona fëmijë janë viktime të abuzimit jo-fatal dhe neglizhencës. Keqtrajtimi i fëmijëve i referohet keqtrajtit fizik dhe emocional, abuzimit seksual, neglizhencës dhe trajtimit neglizhent të fëmijëve, si dhe shfrytëzimit komercial apo formave të tjera të shfrytëzimit të fëmijëve.

Keqtrajtimi i fëmijëve dhe adoleshentëve është njohur ndërkombëtarisht si një çështje serioze e shëndetit publik, e të drejtave të njeriut, e çështjeve ligjore dhe sociale. Natyra dhe ashpërsia e vetë dhunës dhe pasojat e saj variojnë. Keqtrajtimi i fëmijëve mund të çojë deri në vdekje. Shumica e keqtrajtimeve janë jo vdekjeprurëse dhe mund të shfaqen si dëmtime fizike dhe/ose të ndikojnë në mirëqenien e fëmijës për të sjellë pasoja afatgjata në zhvillimin neurologjik, njohës dhe emocional të fëmijës si dhe në shëndetin e përgjithshëm.

Informacioni në lidhje me madhësinë dhe faktorët përcaktues të abuzimit të fëmijëve dhe adoleshentëve, dhe veçanërisht abuzimit seksual gjatë fëmijërisë në Shqipëri, është i pakët. Pas

- 1 Investing in children: the European child maltreatment prevention action plan 2015–2020. Copenhagen: WHO Regional Office for Europe; 2014 (EUR/RC64/13 + UR/RC64/ Conf.Doc./5; http://www.euro.who.int/_data/assets/pdf_file/0009/253728/64wd13e_InvestChildMaltreat_140439.pdf)
- 2 Health 2020: a European policy framework supporting action across government and society for health and well-being. Copenhagen: WHO Regional Office for Europe; 2012 (<http://www.euro.who.int/en/publications/abstracts/health-2020-a-european-policy-framework-supporting-action-across-government-and-society-for-health-and-well-being>, accessed 18 February 2016).

rënies së regjimit komunist në 1990, Shqipëria ka kaluar një tranzicion të shpejtë politik dhe socio-ekonomik të shoqëruar me një nivel të lartë të lëvizshmërisë sociale, emigracion masiv dhe nivele të larta të papunësisë³. Këto ndryshime socio-ekonomike shoqërohen me rritjen e treguesve jo të shëndetshëm që lidhen me stilin e jetesës/sjelljet të cilat pasqyrohen në një rritje të shprehur të sëmundshmërisë dhe vdekshmërisë nga sëmundjet jo të transmetueshme³.

3 Instituti i Shëndetit Publik. Raport Shëndetësor Kombëtar: Gjendja Shëndetësore e Popullatës Shqiptare. Tiranë, Shqipëri, 2014. <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/01/Health-report-English-version.pdf> (accessed: June 11, 2015).

II.

QËLLIMI DHE METODOLOGJIA E RAPORTIT



Qëllimi i këtij raporti është që të kryejë një analizë të thelluar (sekondare) të bazave ekzistuese të të dhënave, në lidhje me disa studime të rëndësishme që janë kryer në Shqipëri në dekadën e fundit, në mënyrë që të sigurojë informacionin e nevojshëm në lidhje me karakteristikat e abuzimit të adoleshentëve dhe të rinjve me një fokus kryesor në diferencat e mundshme gjinore, ato socio-ekonomike dhe diferencat e tjera të mundshme që lidhen me kategoritë e rrezikuara të popullsisë.

METODOLOGJIA

Metodologjia e këtij raporti përbëhet nga qasjet e mëposhtme:

- **Rishikimi i literaturës:** rishikimi i bazës ekzistuese ligjore dhe dokumenteve strategjike kombëtare që mbrojnë fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë nga të gjitha format e dhunës dhe studimet kryesore sasiore dhe cilësore të kryera në Shqipëri që përshkruajnë situatën e abuzimit të adoleshentëve dhe të rinjve. Për më tepër, ky proces nxori në pah sfidat, pengesat dhe boshllëqet me të cilat përballen institucionet sot në kontekstin e mbrojtjes së adoleshentëve dhe të rinjve nga dhuna dhe abuzimi.
- **Rishikimi i raporteve ekzistuese:** raportet e studimeve ekzistuese u shqyrtuan me hollësi për të përshkruar boshllëqet dhe nevojat për analiza të mëtejshme.
- **Analizë e thelluar (sekondare) e të dhënave:** u përfshinë studimet kryesore kombëtare të kryera në dekadën e kaluar, të cilat ofrojnë informacion mbi situatën e abuzimit të adoleshentëve dhe të rinjve në Shqipëri. Studimet kryesore që kemi përfshirë në analizën sekondare janë:
 - o Sjelljet e Shëndetshme të Fëmijëve të Moshës Shkollore 2017/18 (HBSC)
 - o Studimi mbi Përvojat Negative gjatë Fëmijërisë në Shqipëri 2011-12
 - o Mirëqenia dhe Siguria e Grave, 2018
 - o Dhuna Ndaj Grave dhe Vajzave në Shqipëri, INSTAT 2018

Kjo analizë e thelluar (sekondare) trajtoi kryesisht çështjet e mëposhtme për secilin studim:

- o Vlerësimin e thelluar dhe analizën sekondare të prevalencës dhe shpërndarjes së llojeve të ndryshme të keqtrajtimit të adoleshentëve dhe të rinjve (fizik, emocional, seksual, neglizhencës, bulizmit)

- Vlerësimin e faktorëve kryesorë përcaktues (të pavarur) demografikë dhe socio-ekonomikë të keqtrajtimit të adoleshentëve dhe të rinjve tek fëmijët shqiptarë
- Vlerësimin e lidhjes (shoqërimit) së keqtrajtimit të fëmijëve me karakteristikat socio-demografike dhe socio-ekonomike, dhe faktorët e sjelljes/stilit të jetës
- Vlerësimin e lidhjes (shoqërimit) midis llojeve të ndryshme të keqtrajtimit të adoleshentëve dhe të rinjve (fizik, seksual, emocional, neglizhencës, bulizmit)

Analiza e thelluar mbështetet në një analizë të detajuar statistikore bazuar në bazat përkatëse të të dhënave të studimeve të sipërpërmendura. Për të vlerësuar lidhjen midis karakteristikave të abuzimit të adoleshentëve dhe të rinjve dhe faktorëve demografikë, karakteristikave socio-ekonomike dhe faktorëve përcaktues të tjerë të mundshëm u përdorën disa teknika dhe teste statistikore. Regresioni logjistik binar ishte teknika/testi kryesor statistikor i përdorur për vlerësimin e faktorëve përcaktues të pavarur të karakteristikave të llojeve të ndryshme të abuzimit të adoleshentëve dhe të rinjve.

III.

KUADRI LIGJOR I MBROJTJES DHE RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE TË FËMIJËVE NË SHQIPËRI



Njohja, respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve është listuar ndër veprimet prioritare të Qeverisë së Shqipërisë prej vitesh tashmë, falë edhe punës së jashtëzakoshme të organizatave të shoqërisë civile të fokusuara në këtë drejtim. Kuadri ligjor i mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve, ka ardhur duke u përmirësuar ndjeshëm vitet e fundit. Edhe në fushën e politikave dhe institucioneve zbatuese të tyre, vihen re përmirësime.

Por, zbatimi në praktikë i kuadrit ligjor dhe atij të politikave mbetet ende një sfidë, sidomos kur bëhet fjalë për mbrojtjen e fëmijëve, vajza e djem nga dhuna dhe abuzimi. Vetëm gjatë vitit 2020 jemi përballur me denoncimet mediatike të jo pak rasteve të dhunës ndaj fëmijëve në kopshte, shkolla e familje, sidomos të dhunës seksuale të ushtruar kryesisht ndaj fëmijëve vajza, si nga bashkëmoshatarët e tyre ashtu edhe nga të rriturit, përfshirë edhe raste të abuzimit seksual të vajzave të mitura, në marrëdhëniet familjare. Akoma dhe më i vështirë është ofrimi i shërbimeve mbështetëse të specializuara për fëmijët vajza dhe djem të dhunuar, sidomos në rastin e dhunës seksuale. Shërbimet ekzistuese nuk janë të shtrira dhe nuk kanë kapacitet të mbulojnë mbarë territorin e vendit, jo gjithmonë kanë profesionistët e duhur për këtë qëllim, nuk financohen mjaftueshëm, jo gjithmonë funksionojnë duke respektuar standardet e duhura, etj...

Nëse i kthehemi këndvështrimit juridik të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve në Shqipëri, vlen të theksojmë se kuadri ligjor ekzistues përmban instrumente ndërkombëtarë të ratifikuar dhe një tërësi ligjesh të brendshme të përditësuar e përfaruar me këtë kuadër ndërkombëtar.

3.1. KUADRI LIGJOR NDËRKOMBËTAR

Në mënyrën e organizimit të sistemit ligjor në Shqipëri, konventat e ratifikuara nga vendi ynë, quhen pjesë e legjislationit të brendshëm dhe janë të detyrueshme për zbatim. Ato qëndrojnë mbi Kodet dhe ligjet e vendit. Shqipëria ka nënshkruar dhe ratifikuar një sërë konventash dhe instrumentesh ndërkombëtarë të fokusuar në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, ku ndër më të rëndësishmet për mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe abuzimi, përmendim:

a) Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (KDF, 1989)⁴, e cila ndër të tjera përcakton të drejtat bazë civile, politike, sociale, ekonomike dhe kulturore të fëmijëve. E ngritur mbi katër parime bazë (mosdiskriminimi, interesin më të lartë të fëmijës, të drejtën për mbijetesë dhe zhvillim, si dhe pjesëmarrjen e fëmijëve), KDF-ja përmban disa nene që i dedikohen mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna dhe keqtrajtimi, përfshirë edhe mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e shfrytëzimit, të tilla si:

- **Neni 19, Paragrafi 1:** *“Shtetet Palë marrin të gjitha masat legislative, administrative, shoqërore dhe edukative për mbrojtjen e fëmijës nga çdo formë e dhunës fizike ose mendore, fyerja ose keqtrajtimi, braktisja apo mospërfillja, nëpërkëmbja ose shfrytëzimi, përfshirë abuzimin seksual, për sa kohë që ai është nën ruajtjen e prindërve të tij ose të njërit prej tyre, të përfaqësuesit ose përfaqësuesve të tij ligjorë ose të çdo personi tjetër të cilit i është besuar.”* Neni 19, gjithashtu përcakton se masat e mbrojtjes, të propozuara në paragrafin 1 më sipër, përfshijnë ndër të tjera edhe *“procedura të efektshme për hartimin e programeve shoqërore për përkrahjen e nevojshme të fëmijës dhe atyre që kujdesen për të, si dhe për forma të tjera parandalimi dhe identifikimi, raportimi, referimi, hetimi, trajtimi dhe ndjekjeje të rasteve të keqtrajtimit të fëmijës, të përshkruara më lart, duke përfshirë, nëse duhet, procedurat e ndërhyrjes gjyqësore.”*
- **Neni 34:** *“Shtetet Palë marrin përsipër të mbrojnë fëmijën nga çdo lloj forme e shfrytëzimit seksual dhe keqtrajtimit seksual. Për këtë qëllim, Shtetet Palë marrin në mënyrë të veçantë të gjitha masat e duhura në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh për të mos lejuar që: (a) Fëmijët të nxiten ose të detyrohen për t’u përfshirë në veprimtari të paligjshme seksuale; (b) Fëmijët të shfrytëzohen për qëllime prostitucioni ose praktika të tjera seksuale të paligjshme; (c) Fëmijët të shfrytëzohen për shfaqje ose materiale pornografike”.*
- **Neni 35:** *“Shtetet Palë marrin të gjitha masat e nevojshme në planin kombëtar, dypalësh dhe shumëpalësh, për të mos lejuar rrëmbimin, shitjen, ose trafikun e fëmijëve për çdo qëllim dhe në çfarëdo forme qoftë”.*
- **Neni 36:** *“Shtetet Palë mbrojnë fëmijën nga çdo formë tjetër shfrytëzimi, që dëmton në çfarëdo aspekti mirëqënien e tij.”, etj...*

Shqipëria gjithashtu ka nënshkruar dhe ratifikuar protokollet shtesë të kësaj Konvente, ku me rëndësi për t’u përmendur për abuzimin e fëmijëve është **Protokolli shtesë “Mbi shitjen e Fëmijëve, Prostitucionin me Fëmijë dhe Pornografinë”**⁵.

b) Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimi Seksual (Konventa e Lanzarotit, 2007)⁶, që përcakton masa për parandalimin, zbulimin, hetimin dhe

4 Ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me Ligjin Nr.7531, datë 11.12.1991 “Për Ratifikimin e Konventës për të Drejtat e Fëmijës”. <https://www.unicef.org/montenegro/media/9291/file/MNE-media-MNEpublication505.pdf>

5 Miratuar me Ligjin Nr.9834, datë 22.11.2007. http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2016/10/Protokolli-opsional-i-Konvetes-per-te-Drejtat-e-Femijeve-ne-lidhje-me-Shitjen-e-femijeveprostitucionin-me-femije-dhe-pornografine_me_femije1.pdf

6 Ratifikuar me Ligjin Nr. 10071, datë 09.02.2009. <https://rm.coe.int/168046e1e3>

ndëshkimin e të gjitha formave të shfrytëzimit dhe abuzimit seksual të fëmijëve, si dhe mbrojtjen dhe rehabilitimin e fëmijëve viktime të abuzimit dhe shfrytëzimit seksual.

Shqipëria është gjithashtu aderuese dhe nënshkruese e një sërë instrumentesh të tjera ndërkombëtare, si: Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ)⁷, Konventa për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW, 1981)⁸, Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim⁹; Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe dy protokollet shtesë të saj, “Protokolli kundër trafikut të migrantëve me rrugë tokësore, ajrore dhe detare” dhe “Protokolli për parandalimin, pengimin dhe ndëshkimin e trafikut të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve”¹⁰, Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit, 2011)¹¹, etj.

3.2. KUADRI LIGJOR KOMBËTAR

Në vijim të detyrimeve ligjore si shtet nënshkrues i Konventave Ndërkombëtare, dhe në funksion të rregullimit të bazës ligjore, identifikimit, garantimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, Shqipëria ka ndër marrë hapa seriozë në krijimin dhe plotësimin e kuadrit ligjor përkatës. Fryma ligjore dhe qasja juridike kundrejt temës kaq delikate të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve shfaqen që në parimet e ndërtimit të ligjit themeltar të Republikës së Shqipërisë.

a) Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë¹². Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ka një gjuhë neutrale (përfshirë edhe këndvështrimin gjinor¹³), interpretuar kjo si përdorim i qëllimshëm për të nënkuptuar që, të gjithë shtetasit dhe shtetasit shqiptarë, pavarësisht gjinisë, moshës e çfarëdo karakteristike tjetër individuale, gëzojnë të njëjtat të drejta të barabarta. Fëmijët përmenden në Nenet 15 dhe 59 të Kushtetutës, por në mënyrë specifike, lidhur me abuzimin, ka një parashikim në **Nenin 54**: “... 3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën a zhvillimin e tij/saj normal”.

Në të gjitha parashikimet në nenet e sipërcituara del qartë rëndësia dhe qasja për trajtimin që marrin fëmijët në kuptimin ligjor, si subjekte të cilët gëzojnë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. Po kështu, vihet re qëllimi i ligjit themeltar, për të formalizuar dhe vendosur theksin tek

7 Ratifikuar me Ligjin Nr. 8137, datë. 31.07.1996 https://observator.org.al/wp-content/uploads/2015/09/Konventa_Europiane_per_te_Drejtat_e_Njeriut.pdf

8 Ratifikuar në 1993, së bashku me protokollin shtesë të saj ratifikuar në vitin 2003. <https://hrrp.eu/alb/docs/CEDAW-a.pdf>

9 https://www.crca.al/sites/default/files/publications/3.2.1.8.Deklarata_dhe_Platforma_pr_Veprim_e_Pekinit.pdf

10 Ratifikuar me Ligjin Nr. 8920, datë 11.07.2002 http://www.pp.gov.al/web/konventa_e_kombeve_te_bashkuara_kunder_krimet_te_organizuar_nderkombetar_774.pdf

11 Ratifikuar më 04.02.2013. <https://rm.coe.int/168046246b>

12 <https://www.osce.org/files/f/documents/e/0/41889.pdf>

13 Duhet theksuar që gjuha neutrale dhe gati e verbër gjinore përshkon pothuajse të gjithë dokumentet ligjore dhe të politikave në vend dhe është një aspekt që kërkon vëmendje dhe përmirësim

mbrojtja e veçantë që gëzojnë ligjërisht subjekte të caktuara të së drejtës, që në kuptimin social e civil janë subjekte më të brishta se të tjerët. Fëmijëve u është rezervuar një vend i veçantë në tërësinë e instituteve ligjore që kanë për qëllim normimin, identifikimin, garantimin dhe respektimin, e të drejtave juridiko-civile, për sa kohë që qëllimi më i lartë i legjislacionit shqiptar është mbrojtja e të drejtave të fëmijëve dhe familjes.

b) Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar¹⁴, në seksionin IX të tij, ka të parashikuara veprat penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes. Megjithatë, në Kodin Penal nuk ka një parashikim të qartë të moshës se deri kur një person quhet fëmijë, sikundër e gjejmë të përcaktuar në Ligjin Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, në Nenin 3, Pika 4, ku “Fëmijë” është çdo person nën moshën 18 vjeç.”¹⁵. Në Nenin 12 “Mosha për përgjegjësi penale” në Kodin Penal, parashikohen se: “Ka përgjegjësi penale personi që në kohën e kryerjes së një krimi ka mbushur moshën katërmëdhjetë vjeç. Personi që kryen një kundërvajtje penale ka përgjegjësi kur ka mbushur moshën gjashtëmbëdhjetë vjeç”.

Në funksion të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve janë parashikuar një tërësi veprash penale, por lidhur me abuzimin e fëmijëve, përmendim:

- **Neni 124/b “Keqtrajtimi i të miturit”:** *Keqtrajtimi fizik ose psikologjik i të miturit nga prindërit, motra, vëllai, gjyshi, gjyshja, kujdestari ligjor ose çdo person që është i detyruar të kujdeset për të, dënohet me burgim nga tre muaj gjer në dy vjet. Detyrimi, shfrytëzimi, shtytja ose përdorimi i të miturit për të punuar, për të siguruar të ardhura, për të lypur apo për të kryer veprime që dëmtojnë zhvillimin e tij mendor dhe/ose fizik, apo arsimimin e tij/saj, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Kur nga vepra është shkaktuar dëmtimi i rëndë i shëndetit ose vdekja e të miturit, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.*
- **Neni 128/b “Trafikimi i të miturve”:** *Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasojë të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm. Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimit me burgim i shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.*

14 Ndryshuar në vitet 2012, 2013, 2017 dhe së fundmi me Ligjin Nr. 35/2020. http://www.pp.gov.al/web/kodi_penal_2017_1200.pdf

15 https://observer.org.al/wp-content/uploads/2017/06/Layout-A5_shqip_fin_11Maj2017.pdf

Me ndryshimet ligjore që janë kryer në nenin 130/a të Kodit Penal, në vitin 2013 dhe në vitin 2020, përse i takon dhunës në familje, vihet re se dënimet ndaj këtyre veprave rëndohen në rast se kryhen në mënyrë të përsëritur ose në praninë e fëmijëve.

- **Neni 130/a “Dhuna në familje”:** *Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune fizike, psikologjike, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjuhërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim deri në tre vjet. Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjuhërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, me pasojë cenimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim deri në katër vjet. Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt (të paralindur, të paslindur, vëllezër, motra, ungjër, emta, nipër, mbesa, fëmijë të vëllezërve dhe të motrave), ose krushqi e afërt (vjuhërr, vjuhërrë, dhëndër, nuse, kunat/ë, thjeshtri, thjeshtra, njerku e njerka), ose në lidhje apo ish-lidhje intime me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paafësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim deri në pesë vjet. Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet burgim.”.*

Një nga aspektet më të rëndësishme në funksion të mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të fëmijëve janë edhe parashikimet ligjore në fushën krimeve seksuale. Në seksionin VI, të Kodit Penal, kapitulli Krime Seksuale, evidentojmë:

- **Neni 100 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me të mitur”:** *Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale me fëmijë të mitur, që nuk ka arritur moshën katërmbëdhjetë vjeç ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose me dhunë, ose kur i janë shkaktuar fëmijës së dëmtuar pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se njëzet e pesë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.*
- **Neni 101 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës 14-18 vjeç”:** *Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale, me dhunë, me fëmijë të mitur në moshën katërmbëdhjetë gjer në tetëmbëdhjetë vjeç dhe që ka arritur pjekurinë seksuale, dënohet me burgim nga pesë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Kur marrëdhënia seksuale ose homoseksuale, me dhunë, kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose kur fëmijës së dëmtuar i shkaktohen pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim*

nga dhjetë gjer në njëzet vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen ose vetëvrasjen e fëmijës së mitur dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet.

Në sa më sipër, vërejmë se: së pari, përcaktimi në Nenin 100 “ose me të miturën që nuk ka arritur pjekurinë seksuale” le jashtë të miturin që nuk e ka arritur pjekurinë seksuale dhe mund të krijojë hapësirë për dallime gjinore në mbrojtjen që u ofrohet fëmijëve djem e vajza; së dyti, dallimi që bëhet duke specifikuar “marrëdhënie seksuale” ose “homoseksuale” ndërkohë që masa e dënimit është e njëjtë për të dy veprat, është një dallim i panevojshëm, i cili madje mund të përforcojë stereotipet, paragjykimet dhe stigmatizimin e një grupi fëmijësh.

Një hapësirë e veçantë i është kushtuar edhe marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale nga personat në rrethin e ngushtë familjar ose kujdestar të të miturve.

- **Neni 106 “Marrëdhënie seksuale ose homoseksuale me persona në gjini ose nën kujdestari”:** *Kryerja e marrëdhënieve seksuale ose homoseksuale ndërmjet prindit dhe fëmijës, vëllait dhe motrës, ndërmjet vëllezërve, motrave, ndërmjet personave të tjerë që janë gjini në vijë të drejtë ose me persona që ndodhen në raporte kujdestarie ose të birësismit, dënohet me burgim gjer në shtatë vjet.*

Dhuna seksuale, ngacmimi seksual ose vepra të cilësuar të turpshme, kur këto ushtrohen mbi të mitur/mitura, trajtohet në mënyrë të veçantë në brendësi të neneve dhe legjislacionit penal shqiptar. Identifikimi i të miturve/mituravë, nën moshën katërbëdhjetë vjeç ose/dhe deri në tetëmbëdhjetë vjeç, në nenet e këtij lloji, tregon qartazi identifikimin e fëmijëve, si grup subjekti personash të cilët gëzojnë mbrojtje të veçantë nga shteti. Kështu evidentojmë:

- **Neni 107/a, “Dhuna seksuale”:** *Ushtrimi i dhunës seksuale, nëpërmjet kryerjes së veprimeve me natyrë seksuale në trupin e një personi tjetër me objekte, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, në kundërshtim të disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve të moshës katërbëdhjetë deri në tetëmbëdhjetë vjeç dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo një të mituri që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, pavarësisht nëse kryhet me dhunë apo jo, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet.*
- **Neni 108 “Vepra të turpshme”:** *Kryerja e veprave të turpshme me të mitur që nuk kanë arritur moshën katërbëdhjetë vjeç, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet ndaj një të mituri që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç, me të cilin autori ka marrëdhënie familjare, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet. Përfshirja e qëllimshme si dëshmitar, në veprime me natyrë seksuale, e një të mituri/miture që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo i një të mituri/miture që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Propozimi i bërë nga një i rritur, me çdo mjet ose formë, për të takuar një të mitur që nuk ka arritur moshën katërbëdhjetë vjeç apo një të mitur që nuk ka arritur pjekurinë seksuale, me qëllim kryerjen e ndonjëres nga veprat penale të parashikuara në këtë seksion apo në*

seksionin VIII të kreut II të këtij Kodi, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

- **Neni 108/a “Ngacmimi seksual”:** *Kryerja e sjelljeve me natyrë seksuale, që çënojnë dinjitetin e një personi, me çdo mjet ose formë, duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor, degradues, poshtërues ose ofendues, përbën veprë penale dhe dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Kur kjo veprë kryhet në bashkëpunim, kundër disa personave, më shumë se një herë, ose kundër fëmijëve, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet.*

Gjithashtu parashikime të tjera të rëndësishme në lidhje me fëmijët vërejmë edhe në nenet në vijim:

- **Neni 114 “Shfrytëzimi i prostitucionit”:** *Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Po kjo veprë, kur kryhet me të mitur, ndaj disa personave, me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie, apo duke përfituar nga raportet zyrtare, ose kryhet në bashkëpunim apo më shumë se një herë, ose nga persona të ngarkuar me funksione shtetërore dhe publike, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.*
- **Neni 117” Pornografia”:** *Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në mjediset ku ka fëmijë, me çdo mjet ose formë, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me burgim deri në dy vjet. Prodhimi, importimi, ofrimi, vënia në dispozicion, shpërndarja, transmetimi, përdorimi ose posedimi i pornografisë së fëmijëve, si dhe krijimi i aksesit në mënyrë të vetëdijshme në të, me çdo mjet ose formë, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Rekrutimi, përdorimi, shtrëngimi, ose bindja e një fëmije, për të marrë pjesë në shfaqje pornografike, ose marrja pjesë në shfaqje pornografike që përfshijnë fëmijët, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet.*

Në sa më sipër gjithashtu duhet të ndalemi në parashikimin e **Nenit 113 mbi “Prostitucionin”**, sipas të cilit: *Ushtrimi i prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet. Dhënia e shpërblimit për përfitim personal të prostitucionit dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.* Fakti që në këtë nen nuk bëhet një parashikim dhe ndarje ndërmjet të miturve/miturave dhe të rriturve/rriturave, mund të çojë deri në rrezikun e ndëshkimit të fëmijëve për veprën penale të ushtrimit të prostitucionit, ndërkohë që në të vërtetë ata shfrytëzohen për prostitucion. Ky rrezik ekziston në fakt edhe kur flitet për të rriturat/rriturit e shfrytëzuar për prostitucion, mungesa e provave të shfrytëzimit të të cilave/cilëve, i vendos ato/ata në pozicionin e ushtrueseve/ushtuesve të prostitucionit, e për rrjedhojë nga viktimat mund të kalojnë në të akuzuara/akuzuar.

Identifikimi i veçantë i fëmijëve si subjekt i mbrojtjes pozitive ligjore vazhdon përgjatë të gjithë neneve të Kodit Penal, si në: veprat penale kundër njerëzimit dhe jetës, veprat penale kundër lirisë së personit, veprat penale kundër moralit dhe dinjitetit, etj.

c) Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur¹⁶, parashikon në mënyrë më të detajuar dhe përputhet me garancitë procedurale që duhet të gëzojë i mituri/e mitura në procesin penal dhe jo vetëm. Në këtë kuadër, për të garantuar një respektim sa më efikas të lirive dhe të drejtave të fëmijëve, ky kod përmban rregullime të posaçme lidhur me përgjegjësinë penale të të miturve/miturave, rregulla procedurale lidhur me hetimin, ndjekjen penale, procesin gjyqësor, ekzekutimin e vendimit të dënimit penal, rehabilitimin ose të çdo mase tjetër që përfshin një të mitur në konflikt me ligjin, si dhe një të mitur viktimë dhe/ose dëshmitar të veprës penale.

Drejtësia penale lidhur me fëmijët nuk duhet të synojë ndëshkueshmërinë, por riintegrimin e tyre dhe parandalimin në mënyrë që të kemi në të ardhmen individë madhorë sa më larg konfliktit me ligjin dhe pjestarë të përgjegjshëm të shoqërisë dhe shtetit shqiptar. Qëllimi i këtij Kodi është të garantojë një kuadër ligjor mbi drejtësinë penale për të mitur/mitura në përputhje me Kushtetutën, Konventën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe standardet e normat e tjera ndërkombëtare që kanë për qëllim mbrojtjen e të miturit/miturës. Gjithashtu, nëpërmjet këtij Kodi, legjislatori, kërkon dhe synon të promovojë riintegrimin e të miturit/miturës në konflikt me ligjin penal dhe që i mituri/e mitura të luajë një rol sa më të dobishëm në shoqëri, rishoqërizimin dhe rehabilitimin e të miturit/miturës që ka kryer veprë penale, si dhe të mbrojë të drejtat e të miturit/miturës në rastet kur është dëshmitar/dëshmitare dhe/ose viktimë e veprës penale, etj.

Si akti i parë që i dedikohet specifikisht raportit të të miturve/miturave me sistemin e drejtësisë penale, një karakteristikë e Kodit është filozofia mbi aplikimin e burgimit, si masa e fundit dhe në një kohë sa më të shkurtër. Në ato raste kur është e mundur, ai duhet të zëvendësohet me kryerjen e shërbimeve të rehabilitimit me bazë komunitare. Përmes kësaj qasjeje, synohet të lehtësohet procesi i riintegrit të të miturit/miturës, duke e zëvendësuar dënimin me edukimin.

Një tjetër zhvillim të konsiderueshëm ka shënuar përfshirja e profesionistëve dhe profesionisteve të specializuara dhe të kualifikuara në menaxhimin e rasteve të të miturve/miturave në konflikt me ligjin. Specializimi i personave të cilët administrojnë dhe asistojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur është një tjetër çështje delikate dhe me ndikim të drejtpërdrejtë jo vetëm te i mituri/e mitura, por edhe për mbarëvajtjen e procesit në tërësi. Për këtë arsye, Kodi parashikon respektimin e disa parametrave, përmes së cilëve diktohet specializimi dhe trajnimi në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve i të gjithë personave që administrojnë procesin e drejtësisë penale për të mitur (shih Kreun IV, Nenin 25 të këtij kodi).

Pjesëmarrja e detyrueshme e psikologut/psikologes, parashikuar në **Nenin 18** të këtij kodi është një garanci më vehte në të gjitha procedurat ligjore ku përfshihet fëmija. Një garanci tjetër e këtij Kodi është edhe shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi i gjykimeve apo çdo lloj veprimi procedural që lidhet me ta nga cilido organ që njihet dhe operon në mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve apo në konflikt me ligjin. Pikërisht për këtë ka një parashikim në një nen të veçantë (Neni 17 “Shqyrtimi pa vonesë dhe me përparësi”).

¹⁶ Miratuar me Ligjin Nr. 37/ 2017. https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/03_Ligj_37_2017_30.03.2017_Kodi_i_Drejtesise_Penale_per_te_Miturit.pdf

d) Ligji Nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”¹⁷ shënon përpjekjen më të mirë të legjislatorit shqiptar në kuptim të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve. Ashtu siç është parashikuar edhe në hyrjen e këtij ligji, fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive. Interesi më i lartë i fëmijës është konsiderata parësore në çdo veprim që ka të bëjë me fëmijën. Interesi më i lartë i fëmijës nënkupton të drejtën e fëmijës për të pasur një zhvillim të shëndetshëm fizik, mendor, moral, shpirtëror e social, si dhe për të gëzuar një jetë familjare e sociale të përshtatshme për fëmijën. (*shih Nenin 6, të Ligjit Nr. 18/2017 “Zbatimi i interesit më të lartë të fëmijës”*).

Përcaktimi i qartë dhe vendosja e pozitës së fëmijës në kushtet e një grupi shoqëror me mbrojtje të posaçme nga ligji dhe autoritetet shtetërore, mund të shihet përgjatë të gjithë ligjit në fjalë, në formën e frymës dhe parimit të hartimit të normave ligjore. Vlen të theksohet fakti se Ligji Nr. 18/2017, është përmirësuar dukshëm në drejtim të këtyre parashikimeve ligjore krahasimisht me Ligjin e mëparshëm Nr. 10347/2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”.

e) Ligji Nr. 9669/2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, i ndryshuar¹⁸. Me përmirësimet që iu bënë këtij ligji në vitin 2018 dhe 2020, mbrojtja e fëmijëve nga dhuna në familje është reflektuar që në Nenin 1, “Qëllimi”, Pika 2: *“Garantimin e mbrojtjes me masa ligjore dhe me masa të tjera të nevojshme të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimë të dhunës në familje, duke u kushtuar vëmendje të veçantë grave, vajzave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuar, subjekt i këtij ligji, sipas Nenit 3 të tij”*.

Ndërkohë që në parashikimet në **Nenin 10, “Masat mbrojtëse ndaj dhunës në familje”,** ndër të tjera, në lidhje me fëmijët janë bërë këto rregullime: *1. Gjykata, si masë mbrojtëse të dhunës në familje, urdhëron menjëherë largimin e dhunuesit nga banesa për një afat kohor të caktuar, kur viktimë dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën strehë. Gjykata, kur është rasti, në vendosjen e kësaj mase merr në konsideratë nevojat e veçanta të dhunuesit të mitur, të moshuar ose personit me aftësi të kufizuar dhe në këto raste urdhri i largimit nga banesa vendoset vetëm kur asnjë masë tjetër nuk garanton mbrojtjen e viktimës nga dhuna. Përveç masës së largimit të dhunuesit nga banesa, mbrojtja ndaj dhunës në familje, në zbatim të këtij ligji, sigurohet dhe në këto mënyra:*

...d) duke ndaluar menjëherë të paditurin (dhunuesin) që t’i afrohet shtëpisë, vendit të punës, banesës së familjes së origjinës apo banesës së çiftit të ardhshëm ose të personave të tjerë dhe për më tepër shkollës së fëmijëve, ose vendeve të cilat frekuentohen më tepër nga viktimë, me përjashtim të rasteve kur frekuentimi bëhet për arsye pune;

dh) duke vendosur menjëherë viktimën/at dhe të miturit në strehime të përkohshme, duke mbajtur parasysh në çdo rast interesin më të lartë, atë të të miturit;

17 Miratuar në datën 23.02.2017, hyrë në fuqi në datën 09.06.2017. femijet.gov.al/wp-content/uploads/2017/07/LIGJI-NR-18-2017-“PËR-TË-DREJTAT-DHE-MBROJTJEN-E-FËMIJËS”.pdf

18 Me Ligjin Nr. 47/2018 dhe Ligjin Nr. 125/2020. <https://www.parlament.al/Files/Projekt-Ligje/20200207110616Ligji%20per%20masat%20ndaj%20dhunes%20ne%20marredheniet%20familjare.pdf>

e) duke kufizuar ose duke ndaluar të paditurin (dhunuesin) të takohet me fëmijën e viktimës, sipas kushteve të cilat mund të jenë të përshtatshme;

... h) duke urdhëruar të paditurin (dhunuesin) që të paguajë qeranë e banesës së përhershme apo të përkohshme të viktimës, si dhe detyrimin ushqimor për viktimën, fëmijët apo pjesëtarë të tjerë të familjes që ka në ngarkim;

... j) duke i hequr dhunuesit, përkohësisht, përgjegjësinë prindërore ose, nëse është rasti, kujdestarinë mbi të miturin, kujdestarinë për personin me aftësi të kufizuara, ose për personin që i është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar. Kur gjykata vendos të heqë ushtrimin e përgjegjësisë prindërore nga të dy prindërit ose nga prindi i vetëm, ajo cakton kujdestarinë e përkohshme mbi fëmijët, duke zbatuar rregullat e parashikuara në Kodin e Familjes dhe legjislacionin procedural në fuqi;

...3/1 Gjykata, kryesisht, në urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose/dhe në urdhrin e mbrojtjes, mund të parashikojë masa mbrojtëse për fëmijët që kanë pësuar dhunë ose kanë qenë të pranishëm kur është ushtruar dhunë në familje. Gjykata, sipas vlerësimit të saj, mund të zbatojë edhe masa mbrojtëse e procedura të parashikuara nga legjislacioni në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, derisa nuk cenohen afatet e procesit gjyqësor të parashikuara nga ky ligj.

Po kështu, në **Nenin 13/1, Pika 2**: “Në urdhrin për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme, sipas pikës 1 të këtij neni, derisa gjykata të nxjerrë urdhrin e menjëhershëm të mbrojtjes ose urdhrin e mbrojtjes, urdhërohet largimi i menjëhershëm i dhunuesit nga banesa, kur viktimja dhe dhunuesi banojnë në të njëjtën shtëpi, **përveç rastit kur dhunuesi është i mitur**, i moshuar ose person me aftësi të kufizuara, si dhe/ose përcaktohen një ose disa nga masat e mëposhtme...” Po në këtë nen, **Pika 4** theksohet: “...4. Në rastet kur dhuna ushtrohet ndaj ose në prani të fëmijëve, Policia e Shtetit merr menjëherë në mbrojtje fëmijën dhe njëkohësisht referon rastin pranë Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijëve në njësinë e vetëqeverisjes vendore, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”

e) Ligji Nr. 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”¹⁹, është një ndër aktet më të rëndësishme ligjore për mbrojtjen sociale të fëmijëve dhe familjeve në situata të vështira, përfshirë ata/ato në situata shfrytëzimi apo situata të tjera ekstreme. Ligji ka për qëllim “përcaktimin e rregullave për sigurimin dhe ofrimin e shërbimeve të kujdesit shoqëror, të cilat ndihmojnë në mirëqenien dhe përfshirjen shoqërore të individëve e të familjeve që kanë nevojë për kujdes shoqëror”. Administrimi i shërbimeve shoqërore bëhet në bazë të parimeve universale si: parimit të universalitetit, drejtësisë sociale, mbështetjes shoqërore, deinstitutionalizimit, mosdiskriminimit, etj. Sipas Nenit 6 të Ligjit, përfitues të shërbimeve shoqërore janë “a) familjet dhe çdo fëmijë, si dhe fëmija që gëzon mbrojtje ndërkombëtare...; ... ç) vajzat shtatzëna apo prindi i vetëm i një fëmije deri në moshën njëvjeçare; d) të miturit dhe të rinjtë në konflikt me ligjin, që kanë përfunduar periudhën e dënimit dhe kanë nevojë për shërbime të kujdesit shoqëror...; etj.

19 <https://www.vendime.al/ligj-nr-1212016-per-sherbimet-e-kujdesit-shoqeror-ne-republiken-e-shqiperise/>

f) Rezoluta e Kuvendit të Shqipërisë për të Drejtat e Fëmijëve, 2013²⁰. Në 26 Nëntor 2013, Kuvendi i Shqipërisë, pas një diskutimi të gjerë me deputetët dhe shoqërinë civile, nëpërmjet një Seance të Posaçme dëgjimore, që organizohej për herë të parë në historinë e Parlamentit Shqiptar, vendosi me vota unanime të të gjithë deputetëve miratimin e Rezolutës “Për Mbrojtjen dhe Respektimin e të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri”. Rezoluta është një arritje thelbësore e luftës dhe përpjekjes së gjerë të vetë Kuvendit, në bashkëpunim me shoqërinë civile, për të ngritur në një stad të ri nivelin e përgjegjësisë, por edhe llogaridhënies për fëmijët dhe të drejtat e tyre në Shqipëri. Ndër të tjera, Rezoluta fokusohet në rolin e Kuvendit të Shqipërisë, duke e vendosur theksin tek monitorimi i vazhdueshëm i punës së Qeverisë dhe organeve të saj për të mbrojtur fëmijët, mbështetjen që duhet dhënë për shërbimet në mbrojtje të fëmijëve, etj...

g) Rezoluta “Për dënimin e dhunës ndaj grave e vajzave dhe rritjen e efektshmërisë së mekanizmave ligjorë për parandalimin e saj”²¹. Kuvendi, më 04.12.2017, miratoi këtë rezolutë, në zbatim të së cilës u ngrit Nënkomisioni “Për barazinë gjinore dhe parandalimin e dhunës ndaj gruas”, pranë Komisionit të përhershëm për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë. Ky nënkomision në kuadrin e procesit të kontrollit parlamentar kërkon informacion të vazhdueshëm për zbatimin e Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore, raportim për situatën e dhunës në familje, apo për çështje të diskriminimit ndaj grave e vajzave, zhvillon seanca dëgjimore me grupet e interesit dhe institucionet, etj... Në lidhje me këtë rezolutë, në kuadrin e 16 Ditëve Ndërkombëtare të Aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore, më 25 nëntor 2020, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, u është drejtuar me një letër krerëve të Drejtësisë dhe Policisë për zbatimin e legjislacionit kundër dhunës ndaj grave e vajzave. Në këtë letër, ndër të tjera theksohet se “...pavarësisht zhvillimeve pozitive, të dhënat për rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, tregojnë se dhuna është ende e pranishme dhe shfaqet në forma të ndryshme deri tek më ekstremet, ku më së shumti viktimat janë gratë dhe fëmijët. Sipas raportit të GREVIO-s, dobësitë më të mëdha që prekin mekanizmat e referimit kanë të bëjnë me mungesën e zbatimit të duhur të urdhrave të mbrojtjes dhe urdhrave të menjëhershëm të mbrojtjes nga përmbarrimi, përgjigjet e papërshtatshme nga sistemi i gjykatave dhe një përfshirje e pamjaftueshme e profesionistëve të shëndetit, përfshirë këtu mjekët ligjorë. Kuvendi i Shqipërisë vëren se sistemi i drejtësisë (policia, prokuroria, gjykatat, shërbimet sociale në sistemin e drejtësisë penale) nuk ka qenë efektivë sa duhet lidhur me hetimin dhe shqyrtimin e rasteve të dhunës në familje dhe të zbatimit të drejtë të dispozitave ligjore të Kodit Penal për dënimin e dhunuesve dhe ofrimin e shërbimeve për viktimat. Pavarësisht se qasja holistike kundër dhunës ndaj grave nuk mund të mbështetet vetëm në sistemin e drejtësisë penale, gjykatat duhet të jenë në një linjë me qëndrimin e vendosur të ligjvënësit kundër dhunës dhe të ofrojnë një reagim të fuqishëm, duke përfshirë edhe ndëshkimet. Kjo do të nxiste raportimin e mëtejshëm të rasteve të dhunës në familje. Ndonëse ka një përmirësim të qartë në respektimin e afateve të gjykimit të kërkesave për lëshimin e urdhëra të mbrojtjes, ende shtyhen në mënyrë të panevojshme seancat gjyqësore për vërtetimin dhe lëshimin e tyre. Shpejtësia dhe respektimi i afateve, përbën një element thelbësor të gjykimit për urdhrat e mbrojtjes, mosrespektimi i të cilave sjell humbjen e kuptimit të

20 https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/Femijet/rezoluta_per_mbrojtjen_e_femijeve.pdf

21 <https://qbz.gov.al/eli/rezolute/2017/12/04/212-1/776876ba-c4b3-4519-b120-cf2b5dd61cf9>

ligjit kundër dhunës në familje dhe mund të vërë në rrezik viktimat. Në këto kushte, kërkoj nga ana juaj të merrni masat e nevojshme për zbatimin rigoroz të dispozitave të Kodit Penal mbi dhunën në familje dhe dhunën ndaj grave.”²²

Më 23 Korrik 2020, u organizua ceremonia e shpalljes së lëvizjes kombëtare: **#NE JEMI1. Së bashku kundër dhunës dhe shfrytëzimit seksual të fëmijëve në Shqipëri**. Kjo lëvizje kombëtare #NEJEMI1, e bërë publike nga Presidenti Meta dhe Qendra për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve – CRCA/ECPAT Shqipëri, në bashkëpunim me BARNAHUS Shqipëri, synon të adresojë sfidat dhe mangësitë në mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna dhe shfrytëzimi seksual në të gjithë Shqipërinë, duke angazhuar qytetarët, prindërit, arsimtarët, edukatorët, artistët, zyrtarët publikë, shoqërinë civile, të rinjtë dhe vetë fëmijët, për të denoncuar çdo akt të dhunës apo shfrytëzimit seksual të fëmijëve, si dhe për të punuar me autoritetet për të marrë masa për të mbrojtur, kujdesur dhe ndërgjegjësuar fëmijët dhe familjen nga pasojat që sjell dhuna. Në qershor 2020, CRCA/ECPAT Shqipëri dorëzoi pranë Komisionit të Ligjeve dhe Aleancës së Grave Deputete në Kuvendit të Shqipërisë, si dhe pranë Ministrisë së Drejtësisë, propozimet e saj për shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal në Shqipëri. Propozimet kërkojnë të përforcojnë përkufizimet, zbatimin dhe dënimet e disa veprave penale, të cilat sjellin pasoja të rënda mbi jetën, dinjitetin dhe mirëqenien fizike dhe emocionale të viktimave. Këto propozime përfshijnë edhe shtimin e disa neneve të reja dhe dënimin si vepër penale për personat që shtyjnë, nxisin, mashtrojnë e manipulojnë fëmijën për të kryer marrëdhënie seksuale; komunikimin me fëmijën për qëllime seksuale etj... Në propozimet e bëra kërkohet edhe krijimi i Regjistrat Kombëtar për Krimet Seksuale, i cili ka si qëllim të parandalojë takimet midis grabitqarëve seksuale dhe fëmijëve. Këto propozime janë në përputhje të normave dhe standarteve të legjislacionit të Këshillit të Evropës (Konventa e të Drejtave të Njeriut) dhe në mënyrë të veçantë të Konventës së Lanzarotit të KE-së, të ratifikuar nga Shqipëria²³. Aktivitetet në këtë drejtim kanë vijuar edhe më tej, në nëntor 2020, me organizimin e “Ditës së Fjongos Blu”, një maratonë ndërgjegjësimi dhe fuqizimi për fëmijët, adoleshentët, prindërit por edhe aktivistët në luftën kundër dhunës seksuale. Ndërkohë po përgatitet edhe “Protokolli i trajtimit të rasteve të dhunës seksuale tek fëmijët”.

Parashikime të rëndësishme lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve përmbajnë edhe një sërë dokumentesh të tjerë ligjorë, të tillë si: Ligji Nr. 10221/2010 për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji për Avokatin e Popullit, i rishikuar, Kodi i Familjes, etj...

Gjithashtu, së fundmi, janë miratuar një tërësi aktesh normative, të tilla si: Vendime të Këshillit të Ministrave (VKM) dhe udhëzime, që synojnë krijimin e një sistemi efektiv për mbrojtjen e fëmijëve, që garanton të drejtat dhe siguron mbrojtjen e tyre nga të gjitha format e dhunës, në përmbushje të parimeve të bashkëpunimit ndërsektorial. Ndër to, përmendim:

VKM-ja Nr. 148, datë 13.03.2018 “Për përcaktimin e rregullave të bashkëpunimit midis mekanizmave institucionale, strukturave për mbrojtjen e fëmijëve në nivel vendor dhe organizatave jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare dhe vendore, si dhe për

22 <https://www.parlament.al/News/Index/11497>

23 <https://www.crca.al/sq/news-national-register-sexual-crimes-against-children-albania-child-protection-violence/crca-dorezon>

shërbimet e nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve". Ky vendim përcakton rregullat e bashkëpunimit mes mekanizmave institucionalë, strukturave për mbrojtjen e fëmijëve në nivel qendror dhe vendor dhe organizatave jofitimprurëse për realizimin e politikave kombëtare dhe vendore, si dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për mbrojtjen e fëmijëve. Vendimi parashikon angazhimet konkrete që ndërmarrin mekanizmat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës në nivel qendror e vendor në kuadër të këtij bashkëpunimi, si dhe nga ana tjetër, angazhimet që ndërmarrin organizatat jofitimprurëse sipas legjislacionit në fuqi për të realizuar këtë bashkëpunim.

VKM-ja Nr. 565, datë 29.09.2018 "Për bashkërendimin e veprimtarisë ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor, për çështjet që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës". Ky vendim përcakton rregullat dhe procedurat për bashkërendimin e punës ndërmjet mekanizmave këshillimorë dhe koordinues institucionalë dhe strukturave në nivel qendror dhe vendor, për çështje që lidhen me të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës. Procesi i bashkërendimit të punës, ndërmjet mekanizmave dhe strukturave që përcaktohen në këtë vendim, ka si synim përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi, si edhe detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë, në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës.

VKM-ja Nr. 578, datë 03.10.2018 "Për procedurat e referimit dhe të menaxhimit të rastit, hartimin e përmbajtjes së planit individual të mbrojtjes, financimin e shpenzimeve për zbatimin e tij, si dhe zbatimin e masave të mbrojtjes". Ky vendim është një nga aktet nënligjore më të rëndësishëm dhe thelbësor për realizimin dhe funksionimin e sistemit të mbrojtjes së fëmijëve pasi adreson procese, instrumente dhe mekanizma, që qëndrojnë në bazë të sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, siç janë procedurat e referimit, hartimi dhe zbatimin e Planit të Mbrojtjes së Fëmijës, si dhe marrja e vënies në zbatim të masave të mbrojtjes. Për herë të parë ky vendim parashikon mënyrën e financimit të ndërhyrjeve dhe shërbimeve për mbrojtjen e fëmijës.

VKM-ja Nr. 129, datë 13.03.2019 "Për procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar, përfshirë fëmijët në situatë rruge". Ky vendim ka për qëllim të përcaktojë rregullat dhe procedurat për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar në sektorin formal dhe informal, përfshirë fëmijët në situatë rruge. Ai parashikon rolet, përgjegjësitë, afatet kohore dhe ndërveprimin midis institucioneve përgjegjëse për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve të shfrytëzuar, përfshirë fëmijët në situatë rruge. Gjithashtu vendimi përcakton edhe procedurat për referimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje tek shërbimet mbështetëse të nevojshme.

VKM-ja Nr. 465, datë 03.07.2019 "Masat për mbrojtjen e fëmijëve nga aksesin në përmbajtje të paligjshme dhe/ose të dëmshme në internet". Qëllimi i këtij vendimi është që informacioni, i cili merret apo përfitohet, duhet të përdoret vetëm për të përcaktuar nevojat e fëmijës dhe për ta mbrojtur atë nga dëmtimi, si dhe në çdo rast do të mbrohet privatësia dhe identiteti i fëmijës. Mbrojtja e fëmijës është një përgjegjësi e përbashkët dhe duhet të përfshijë të gjitha strukturat dhe shërbimet, fëmijët dhe familjen e tyre.

Udhëzimi Nr. 556, datë 29.07.2019 “Për mënyrën e vendosjes, në institucionet e përkujdesit shoqëror për fëmijën, ndaj të cilit është marrë masë mbrojtje”. Qëllimi i këtij udhëzimi është të garantojë sistemimin e fëmijës në institucionet e përkujdesit shoqëror me efektivitet dhe në përputhje me nevojat e interesin më të lartë, ndaj të cilit është marrë një masë mbrojtjeje sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin Nr. 18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.

Udhëzimi Nr. 650, datë 13.09.2019 “Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal”²⁴. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i kriterëve dhe procedurave për përzgjedhjen e përfaqësuesve proceduralë për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal.

Udhëzimi Nr 651, datë 13.09.2019 “Për procedurat e raportimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje”²⁵. Qëllimi i këtij udhëzimi është përcaktimi i procedurave të raportimit të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje, nga çdo person fizik ose juridik, institucionet publike dhe private, mësuesit dhe ofruesit e shërbimit psiko-social në shkolla, institucion arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, punonjësit e institucioneve shëndetësore apo të përkujdesit shoqëror të fëmijës, qofshin këto publike apo private, organet e policisë dhe strukturat e mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor, sipas përcaktimeve në Ligjin Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”.

3.3. POLITIKAT KRYESORE KOMBËTARE

Parashikime lidhur me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve si dhe ofrimin e shërbimeve përkatëse sipas moshës e nevojave të tyre, gjejmë dhe në një sërë politikash të rëndësishme kombëtare, duke filluar nga Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2016 – 2020, e cila parashikon “*Reformimin e përgjithshëm të sistemit të drejtësisë dhe cilëson sistemin e drejtësisë për të miturit si një sfidë të rëndësishme*”. Po kështu, mund të përmendim dhe Strategjinë Sektoriale të Mbrojtjes Sociale 2016-2020, Strategjinë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Planin e saj të Veprimit 2016-2020, Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe Egjiptjanëve në Republikën e Shqipërisë 2016–2020, etj... Por, si politika më të rëndësishme kombëtare në drejtim të mbrojtjes së fëmijëve do të veçonim:

a) Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017–2020²⁶, përfaqëson një dokument strategjik, i cili shpreh prioritetet e institucioneve shtetërore në fushën e të drejtave të fëmijëve, si dhe njëkohësisht, një kuadër të unifikuar për monitorimin e progresit të qeverisë shqiptare drejt realizimit të të drejtave të fëmijëve, në të gjithë sektorët përkatës. Kjo agjendë përmban tre shtylla strategjike: (i) Mirëqeverisja në funksion të promovimit, respektimit dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve; (ii) Eliminimi i të gjitha formave të dhunës ndaj fëmijëve; dhe (iii) Sisteme dhe shërbime

24 Udhëzim i përbashkët me Ministrinë e Drejtësisë, Neni 49, Pika 4

25 Udhëzim i përbashkët me Ministrinë e Arsimit, Sporteve dhe Rinisë si dhe me Ministrinë e Brendshme, Neni 67, Pika 7

26 Miratuar me VKM-në Nr. 372, datë 26.4.2017. https://childhub.org/sq/system/tdf/library/attachments/agjenda-kombetare-per-te-drejtat-e-femijeve_0.pdf?file=1&type=node&id=27393

miqësore ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve: zhvillimi dhe arsimimi, drejtësia, shëndeti dhe ushqyerja, si dhe mbrojtja sociale. Agjenda udhëhiqet nga parimi kryesor i interesit më të lartë të fëmijës dhe ka si vizion krijimin e një mjedisi të favorshëm për rritjen e sigurtë dhe të shëndetshme të fëmijëve, zhvillimin e potencialit maksimal fizik dhe psikosocial të fëmijëve, përfshirjen sociale dhe pjesëmarrjen aktive në të gjitha fushat që prekin jetën e tyre, si dhe garantimin e vlerësimit të progresit të të drejtave të fëmijëve në fushat kryesore të politikave publike që lidhen me fëmijët.

b) Strategjia e Drejtësisë për të Miturit dhe Plani i Veprimit 2018–2021²⁷, qëllimi i së cilës është promovimi dhe mbrojtja më efektive e të drejtave dhe nevojave në proceset gjyqësore dhe alternativat ndaj këtyre procedurave, për të miturit/miturat në konflikt me ligjin, viktimat, dëshmitarë/dëshmitare të veprave penale, të miturit/miturat nën moshë për t'u ndjekur penalisht dhe të miturit/miturat pjesëmarrës/pjesëmarrëse në proceset gjyqësore, kryesisht atyre penale, nëpërmjet zbatimit të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve. Strategjia përmban një qasje ndërdisiplinore, që integrohet me të gjitha dokumentet e tjera ekzistuese kombëtare, e shoqëruar me aktivitete konkrete. Prioritetet në realizimin e vizionit strategjik fokusohen në qasjen tek një drejtësi miqësore për të mitur/mitura, e cila u referohet sistemeve të drejtësisë që garantojnë respektimin dhe zbatimin efektiv të të drejtave të fëmijëve, duke mbajtur në konsideratë nivelin e pjekurisë së fëmijës dhe rrethanat e çështjes. E ndarë në komponentë, kjo nënkupton drejtësi të aksesueshme, të përshtatshme me moshën, të shpejtë, efektive, të përshtatur dhe të fokusuar në nevojat dhe të drejtat e fëmijëve, ku përfshihet e drejta për proces të rregullt, e drejta për të marrë pjesë në gjykim dhe për të kuptuar procedurat, si dhe e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, integritetit dhe dinjitetit të fëmijës.

3.4. MEKANIZMAT KËSHILLIMORË INSTITUCIONALË PËR TË DREJTAT DHE MBROJTJEN E FËMIJËS

Ligji Nr.18/2017 “Për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës”, në kreun III të tij, Neni 34 e në vijim, parashikon edhe mekanizmat këshillimorë dhe koordinues institucionalë, dhe strukturat për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, të cilët ndahen në mekanizma në nivel qendror dhe vendor.

a) Këshilli Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (KKDMF) është organi më i lartë këshillimor në nivelin qendror. Ai ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozimin e ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës. KKDMF-ja ka si detyrë kryesore këshillimin dhe bashkërendimin e politikave shtetërore për garantimin e të drejtave dhe mbrojtjen e fëmijës në të gjitha fushat, sidomos në ato të drejtësisë, shërbimeve shoqërore, arsimit, shëndetësisë dhe kulturës (*shih Nenin 35 të Ligjit Nr. 18/2017*). Vlen të theksohet fakti se ligji Nr. 18/2017, në ndryshim me ligjin e mëparshëm të mbrotjes së të drejtave të fëmijëve Nr.10/347/2010, ka përfshirë si pjesë përbërëse të këtij këshilli jo dy, por pesë përfaqësues nga rradhët e shoqërisë civile si dhe ka sjellë një risi absolute me përfshirjen në këtë këshill të fëmijëve me

²⁷ Miratuar me VKM-në Nr. 541, datë 19.09.2018. <https://administrata.al/Documents/strategjia%20doc/21.Strategjia%20e%20Drejt%20c3%absis%20p%20c3%abr%20t%20c3%ab%20Mitur%202018%20-%202021%20.pdf>

statusin e vëzhguesit, të cilët janë përfaqësues të qeverive të nxënësve, organizatave, forumeve apo çdo grupimi tjetër fëmijësh. *(shih Nenin 34, Pika 3 e Ligjit Nr. 18/2017).*

VKM-ja Nr. 54, datë 31.01.2018 “Për rregullat e funksionimit të Këshillit Kombëtar për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës” synon të përcaktojë rregullat në lidhje me funksionimin e KKDMF-së. Rregullorja e KKDMF-së ka në përmbajtjen e saj mënyrën se si zgjidhen anëtarët, kohëzgjatjen e mandatit të tyre, organizimin dhe mbledhjet e KKDMF-së, detyrat dhe funksionet që realizon sekretariati teknik pranë këtij Këshilli. Po ashtu, rregullorja përcakton se cilët/cilat janë pjesëmarrës/pjesëmarrëse me statusin e vëzhguesit/vëzhgueses në mbledhjet e Këshillit.

b) Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF) është pjesë e strukturave në nivel qendror për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, në varësi të ministrisë që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës. Agjencia është përgjegjëse për koordinimin dhe organizimin e sistemit të integruar të mbrojtjes së fëmijës, në zbatim të politikave kombëtare për mbrojtjen e fëmijës, duke përfshirë zbatimin e ndërhyrjeve dhe marrjen e masave për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijës nga abuzimi, neglizhimi, keqtrajtimi dhe dhuna.

ASHDMF-ja ka për detyrë t’u ofrojë mbështetje të drejtpërdrejtë strukturave të mbrojtjes së fëmijës në nivel vendor; bashkëpunon me strukturat shtetërore përgjegjëse në procesin e hartimit të propozimeve e të zbatimit të politikave integruese në Bashkimin Evropian, në fushën e mbrojtjes së të drejtave të fëmijës; ndërton dhe realizon vetë veprimtari për edukimin, trajnimin, ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe të punonjësve/seve e të funksionarëve/eve të administratës publike e të sistemit të drejtësisë; koordinon ose realizon fushata ndërgjegjësimi dhe aktivitete konkrete për promovimin e pjesëmarrjes së fëmijës në të gjitha fushat; inicion dhe zbaton projekte pilot, në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe u jep mbështetje teknike organizatave jofitimprurëse, që punojnë në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës; organizon dhe bashkërendon kërkime shkencore në fushën e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës, etj.

VKM-ja Nr. 91, datë 14.02.2018 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit dhe vendosjes së sanksioneve nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës (ASHDMF)”, që përcakton rregullat në lidhje me procedurën e kryerjes së kontrollit, kur vihet re ose dyshohet se ka ndodhur një shkelje e të drejtave të fëmijës, ose kur strukturat përkatëse nuk kanë përmbushur detyrimet ligjore. Këto rregulla kanë për qëllim përforcimin e rolit të ASHDMF-së në funksion të kompetencave që i janë dhënë në bazë të Ligjit Nr. 18/2017.

VKM-ja Nr. 636, datë 26.10.2018 “Për përcaktimin e llojeve, të mënyrës së shkëmbimit e të përpunimit të informacionit dhe të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës pranë strukturave shtetërore përgjegjëse, në nivel qendror dhe vendor”. Ky vendim përcakton llojin dhe mënyrën e shkëmbimit dhe të përpunimit të informacionit e të dhënave statistikore, të kërkuara nga Agjencia pranë strukturave shtetërore përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor. Treguesit dhe statistikat nga fusha të ndryshme, si: demografia, shëndeti, ushqimi, dhuna, migrimi, puna, varfëria, arsimit, drejtësia për fëmijë, paraqesin një panoramë të fushave të të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijëve.

c) Njësitë e Vetëqeverisjes Vendorë (Bashkitë). Bashkitë janë përgjegjëse për ngritjen në varësi të tyre të strukturave përkatëse për mbrojtjen e fëmijës dhe, nëpërmjet tyre, të një sistemi të integruar të mbrojtjes së fëmijës. Pushtetit vendor, në bazë të ligjit, i lind detyrimi në funksion të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, të bëjë pasqyrimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijës në planet e zhvillimit vendor, në programet dhe projektet e tyre, të parashikojë në buxhet fonde për realizimin progresiv të të drejtave të fëmijës, etj...

Në fokus të ligjit dhe në përputhje me interesin më të lartë të fëmijës është edhe organizimi dhe ofrimi i shërbimeve për fëmijët në nevojë për mbrojtje, shërbimeve me bazë komunitare për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e fëmijës, shërbimeve mbështetëse për familjet e shërbimeve të përkujdesjes alternative për fëmijët; si dhe ngritja e programeve dhe shërbimeve rehabilituese e riintegruese për fëmijët në nevojë për mbrojtje, me një fokus të veçantë për fëmijët viktimë të dhunës, abuzimit, neglizhimit dhe shfrytëzimit, si dhe fëmijët që dyshohen apo kanë kryer vepra penale, të cilët/cilat janë nën moshën për përgjegjësi penale.

Struktura përgjegjëse për shërbimet shoqërore në bashki është përgjegjëse edhe për çështjet e mbrojtjes së fëmijës në përgjithësi. Ajo në bashkëpunim me drejtoritë e tjera të bashkisë, me mekanizmat vendorë të mbrojtjes dhe institucionet tjera vendore, merr të gjitha masat e nevojshme për realizimin dhe garantimin e mbrojtjes së fëmijës në territorin e bashkisë (*shih Nenin 47 të Ligjit Nr. 18/2017*)

Njësia për mbrojtjen e fëmijës (NJMF) në bashki ngrihet dhe funksionon si njësi e posaçme brenda strukturës përgjegjëse për shërbimet shoqërore në nivel bashkie dhe ka për detyrë, në mënyrë të posaçme, parandalimin, identifikimin, vlerësimin, mbrojtjen dhe ndjekjen e rasteve të fëmijës në rrezik dhe/ose në nevojë për mbrojtje (*shih Nenin 49 të Ligjit Nr. 18/2017*). NJMF-ja në bashki harton dhe përshtat, një herë në vit, listën e përfaqësuesve/eve proceduriale për fëmijët në konflikt me ligjin, fëmijët viktimë dhe dëshmitarë në procesin penal dhe ua dërgon atë strukturave vendore të Policisë së Shtetit, Prokurorisë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor e të Apelit. Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përfaqësuesve/eve proceduriale përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit që bashkërendon punën për çështjet e të drejtave dhe mbrojtjes së fëmijës dhe Ministrit të Drejtësisë.

Punonjësit për mbrojtjen e fëmijës (PMF) në njësitë administrative të bashkisë, janë pjesë e njësisë së vlerësimit të nevojave dhe referimit dhe parashikohet të kryejnë vetëm detyra që lidhen me mbrojtjen e fëmijës. Çdo njësi administrative e bashkisë, e cila ka më shumë se 3000 fëmijë, duhet të ketë minimalisht, një punonjës për mbrojtjen e fëmijës. PMF-ja kryen funksionin e menaxherit të rastit për fëmijët në nevojë për mbrojtje, që nga momenti i identifikimit apo referimit, gjatë hartimit e zbatimit të masës së mbrojtjes dhe Planit Individual të Mbrojtjes deri në përfundimin e tyre (*shih Nenin 51 e vijues të Ligjit Nr. 18/2017*). Megjithatë, pavarësisht këtyre parashikimeve ligjore, në praktikë, numri i PMF-ve të dedikuara vetëm për këtë pozicion punë me kohë të plotë, është tepër i kufizuar. Shpesh PMF-ja kryen edhe detyrën e Koordinatorit/es Vendor/e kundër dhunës në familje, të Nëpunësit/es së Barazisë Gjinore, etj...

Grupi teknik ndërsektorial (GTN). Në çdo bashki dhe në çdo njësi administrative bashkiake, e cila ka mbi 3000 fëmijë, krijohet ad hoc, grupi teknik ndërsektorial i trajtimit të rasteve të fëmijës në nevojë për mbrojtje. GTN-ja mbështet PMF-në dhe njësinë e vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit, hartimin e Planit Individual të Mbrojtjes, lehtëson referimin e tij, si dhe zbatimin e ndërhyrjeve apo veprimeve të përcaktuara në Planin Individual të Mbrojtjes.

VKM-ja Nr. 353, datë 12.06.2018 “Për rregullat e funksionimit të grupit teknik ndërsektorial për mbrojtjen e fëmijëve pranë bashkive dhe njësive administrative”, synon të rregullojë mënyrën e funksionimit të GTN-së duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë e antëtarëve, për një adresim sa më të plotë dhe efikas të rasteve të fëmijëve në nevojë për mbrojtje.

IV. RISHIKIMI I RAPORTEVE EKZISTUESE



Abuzimi seksual, përfshirë sulmin seksual ose përdhunimin, ndaj fëmijëve dhe adoleshentëve është një problem i madh global i shëndetit publik, që shkel të drejtat e njeriut dhe krijon shumë pasoja, sociale, psikologjike dhe shëndetësore afatshkurtëra dhe afatëgjata. Abuzimi seksual i fëmijëve dhe adoleshentëve është një temë që ka marrë shumë vëmendje në vitet e fundit. Njëzet e tetë për qind (28%) deri në tridhjetë e tre për qind (33%) e grave dhe dymbëdhjetë për qind (12%) deri në tetëmbëdhjetë për qind (18%) e burrave ishin viktime të abuzimit seksual gjatë fëmijërisë ose adoleshencës (Long, Burnett, & Thomas, 2006). Abuzimi seksual i fëmijëve mund të marrë shumë forma, por gjithnjë është shkelje e të drejtave të një të riu dhe rrit rrezikun e shumë kushteve të pafavorshme të shëndetit fizik dhe mendor.

Abuzimi seksual i fëmijërisë shkel të drejtat themelore të qenieve njerëzore. Fëmijët duhet të jenë në gjendje të kenë përvojë seksuale në kohën e duhur të zhvillimit duke bërë zgjedhjen e tyre. Natyra dhe dinamika e abuzimit seksual dhe marrëdhënive abuzive seksuale janë shpesh traumatike. Kur abuzimi seksual ndodh në fëmijëri, ai mund të pengojë rritjen normale shoqërore dhe të jetë shkak i shumë problemeve të ndryshme psiko-sociale (Maltz, 2002).

Në Shqipëri, vitet e fundit, janë kryer disa studime që adresojnë çështje të abuzimit të fëmijëve, e veçanërisht çështje të abuzimit seksual të tyre.

4.1. Studimi mbi Prevalencën e Përvojave Negative gjatë Fëmijërisë (2011-2012), OBSH-ja, 2013: ky studim u mbështet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe u krye në një kampion përfaqësues të studentëve që ndjekin universitetin (N=1437; 67.6% femra /32.4% meshkuj). Ky studim synonte të përshkruante Përvojat Negative gjatë Fëmijërisë (PNF) në popullatën e re shqiptare, për të identifikuar karakteristikat socio-ekonomike dhe për të gjetur lidhjet midis PNF-së, sjelljeve të rrezikshme shëndetësore dhe pasojave shëndetësore. Rezultatet dëshmuuan për një prevalencë të lartë të keqtrajtimit të fëmijëve ku format më të shpeshta të abuzimit gjatë fëmijërisë ishin ato fizike (40%), psikologjike (50%), seksuale (6%), dhe të qenit dëshmitarë të keqtrajtimit të nënës (rreth 30%), duke paraqitur nivelin më të lartë të keqtrajtimit në këtë popullsi krahasuar me 8 vendet e tjera që kanë kryer studimin e PNF-së. Prevalenca e abuzimit seksual ishte dukshëm më e lartë tek studentët meshkuj krahasuar me studentet femra (përkatësisht 8.8% përkundrejt 4.7%).

Shkalla e abuzimit emocional gjatë fëmijërisë ishte e ngjashme në studentët meshkuj dhe femra (51%). Djemtë ishin më të lënë pas dore fizikisht (10.1 tek djemtë përkundrejt 6.5 tek vajzat) dhe emocionalisht (15.7 tek djemtë përkundrejt 11.2 tek vajzat) krahasuar me femrat, dhe këto ndryshime ishin statistikisht të rëndësishme ($P < 0.001$). Në total, rreth 30% e studentëve dëshmuar se nëna e tyre ishte dhunuar dhe rreth 40% e tyre ishin ngacmuar dhe ishin përfshirë në ndeshje fizike gjatë fëmijërisë, të cilat ishin dukshëm më të përhapura tek meshkujt sesa tek femrat. Në përgjithësi 14% e studentëve raportuan të paktën katër PNF dhe pothuajse gjysma e tyre raportuan 2 ose më shumë PNF. PNF-të ishin të lidhura pozitivisht me vendlindjen, arsimimin e prindërve, papunësinë e babait dhe të lidhura anasjelltas me nivelin e të ardhurave. Gjetjet tregojnë se mundësitë e zhvillimit të sjelljeve të rrezikshme shëndetësore, të tilla si: përdorimi i duhanit, alkoolit, drogave të paligjshme, partnerëve të shumtë dhe përpjekjeve për vetëvrasje rriten me rritjen e numrit të PNF-ve, duke nënkuptuar një lidhje shkakësore.

4.2. Studimi “Sjelljet e shëndetshme tek fëmijët e moshës shkollore (HBSC) 2017-2018”: Shqipëria është pjesë e rrjetit të HBSC-së që nga viti 2009. Ky lloj studimi mbledh të dhëna për shëndetin dhe mirëqenien, mjedisin shoqëror dhe sjelljet shëndetësore të djemve dhe vajzave të moshës 11, 13 dhe 15 vjeç. Këto të dhëna mund të përdoren për politikëbërje dhe qëllime planifikimi në lidhje me strategjitë e ndërhyrjes për përmirësimin e gjendjes shëndetësore të adoleshentëve. Në raundin aktual, për herë të parë Shqipëria përfshiu edhe pyetjet opsionale në lidhje me keqtrajtimin e fëmijëve. Ndër të tjera, HBSC-ja 2017-18 ofron informacion të vlefshëm në lidhje me bulizimin, ngacmimet fizike dhe keqtrajtimin e fëmijëve, përveç të dhënave të abuzimit seksual, të cilat u mbledhën për herë të parë në Shqipëri.

Në total, një në katër fëmijë (rreth 30% e djemve përkundrejt 20% e vajzave) kishin ngacmuar të tjerët në muajt e fundit para studimit. Rreth 22% (rreth 25% e djemve përkundrejt 20% të vajzave) ishin ngacmuar në muajt e fundit nga bashkëmohatarët e tyre. Për më tepër, rreth 22% e mostrës së përgjithshme të nxënësve të shkollës të përfshirë në studim kishin ngacmuar kibernetikisht të tjerët dhe/ose ishin ngacmuar kibernetikisht nga bashkëmohatarët e tyre në muajt e fundit. Lidhur me ngacmimet fizike, rreth 30% e nxënësve raportuan të paktën një episod të ngacmimeve fizike gjatë vitit të kaluar (pothuajse një në dy djem krahasuar me një në pesë vajza). Përveç kësaj, rreth 32% e nxënësve të shkollës (37% e djemve përkundrejt 28% të vajzave) raportuan të paktën një episod të lëndimit gjatë vitit të kaluar. Për më tepër, prevalenca e abuzimit fizik gjatë gjithë jetës në kampionin e përgjithshëm të nxënësve të shkollës të përfshirë në sondazh ishte rreth 31% (pak më e lartë tek djemtë sesa tek vajzat), ndërsa prevalenca e abuzimit emocional gjatë gjithë jetës ishte 16% (mesatarisht më e lartë tek djemtë krahasuar me vajzat)) Së fundmi, neglizhenca fizike gjatë gjithë jetës u raportua nga vetëm rreth 2% e fëmijëve (rreth 4% tek djemtë kundrejt vetëm 0.7% të vajzave), ndërsa neglizhenca emocionale nga 14% e fëmijëve (rreth 9% tek djemtë përkundrejt 19% të vajzave). Ndërkohë që prevalenca e neglizhencës fizike (të vetë-raportuar) ishte më e lartë tek djemtë sesa tek vajzat, një gjetje e kundërt ishte e dukshme për neglizhencën emocionale.

Matja e abuzimit dhe keqtrajtimit të fëmijëve, e kufizuar vetëm tek të rinjtë e moshës 15 vjeç, përfshiu vlerësimin e abuzimit fizik dhe abuzimit emocional gjatë jetës dhe/ose gjatë muajit të

kaluar. Në përgjithësi, më shumë se dy të tretat (69%) e të rinjve raportuan se nuk ishin lënduar ndonjëherë fizikisht nga prindërit e tyre ose të rriturit e tjerë në familjet e tyre përkatëse. Një në katër të rinj (26%) raportuan se ishin abuzuar fizikisht një ose dy herë gjatë jetës, ndërsa 6% kishin përjetuar abuzim fizik shumë herë gjatë jetës së tyre. Nuk kishte dallime të rëndësishme gjinore në nivelet e abuzimit fizik ($P = 0.501$).

Në total, prevalenca e abuzimit emocional gjatë gjithë jetës ishte 16%, me një ndryshim të rëndësishëm midis djemve dhe vajzave (13% përkundrejt 18%, respektivisht; $P = 0.007$). Në mënyrë të ngjashme, vetëm të rinjtë e moshës 15 vjeç u pyetën për neglizhencën emocionale në kontekstet e tyre përkatëse dhe rrethanat shtëpiake. Më konkretisht, të rinjtë u pyetën nëse kishte raste kur me ta nuk jetonte asnjë i rritur që t'i bënte fëmijët të ndiheshin të dashur. Në total, rreth 14% e të rinjve të moshës 15 vjeçare raportuan se kishin përjetuar neglizhencë emocionale gjatë jetës së tyre (9% tek djemtë përkundrejt 19% të vajzave; $P < 0.001$).

4.3. Vrojtimi Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave (DhNGV) në Shqipëri, INSTAT 2019

Vrojtimi Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave (DhNGV) në Shqipëri, 2018 (publikuar në Mars 2019) u bë për të matur natyrën dhe shkallën e pesë llojeve të ndryshme të DhNG-së (dhuna në familje ushtruar nga partneri intim, dhuna gjatë marrëdhënies dashurore, dhuna nga jo-partneri, ngacmimi seksual dhe, përndjekja) dhe disa norma shoqërore të lidhura me DhNGV-në. Kampioni i studimit ishte 3.443 familje dhe gratë e moshës 18-74 vjeç.

Të dhënat e studimit tregojnë se 3,1% e grave të moshës 18-74 vjeçare raportuan se ishin abuzuar seksualisht gjatë fëmijërisë (domethënë, ato ishin prekur seksualisht kur nuk kishin dashur apo ishin detyruar të bënin diçka seksuale që nuk kishin dashur ta bënin). Gjithashtu gratë që kanë përjetuar abuzim seksual në fëmijëri (88,8%) kishin më shumë gjasa të përjetonin “ndonjëherë” dhunë seksuale dhe/ose dhunë me bazë gjinore në moshë të rritur në jetën e tyre krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar abuzime seksuale në fëmijëri (51,5%). Përveç kësaj, gratë që kishin përjetuar abuzime seksuale në fëmijëri (64,6%) kishin më shumë gjasa të përjetonin dhunë në familje nga partneri intim, krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar abuzime seksuale në fëmijëri (39,3%). Po ashtu, gratë që kishin përjetuar abuzime seksuale në fëmijëri (41,9%) kishin dy herë më shumë gjasa të pësonin dhunë nga jo-partneri që prej moshës 15 vjeçare, krahasuar me gratë që nuk kishin përjetuar abuzime seksuale në fëmijëri (17,7%). Këto gjetje tregojnë se gratë e abuzuara seksualisht në fëmijëri janë në rrezik të madh të pësojnë edhe forma të tjera të dhunës më vonë, në jetën e tyre. Studimet (Lalor & McElvaney, 2010; Humphrey & White, 2000) sugjerojnë që viktimizimi seksual në fëmijëri dhe/ose adoleshencë rrit mundësinë e viktimizimit seksual në moshë të rritur me 2 deri në 13,7 herë.

Dhuna në familje nuk prek vetëm gratë e rrahura dhe të keqtrajtuara, por ajo ka efekte negative edhe ndaj fëmijëve që janë viktimat e drejtpërdrejta dhe të tërthorta të dhunës në familje dhe dëshmitarë të dhunës në familje. Është e dokumentuar mirë se fëmijët vuajnë pasoja negative kur ekspozohen ndaj dhunës në shtëpi dhe familje. Të dhënat e studimit treguan se 47,7% e grave të moshës 18-74 vjeç, të cilat kishin fëmijë të moshës 0-17 vjeç që jetonin në familjet e tyre, raportuan

se kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë në familje dhe 40,1% se përjetonin “aktualisht” dhunë në familje (një nga pesë llojet matura të dhunës në familje të ushtruar nga partneri intim). Më konkretisht, 21,1% e grave që kanë përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja, dhe 11,7% që po përjetonin “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose seksuale kishin fëmijë të moshës 0-17 vjeç që jetonin në familjet e tyre.

Bazuar në të dhënat e ponderuara për gratë të cilat kishin fëmijë të moshës 0-17 vjeç që jetonin në familjet e tyre dhe numrin e fëmijëve që secila prej tyre kishte, u përlogarit se gjithsej ishin 591.476 fëmijë të moshës 0-17 vjeç që jetonin në familjet e vrojtuar. Studimi tregon se afërsisht 286.498 fëmijë të moshës 0-17 vjeç kishin më shumë gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje për shkak se nënat e tyre kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë në familje, dhe 246.707 fëmijë kishin më gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës në familje gjatë 12 muajve përpara intervistës për shkak se nënat e tyre përjetonin “aktualisht” dhunë në familje. Më konkretisht, 128.144 fëmijë të moshës 0-17 vjeç kishin më gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale në familjen e tyre, sepse nënat e tyre kishin përjetuar “ndonjëherë” dhunë fizike dhe/ose seksuale nga bashkëshorti/partneri, dhe 73.535 fëmijë të moshës 0-17 vjeç kishin shumë gjasa të ishin ekspozuar ndaj dhunës fizike dhe/ose seksuale gjatë 12 muajve përpara intervistës, sepse nënat e tyre përjetonin “aktualisht” dhunë fizike dhe/ose seksuale, ose të dyja.

Studimi tregon se midis grave të moshës 18-74 vjeç, 18,2% e tyre kanë përjetuar “ndonjëherë” dhe 2,4% “aktualisht” një ose më shumë se një nga katër llojet e dhunës fizike dhe/ose seksuale që në moshën 15 vjeçare nga dikush që është i ndryshëm nga bashkëshorti/i dashuri i tyre. Gratë kishin më shumë gjasa të përjetonin dhunë fizike nga jo-partneri (17,3% ndonjëherë, 2,3% aktualisht) se sa dhunë seksuale nga jo-partneri (1,3% ndonjëherë, 0,1% aktualisht). Gjithashtu midis grave që kanë përjetuar ndonjëherë dhunë seksuale nga jo-partneri që prej moshës 15 vjeçare, ato që identifikuan autorët e tyre identifikuan shokun e klasës/shkollës (15,1%), mësuesin (7,1%), miqtë /të njohurit (5,4%), babain/njerkun (5,2%), nënën/njerkën (4,4%), dhe të panjohurit (3,3%). Një për qindje e madhe e grave nuk pranoi ose refuzoi të identifikonin autorët e dhunës seksuale të ushtruar nga jo-partnerë.

4.4. Studimi Demografik dhe Shëndetësor në Shqipëri (SDSH) 2017-18: përfshin një sondazh të madh familjar në të gjithë vendin në Shqipëri. Ky studim përfshiu 15,823 familje dhe jep informacion për një gamë të gjerë të treguesve demografikë dhe shëndetësorë të fëmijëve të moshës 0-5 vjeç, si dhe burrave dhe grave të moshës 15-59 vjeç. Duke krahasuar dy raundet e SDSH-ve të zhvilluara në Shqipëri (raundi i parë u krye në 2008-09), ka të dhëna për një përmirësim të situatës së fëmijëve në lidhje me çështjen e abuzimit dhe keqtrajtimit. Për qindja e fëmijëve që u disiplinuan vetëm nga qasje jo të dhunshme ose “teknika” (të tilla si heqja e përfitimeve/privilegjeve për fëmijët, ose sigurimi i hapësirës për aktivitete alternative ndaj tyre, pa ushtruar dhunë verbale ose fizike) u rrit nga 22% në 37% ndërmjet 2008-09 dhe 2017-18. Për të njëjtën periudhë kohe, për qindja e fëmijëve që pësuan një lloj dhune fizike u ul nga 41% në 32%, ndërsa për qindja e fëmijëve që përjetuan ndonjë lloj agresioni psikologjik ose fizik u ul nga 75% në 48%. Lidhur me qëndrimet ndaj ndëshkimit fizik, vetëm 4% e të anketuarve meshkuj dhe 3% e të anketuarve femra besojnë se ndëshkimi fizik

është i domosdoshëm për edukimin e duhur të një fëmije, krahasuar me 13% të të anketuarve në raundin e parë të SDSH-së (kryer në 2008-09). Për më tepër, për qindja e fëmijëve nën 5 vjeç të cilët raportuan se ishin lënë nën kujdes të papërshtatshëm u ul disi (nga 11% në 7%) midis 2008-09 dhe 2017-18.

4.5. Një klikim larg: Përvojat e përdorimit të internetit nga fëmijët në Shqipëri, 2019²⁸: ky studim, i kryer nga UNICEF-i Shqipëri dhe IPSOS Stragic Marketing me një kampion përfaqësues të 1000 fëmijëve të moshës nga 9 deri në 17 vjeç që përdorin internetin në Shqipëri dhe 1000 prindërve ose kujdestarëve të tyre synon të sigurojë të dhëna të besueshme për përdorimin e internetit nga fëmijët përmes dimensioneve të mëposhtme: aksesit, praktikave dhe aftësitë e përdoruesit, mundësitë, rreziqet, mirëqenia dhe të drejtat, faktorët socialë dhe ekologjia digjitale. Studimi tregoi se fëmijët fillojnë të përdorin internetin rreth moshës 9 vjeç dhe ata kryesisht e përdorin atë përmes përdorimit të telefonave smartfon. Gjysma e fëmijëve (51%) që përdorin internet kanë akses të përhershëm në internet. Studimi eksploroj disa lloje rreziqesh në internet për fëmijët, siç janë: njohja me njerëz të rinj përmes ekspozimit të qëllimshëm ndaj përmbajtjes seksuale, negative dhe të dëmshme dhe keqpërdorimit të informacionit në internet.

Në përgjithësi, ekspozimi ndaj rreziqeve është më i përhapur tek fëmijët e moshës 15 deri në 17 vjeç, veçanërisht në mesin e atyre fëmijëve prindërit e të cilëve nuk përdorin internetin. 14% e fëmijëve raportuan se vitin e kaluar ata përjetuan diçka që i shqetësoi ose i mërzi në Internet, dhe 18% mes tyre nuk folën kurrë me askënd për këto përvoja. Një në pesë fëmijë gjatë vitit të kaluar ka takuar dikë në Internet, të cilin nuk e njeh. Fëmijët e moshës 15 deri 17 vjeç, dhe djemtë në veçanti, janë më të prirur për një sjellje të tillë. Gjithashtu, 16% e fëmijëve raportojnë se kanë takuar personalisht dikë të cilin e kishin takuar më parë në Internet. 9% e fëmijëve kishin të paktën një përvojë seksuale të padëshiruar në Internet gjatë vitit të kaluar. Më shpesh ky incident i referohej rastit kur dikush kërkonte informacion seksual rreth tyre, dhe kjo përfshinte më shpesh ish-partnerë, të rritur në familje të fëmijëve dhe miqve dhe të njohur nën moshën 18 vjeç që fëmijët i njihnin personalisht. Çdo fëmijë i pestë raportoi një përvojë ku ata kishin parë një përmbajtje në internet që lidhej me abuzimin ose dhunën, ndërsa 17% e fëmijëve panë përmbajtje ku njerëzit flisnin për dëmtime fizike. Një në 10 fëmijë shihet përmbajtje ku tema ishte se si të vetëvritesh. 16% e fëmijëve kanë qenë të ekspozuar ndaj përmbajtjes seksuale në internet: 55% e panë këtë përmbajtje sepse dëshironin, 71% e panë atë papritur, 45% e panë kur dikush ua tregoi atyre.

4.6. Studimi kombëtar mbi bulizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm në sistemin arsimor shqiptar, 2017²⁹: është realizuar nga Instrumenti Horizontal i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë në kuadër të Projektit “Lufta Kundër Bulizmit dhe Ekstremizmit në Sistemin Arsimor në Shqipëri” në bashkëpunim me Departamentin e Punës dhe Politikës Sociale dhe Institutin e Studimeve të Opinioneve Publik në Shqipëri. Qëllimi i këtij studimi ishte të siguronte një pasqyrë gjithëpërfshirëse të shpeshësisë, shkallës dhe natyrës së bulizimit dhe ekstremizmit në sistemin arsimor në Shqipëri. Studimi përfshihet 2377 nxënës nga klasa e IV-të deri në klasën e

28 <https://www.unicef.org/albania/media/2486/file/one%20click.pdf>

29 <https://rm.coe.int/albania-study-report-on-bullying-egn/1680732872>

XII-të, 3560 mësues dhe 970 prindër nga 144 shkolla në 12 rrethe të Shqipërisë. Afërsisht 19.4 % e nxënësve pohuan se janë të përfshirë në fenomenin e bulizmit 2-3 herë në muaj ose më shumë, dhe më tej 29% vetëm një ose dy herë në muaj.

Në përgjithësi, 9.7% e nxënësve e konsideruan veten viktimë të ngacmimit, 5.2% pranuan se kishin ngacmuar nxënës të tjerë dhe 4.3% kishin përjetuar të dyja, ngacmimin dhe të qenit viktimë e këtij fenomeni. Në tërësi, 60% e mësuesve konsideruan se ngacmimi ishte i pranishëm në shkollat e tyre përkatëse dhe 23% e prindërve pranuan se fëmijët e tyre kishin qenë viktimë të bulizmit në kohë të ndryshme dhe shkallë të ndryshme në shkollat e tyre. Rreth 78% e mësuesve konfirmojnë se “bien dakord” dhe “plotësisht dakord” se bulizmi verbal është forma më e përhapur e ngacmimit në shkollën e tyre, e ndjekur nga bulizmi psikologjik me 61% të rasteve. Pothuajse gjysma e mësuesve (51%) konfirmojnë se bulizmi virtual është forma më e shpeshtë që ndodh në shkollat e tyre. Në perceptimet e mësuesve, format e tjera të bulizmit racor dhe seksual ishin më pak të njohura.

Për më tepër, djemtë ishin më të përfshirë se vajzat në ngacmime dhe, interesante është, se ata e perceptonin veten kryesisht si ‘ngacmues’ (68%) sesa viktimë të bulizmit (52%). Përkundrazi, 48% e vajzave e perceptonin veten si viktimë të bulizmit, ndërsa 32% e konsideronin veten si ‘ngacmuese’. Lidhur me marrëdhënien e moshës, bulizmi ishte kryesisht i dukshëm tek fëmijët e moshës 15-16 vjeç, të ndjekur nga ata të moshës 10-11 vjeç. Për më tepër, kishte prova të një prevalencë më të lartë të bulizmit në mesin e nxënësve nga zonat urbane krahasuar me bashkëmoshatarët e tyre nga zonat rurale (përkatësisht 20% përkundrejt 17%).

Vendet specifike më të shpeshta ku ka ndodhur ngacmimi përfshinin klasat në kohën kur mësuesit nuk ishin të pranishëm (39%), pasuar nga zonat e argëtimit (hapësirat e sporteve dhe këndeve të lojërave) (38%). Për më tepër dhe çuditërisht, 13% e studentëve raportuan se bulizimi kishte ndodhur në klasa edhe në prani të mësuesve. Sa i përket llojit të ngacmimit, bulizmi psikologjik ishte forma më e raportuar (45%), e ndjekur nga bulizmi verbal (37%), ngacmimi fizik (33%) dhe bulizmi virtual/kibernetik (15%). Në lidhje me “përcaktuesit” e këtij fenomeni, pamja fizike (73.4%), gjuha dhe vështirësitë në të folur (67.6%) dhe prania e nxënësve fizikisht më të dobët (62.2%) u konsideruan nga mësuesit si faktorët kryesorë nxitës të bulizmit nëpër shkolla.

Analiza për dallimet gjinore tregon se në lidhje me format më të shpeshta të bulizmit, nuk ka dallime gjinore; megjithatë, bulizmi social është më i përhapuri tek djemtë me 24%, përkundrejt 15% të vajzave, si dhe bulizmi seksual i raportuar nga 24% e djemve dhe 13% e vajzave. Format e bulizmit për vajzat që raportuan se ishin ngacmuar 2-3 herë në muaj ose më shumë ishin psikologjike 54%, verbale (41%), fizike (34%), seksuale (18%), etj... Format e bulizimit për djem që ngacmohen 2-3 herë në muaj ose më shumë ishin psikologjike (49%), verbale (49%), fizike (38%), seksuale (30%), etj...

4.7. Abuzimi Seksual i Fëmijëve Brenda Rrethit të Besimit në Shqipëri, 2015³⁰: ky studim u realizua nga Terre des Homme me qëllim identifikimin e karakteristikave të abuzimit seksual në rrethin e

30 https://childhub.org/en/system/tdef/library/attachments/raporti_csa_alb_mail_2015-15-24.pdf?file=1&type=node&id=13542

besimit në Shqipëri dhe normat e tyre shoqërore, si dhe reagimin e sistemit në lidhje me abuzimin seksual të fëmijëve në praktikën ekzistuese. Gjetjet nga ky studim treguan se abuzimi seksual i fëmijëve në Shqipëri zakonisht ndodh brenda rrethit të tyre të besimit, që është një çështje shumë serioze dhe kërkon vëmendje të veçantë. Për më tepër, sipas gjetjeve të studimit, viktimat e abuzimit paragjykojnë dhe stigmatizohen nga shoqëria shqiptare. Normat sociale dhe qëndrimet tolerante në përgjithësi ndaj dhunës, ruajtja e sekretit familjar që vlerëson si të shenjtë privatësinë e familjes, ushqen sekretin dhe heshtjen, si dhe stigmatizimi i fëmijëve viktimat të abuzimit seksual në shoqëri bën që profesionistët, prindërit dhe fëmijët të hezitojnë ta raportojnë atë.

Sa i përket përgjigjes së sistemit, studimi raportoi mangësi në sistemin shqiptar të mbrojtjes së fëmijëve, duke përfshirë burimet e kufizuara njerëzore, mungesën e njohurive profesionale, pasiguritë në lidhje me rolet dhe përshtatjet e punës, problemet në menaxhimin e çështjeve, mungesën e bashkëpunimit ndërinstytucional, ndërhyrjet e pakta parandaluese, nënraportimi nga profesionistët dhe nevoja e paplotësuar për rehabilitim afatgjatë. Studimi tregoi se, në përgjithësi, ka mungesë të të dhënave sistematike dhe koherente në lidhje me rastet e fëmijëve të abuzuar seksualisht dhe, në veçanti, ato brenda rrethit të besimit. Për më tepër, ka prova të shkeljes së etikës nga media dhe mungesës së mekanizmave të monitorimit dhe ndëshkimit. Studimi dokumentoi disa norma shoqërore që kontribuojnë në padukshmërinë e abuzimit të fëmijëve në Shqipëri, veçanërisht kulturën e dhunës dhe tolerancën ndaj dhunës, stigmatizimin dhe diskriminimin e viktimave dhe diskriminimin gjinor.

4.8. Studimi mbi Sigurinë Online të Fëmijëve në Shqipëri, 2014³¹- ky studim, i kryer nga World Vision në Shqipëri, përfshiu 821 fëmijë të moshës 13-17 vjeç, përshkroi shkallën në të cilën fëmijët shqiptarë hyjnë në internet dhe rreziqet me të cilat përballen aktualisht gjatë aksesit në internet. Në mesin e fëmijëve që u përgjigjën në këtë sondazh, 44% e tyre raportuan se ata e përdorin internetin në baza ditore për të parë materiale pornografike, ndërsa, më tej, 62% e fëmijëve pranuan se kishin miq që kishin vizituar faqe interneti të ngjashme. Ngacmimi, vjedhja e fjalëkalimit dhe shikimet e paqëllimta të pornografisë pothuajse çdo ditë u raportuan nga 45% e të anketuarve. Për më tepër, 47% e pjesëmarrësve më të rinj ishin kontaktuar në internet nga një person i panjohur brenda vitit të fundit, i cili, në 40% të rasteve, ishte i huaj (d.m.th., jo shqiptar). Gjetje të tjera të rëndësishme nga ky studim kanë të bëjnë me mesazhet më problematike që fëmijët kishin marrë në internet, duke përfshirë materiale provokuese (26%), mesazhe ngacmuese (22%) dhe materiale të dhunshme ose agresive (11%). Në përgjithësi, ky raport theksoi qartë nevojën për forcimin dhe përmirësimin thelbësor të sigurisë në internet për fëmijët shqiptarë, të cilët janë mjaft të ekspozuar ndaj rreziqeve të ndryshme që përfshijnë përdorimin e internetit.

4.9. Mirëqenia dhe siguria e grave, OSBE 2019³²- ishte studimi i parë përfaqësues i kryer në Evropën Lindore për të siguruar të dhëna të krahasueshme në të gjithë rajonin. Studimi analizoi qëndrimet gjinore dhe përvojat e grave nga grupet e pakicave. Qëllimi i tij ishte të siguronte të dhëna të forta

31 <https://www.wvi.org/sites/default/files/Internet%20Safety%20OK.pdf>

32 https://www.osce.org/files/f/documents/c/8/434849_1.pdf

në mënyrë që të zhvillonte politika, strategji, programe dhe aktivitete më gjithëpërfshirëse dhe të bazuara në prova për të parandaluar dhe luftuar dhunën ndaj grave. Studimi aplikoi metodologji sasiore dhe cilësore. Një kampion përfaqësues i përbërë nga 1,858 gra të moshës 18-74 vjeç u përfshi në studim. Rezultatet e studimit tregojnë se 34% e grave tregojnë se kanë përjetuar të paktën një formë të ngacmimit seksual që kur ishin 15 vjeç. Gratë më të reja tregojnë se kanë përjetuar më shpesh ngacmime seksuale: 54% e 18-29 vjeçareve kanë pasur një ose më shumë përvoja të tillë që nga moshë 15 vjeç krahasuar me 27% të 40-49-vjeçareve, 25% të 50-59 vjeçareve dhe 18% e atyre mbi 60 vjeç. Ngacmimi seksual përfshin një gamë të gjerë përvojash. Forma më e zakonshme e treguar nga gratë që kur ishin 15 vjeç është frikësimi përmes vështrimit, i cili përmendet nga 21% e grave, e ndjekur nga pyetje ndërhyrëse në lidhje me jetën e tyre private (13%). Për qindja mesatare e grave në BE që deklaruan se kishin përjetuar ngacmime seksuale është 55%, duke filluar nga 24% në Bullgari, në 81% në Suedi. Shifra për Shqipërinë është më e ulët se mesatarja e BE-së dhe gjithashtu më e ulët se shifra për Kroacinë (41%). Vendet me tradita më të gjata të politikave të barazisë gjinore dhe fushatave të ndërgjegjësimit (vendet nordike dhe Evropa perëndimore) gjithashtu kanë nivele më të larta të grave që ndajnë përvojat e tyre të ngacmimeve seksuale.

Sipas rezultateve të sondazhit në përgjithësi, 11% tregojnë dhunë fizike dhe/ose seksuale nga një jo-partner që nga moshë 15 vjeç (2% në 12 muaj para sondazhit), ndërsa 1% thonë se u janë nënshtruar formave të dhunës seksuale (0.2% në 12 muaj para sondazhit). Njëzet e gjashtë për qind (26%) e grave thonë se kanë përjetuar një formë të dhunës fizike nga duart e një të rrituri para se të ishin 15 vjeç, e cila është e ngjashme me prevalencën mesatare në BE (27%). Prevalenca e dhunës psikologjike në fëmijëri ishte shumë më e ulët (4%). Dhuna seksuale në këtë moshë është edhe më pak e zakonshme, me më pak se 1% të grave që deklarojnë përvojat e tyre. Kjo është shumë më e ulët se mesatarja e BE-së prej 12%. Vendet ku gratë mendojnë se dhuna në familje është një çështje private dhe ku ekziston një kulturë e heshtjes kanë tendencë të raportojnë nivele më të ulëta të përvojave krahasuar me vendet që kanë një traditë më të gjatë të ndërgjegjësimit për dhunën ndaj grave. Gratë që kanë përjetuar ndonjë formë të dhunës në fëmijëri kanë më shumë gjasa të thonë se kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale nga ana e jo-partnerëve dhe partnerëve: 24% e grave që kanë përjetuar dhunë në fëmijëri thonë se kanë përjetuar dhunë fizike dhe/ose seksuale, krahasuar me 7% të atyre që nuk kanë përjetuar dhunë në fëmijëri. Për dhunën fizike dhe ose seksuale të partnerit intim, shifrat përkatëse janë 35% dhe 14%.

4.10. Hartëzimi i shërbimeve të dhunës seksuale në Ballkanin Perëndimor & Turqi, WAVE 2019³³

Ky studim i shkurtër u krye në periudhën korrik - shtator 2019 dhe përfshiu rishikimin e literaturës dhe zhvillimin e intervistave me 43 pjesëmarrës në gjashtë bashki të ndryshme të Shqipërisë (Durrës, Shkodër, Vlorë, Korçë, Sarandë dhe Elbasan). Të intervistuarit punonin për policinë e shtetit, shërbimin social shtetëror dhe bashkitë, spitalet rajonale dhe OJF-të e grave. Qëllimi ishte të sigurohej një pasqyrë e numrit të shërbimeve mbështetëse për viktimat e dhunës seksuale aktualisht në dispozicion në vendet partnere të projektit.

33 https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/2019/11/wave_svreport191119_web.pdf?la=en&vs=2900

Të gjithë të intervistuarit (100%) njohën përdhunimin dhe abuzimin seksual të fëmijëve si forma të dhunës seksuale, ndërsa 41 nga 43 të intervistuarit e njohën sulmin seksual si një formë të dhunës seksuale. Një numër i konsiderueshëm i të intervistuarve kanë shumë pak informacion në lidhje me shërbimet në dispozicion. 72% e të intervistuarve nuk kishin ndonjë informacion në lidhje me ekzistencën e ndonjë shërbimi ekskluzivisht për të mbështetur viktimat e dhunës seksuale, ndërsa 11% kishin informacion për linjat lokale të ndihmës.

Të gjithë pjesëmarrësit e intervistuar raportuan se shërbimet e specializuara të grave mbështesin viktimat e dhunës seksuale në Shqipëri. Ndër shërbimet që ofrohen më shpesh nga OJF-të e grave për viktimat e dhunës seksuale janë mbështetja sociale dhe psikologjike, ndihma mjekësore, mbështetja ligjore, ndihma ekonomike, strehimi, strehimi emergjent dhe akomodimi. Burimet kryesore të financimit të shërbimeve mbështetëse të grave vijnë nga donatorët, të ndjekur nga qeveria kombëtare dhe qeveria lokale.

4.11. Mbi ngacmimin seksual dhe llojet e tjera të dhunës me bazë gjinore në hapësirat publike në Shqipëri, IDRA 2018 dhe 2019³⁴

Ky studim u realizua nga IDRA Research & Consulting me mbështetjen e UN Women në bashki të ndryshme të vendit, në disa vite. Raporti i vitit 2019 përmban informacion nga dy bashki: Shkodra dhe Korça. Studimi i vitit 2018, u krye në tre bashki: Tiranë, Durrës dhe Fier.

Ndërsa UN Women, në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe organizatën Observatori për të Drejtat e Fëmijëve zhvilluan në 2016 studimin e parë pilot “Për ngacmimin seksual dhe dhunën seksuale ndaj grave dhe vajzave në hapësira urbane” në tre lagje të Tiranës. Gjetjet kyçe që dolën nga studimi i vitit 2016 e që çuan në vendimin për të përsëritur studimin në tri bashki në vitin 2018, ishin si më poshtë vijon: (1) Në përgjithësi, asnjë nga tri zonat e përzgjedhura të studimit 2016 në Tiranë nuk u konsiderua si vend i sigurtë në lidhje me ngacmimin seksual dhe dhunën seksuale ndaj grave dhe vajzave; (2) Mirëmbajtja e lagjeve (ndriçimi rrugor, hapësira e kufizuar midis ndërtesave, transporti publik) nuk konsiderohet e kënaqshme (3) Gratë, vajzat, burrat dhe djemtë e intervistuar kanë përshkruar ekzistencën e disa institucioneve publike kyçe si rajoni i policisë, qendrat shëndetësore/spitalet dhe bashkinë si të vendosura jo larg, por nuk kanë një perceptim të qartë mbi funksionet e tyre mbështetëse. (4) Rastet e ngacmimit seksual (me fjalë dhe me prekje) dhe të dhunës seksuale konfirmohen të kenë ndodhur në tre lagjet e përzgjedhura të Tiranës. Më shumë se një e treta e numrit të përgjithshëm të të anketuarve/-ave (ose 32% e të anketuarve femra gjithsej dhe 40% e të anketuarve meshkuj) mendonin se ngacmimi seksual ndodh kudo. Rastet për ngacmimin seksual klasifikohen si “të shpeshta” me 18 për qind të numrit të përgjithshëm të të anketuarve/-ave.

Në studimin e vitit 2018 të kryer nga IDRA Research and Consulting me mbështetjen e UN Women, metodologjia e përdorur ishte një kombinim i rishikimit të literaturës me studimin empirik për mbledhjen e të dhënave primare (intervista gjysmë të strukturuar të kryera me palët e interesuara,

34 https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20albania/attachments/publications/2019/05/english_web.pdf?la=en&vs=355

- Regresioni Logjistik Binar, i cili u përdor për të vlerësuar lidhjen midis variablave kryesore

që lidhen me pasojat e interesit (sjelljet shëndetësore/karakteristikat e stilit të jetesës të studentëve duke përfshirë duhanpirjen, përdorimin e alkoolit dhe drogës, marrëdhëniet seksuale dhe marrëdhëniet e hershme seksuale) dhe faktorëve përcaktues (determinantëve) të interesit që janë PNF-të, duke i kontrolluar për karakteristikat socio-demografike të studentëve dhe prindërve të tyre. Gjithashtu, u llogaritën dhe u raportuan raportet e gjasave (OR), intervalet e tyre të besimit (95% CI) dhe vlerat e rëndësisë statistikore (vlerat e P-së). Modelet e kontrolluara për të gjithë ndryshorët e pavaruar paraqesin vlerësimet e pavaruara (të kontrolluara) (OR-të, 95% CI dhe vlerat e P-së) për secilin faktor të stilit të jetesës (përdorim të duhanit, alkoolit, drogës, marrëdhënie seksuale dhe fillim të hershëm të marrëdhënieve seksuale) me PNF-të. Në të gjitha modelet e kontrolluara për të gjithë ndryshorët, u aplikua testi Hosmer-Lemeshow (goodness-of-fit test) për të testuar përshtatshmërinë e përgjithshme të modelit.

- Modeli i Përgjithshëm Linear, i cili u përdor për të llogaritur vlerat mesatare të PNF-ve (të shprehura në variabla/terma numerikë) sipas karakteristikave të ndryshme socio-ekonomike dhe disa karakteristika të lidhura me sjelljet shëndetësore të pjesëmarrësve të përfshirë në studimin e PNF-ve në 2011-12. Vlerat mesatare, intervalet përkatëse të besimit (95% CI) dhe vlerat e P-së u raportuan për modelet e kontrolluara për të gjithë ndryshorët e pavarur (pra, duke adresuar efektin/ndikimin e pavarur të secilit faktor në rezultatet kryesore të interesit).

REZULTATET

Kjo pjesë e rezultateve përmbledh shtrirjen (magnitudën) e PNF-ve dhe shpërndarjen e tyre sipas karakteristikave të përzgjedhura socio-ekonomike dhe faktorëve të stilit të jetesës (sjelljes) së studentëve, dhe më pas analizon faktorët përcaktues të pavarur të PNF-ve dhe praktikave të sjelljeve të pashëndetshme (përfshirë duhanpirjen, konsumin e alkoolit dhe drogës dhe fillimin e hershëm të marrëdhënieve seksuale).


PËRSHKRIMI I PREVALENCËS SË PNF-ve DHE FAKTORËVE TË STILIT TË JETESËS TEK STUDENTËT NË SHQIPËRI

Grafiku 1 paraqet prevalencën e disa karakteristikave të stilit të jetesës jo të shëndetshëm sipas gjinisë së studentëve të përfshirë në studimin PNF të kryer në Shqipëri në 2011-12.

Prevalenca e duhanpirjes aktuale ishte dukshëm më e lartë tek studentët meshkuj sesa tek ato femra (rreth 28% përkundrejt 19%, $P < 0,01$).

Në mënyrë të ngjashme, prevalenca e përdorimit problematik të alkoolit ishte dukshëm më e lartë tek meshkujt sesa tek studentet femra (rreth 15% përkundrejt 11%, $P = 0,04$).

Nga ana tjetër, vetëm 3.4% e meshkujve dhe 3.1% e femrave kishin pasur ndonjëherë ndonjë problem me përdorimin drogave, pa ndonjë provë të dallimeve domethënëse gjinore.




Grafiku 2 paraqet shpërndarjen e disa karakteristikave të lidhura me marrëdhëniet seksuale të studentëve sipas gjinisë.


Prevalenca e marrëdhënieve seksuale *gjatë gjithë jetës* ishte dukshëm më e lartë tek meshkujt krahasuar me femrat (rreth 74% përkundrejt 43%, $P < 0,01$).

Midis studentëve që raportuan të kishin kryer marrëdhënie seksuale, përqindja e djemve që kishin filluar marrëdhëniet seksuale në moshën ≤ 16 vjeç ishte dukshëm më e lartë krahasuar me vajzat e së njëjtës moshë (rreth 45% përkundrejt 31%, $P = 0,05$).

Nuk kishte ndryshim domethënës tek djemtë përkundrejt vajzave në lidhje me pasjen e më shumë se 3 partnerëve seksualë (rreth 27% përkundrejt 23%; $P = 0,31$).



Grafiku 3 paraqet prevalencën e disa PNF-ve sipas gjinisë së studentëve të përfshirë në studimin PNF të kryer në Shqipëri në 2011-12.



Në total, prevalenca e abuzimit fizik dhe seksual gjatë 18 viteve të para të jetës (referuar si *gjatë fëmijërisë*) ishte përkatësisht 41.5% dhe 14.7%. Rreth 8.8% e meshkujve dhe 4.7% e femrave kanë kryer marrëdhënie seksuale me një të rritur gjatë fëmijërisë së tyre. Prevalenca e abuzimit emocional gjatë fëmijërisë ishte e ngjashme si në studentët meshkuj ashtu edhe në ato femra (51%).


Në total, rreth 30% e studentëve kishin qenë dëshmitarë të keqtrajtimit të nënës në familje dhe rreth 40% e tyre kishin përjetuar bulizmin, si dhe ishin përfshirë në grindje fizike gjatë fëmijërisë - karakteristika të cilat ishin dukshëm më të përhapura tek meshkujt sesa tek femrat.

Në 2.4% të meshkujve dhe 4.5% të femrave u raportua të paktën një episod i përpjekjes për të kryer vetëvrasje. Rreth 8% e femrave raportuan të paktën një episod të shtatzënisë së padëshiruar.

Grafiku 4 paraqet prevalencën e të qenit dëshmitar i dhunës në familje sipas gjinisë së studentëve të përfshirë në studimin PNF në Shqipëri në 2011-2012.

Mes meshkujve dhe femrave nuk kishte asnjë ndryshim në lidhje me të qenit dëshmitar i dhunës në familje gjatë 18 viteve të para të jetës (respektivisht 31% përkundrejt 30%, $P = 0.34$).

Gjatë 18 viteve të para të jetës, rreth 3% e studentëve meshkuj kishin jetuar me dikë që ka qenë në burg në krahasim me 4% të studenteve femra ($P = 0.14$). Nga ana tjetër, rreth 8% e studentëve meshkuj i kishin prindërit të ndarë, krahasuar me 6% të studenteve femra ($P = 0.11$).



Në mënyrë të përmbledhur, përvojat negative më të hasura gjatë fëmijërisë të raportuara në studimin PNF 2011-12 ishin: abuzimi psikologjik/emocional (51%) dhe abuzimi fizik (42%). Djemtë ishin më të neglizhuar fizikisht dhe emocionalisht në krahasim me vajzat, dhe këto ndryshime ishin statistikisht të rëndësishme ($P < 0,01$). I rëndësishëm është fakti që rreth 19.3% e meshkujve dhe 14.5% e femrave raportuan të paktën katër PNF.

ANALIZA E THELLUAR (SEKONDARE) E STUDIMIT PNF, 2011-2012

Më poshtë paraqiten gjetjet kryesore të analizës sekondare të studimit PNF, 2011-2012. Secili prej seksioneve më poshtë paraqet lidhje (shoqërim) të pavaruara të disa përvojave negative gjatë fëmijërisë me karakteristikat socio-demografike dhe faktorët e sjelljes (stilit të jetesës) të studentëve.

Dëshmitar i dhunës në familje, karakteristikat socio-ekonomike dhe faktorët e rrezikut të lidhur me stilin e jetesës (sjelljet)

Tabela 1 paraqet lidhjen (shoqërimin) e pavarur të të qenit dëshmitar i dhunës në familje gjatë 18 viteve të para të jetës (variabli kryesor) me karakteristikat demografike dhe socio-ekonomike si dhe faktorët e lidhur me stilin e jetesës (sjelljet). Të gjitha variablat (faktorët socio-demografikë dhe karakteristikat e stilit të jetesës) të paraqitura në Tabelën 1, u kontrolluan njëkohësisht në modelet e regresionit logjistik binar. Prandaj, këto vlerësime përfaqësojnë kontributin (rolin) e pavarur të secilit faktor në lidhje me prevalencën e të qenit dëshmitar i dhunës në familje gjatë fëmijërisë.

Lidhur me lidhjen (shoqërimin) midis të qenit dëshmitar i dhunës në familje dhe karakteristikave socio-demografike të studentëve dhe prindërve të tyre, spikatën gjetjet e mëposhtme:

- Nuk kishte ndonjë ndryshim të dukshëm gjinor dhe/ose diferencë moshore në nivelet e vetë-raportuara të të qenit dëshmitar i dhunës në familje (në të dyja rastet, vlerat e $P > 0,05$).
- Nga ana tjetër, vendbanimi në zonë rurale dhe vendlindja ishin të dyja korrelacione të pavarura të të qenit dëshmitar i dhunës në familje (përkatësisht $OR = 2.5$, $95\% CI = 1.6-3.2$

dhe OR = 2.3, 95% CI = 1.7-3.0).

- Arsimimi i prindërve ishte i lidhur fuqishëm, në mënyrë lineare negative me të qënit dëshmitar i dhunës (si për nënën ashtu edhe për babanë: $P < 0.001$).
- Papunësia e babait ishte e lidhur pozitivisht dhe fuqishëm me të qënit dëshmitar i dhunës në familje (OR = 4.6, 95% CI = 3.9-6.1), gjetje e cila nuk ishte e evidente për statusin e punësimit të nënës.
- Niveli i ulët i të ardhurave ishte një korrelacion i rëndësishëm e i pavarur i të qënit dëshmitar i dhunës në familje (OR = 2.8, 95% CI = 1.9-3.9), ndërsa niveli mesatar i të ardhurave nuk ishte i lidhur me këtë dukuri.

Përsa i përket lidhjes (shoqërimit) të të qënit dëshmitar i dhunës në familje me karakteristikat e stilit të jetesës/sjelljes së studentëve, u konstatuan gjetjet kryesore:

- Kishte një lidhje (shoqërim) pozitiv dhe të rëndësishëm të të qënit dëshmitar i dhunës në familje me duhanpirjen aktuale të studentëve (OR = 1.9, 95% CI = 1.2-2.4).
- Në mënyrë të ngjashme, të qënit dëshmitar i dhunës në familje lidhej ndjeshëm dhe në mënyrë të pavarur me përdorimin problematik të alkoolit tek studentët (OR = 1.5, 95% CI = 1.1-2.2).
- Po kështu, të qënit dëshmitar i dhunës në familje lidhej në mënyrë të pavarur me përdorimin e drogave (OR = 1.5, 95% CI = 1.0-2.7), gjetje e cila ishte statistikisht e rëndësishme në kufi ($P = 0.06$).
- Për më tepër, kryerja e marrëdhënieve seksuale gjatë gjithë jetës kishte një lidhje të rëndësishme e të pavarur me të qënit dëshmitar i dhunës në familje (OR = 1.9, 95% CI = 1.7-3.0).
- Nga ana tjetër, fillimi i hershëm i marrëdhënieve seksuale dhe/ose numri i partnerëve seksualë gjatë gjithë jetës nuk ishin të lidhura në mënyrë domethënëse me të qënit dëshmitar i dhunës në familje.

Tabela 1. Lidhja (shoqërimi) e pavaruar e të qenit dëshmitar i dhunës me faktorët socio-demografikë dhe ata të lidhur me sjelljen e studentëve; modelet e regresionit logjistik të kontrolluar për shumë ndryshore

KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE FAKTORËT E STILIT TË JETESËS	OR*	95%CI*	P*
Gjinia:			
Meshkuj	1.04	0.79-1.41	0.714
Femra	1.00	Referencë	
Grup-mosha:			0.238 (3)[†]
18-19 vjeç	0.71	0.49-1.19	0.194
20-21 vjeç	0.69	0.46-1.21	0.138
22-23 vjeç	0.63	0.42-1.17	0.165
≥24 vjeç	1.00	Referencë	-
Vendlindja:			
Zonë rurale	2.31	1.72-2.97	<0.001
Zonë urbane	1.00	Referencë	
Vendbanimi:			
Zonë rurale	2.47	1.59-3.23	<0.001
Zonë urbane	1.00	Referencë	
Arsimimi i babait:			<0.001 (2)
I ulët (0-8 years)	4.38	3.29-7.62	<0.001
I mesëm (9-12 years)	2.31	1.82-3.87	<0.001
I lartë (>12 years)	1.00	Referencë	-
Arsimimi i nënës:			<0.001 (2)
I ulët (0-8 years)	4.79	2.93-6.89	<0.001
I mesëm (9-12 years)	1.69	1.23-2.17	0.002
I lartë (>12 years)	1.00	Referencë	-
Statusi i punësimit të babait:			
I papunë	4.61	3.84-6.12	<0.001
Pjesa tjetër	1.00	Referencë	
Statusi i punësimit të nënës:			
E punësuar	1.08	0.68-1.24	0.412
Pjesa tjetër	1.00	Referencë	
Niveli i të ardhurave:			<0.001 (2)
I ulët	2.75	1.93-3.87	<0.001
I mesëm	1.09	0.76-2.14	0.538
I lartë	1.00	Referencë	-
Duhanpirje aktuale:			
Po	1.92	1.19-2.37	<0.001
Jo	1.00	Referencë	
Probleme me alkoolin:			
Po	1.49	1.09-2.23	0.031
Jo	1.00	Referencë	

Përdorimi i drogës:			
Po	1.54	1.03-2.72	0.059
Jo	1.00	Referencë	
Kryerja e marrëdhënieve seksuale gjatë gjithë jetës:			
Po	1.93	1.68-2.97	<0.001
Jo	1.00	Referencë	
Fillim i hershëm i marrëdhënieve seksuale			
≤16 vjeç	1.07	0.59-1.37	0.635
>16 vjeç	Referencë	-	
Numri i partnerëve seksualë gjatë gjithë jetës			
>3 partnerë	1.09	0.68-1.52	0.821
≤3 partnerë	Referencë	-	

* Raporti i Gjasave (OR: dëshmi e dhunës përkundrejt jo dëshmi e dhunës), intervali i besimit 95% (95%CI) vlerat e p-së nga analiza e Regresionit Logjistik Binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur. Të gjithë ndryshorët e paraqitur në tabelë u përfshinë njëherësh në modelet e regresionit logjistik.

† Vlera e përgjithshme e P-së dhe shkallët e lirisë (në kllapa).

Abuzimi fizik, karakteristikat socio-demografike dhe faktorët e stilit të jetesës/sjelljes

Tabela 2 paraqet lidhjen (shoqërimin) e abuzimit fizik të studentëve gjatë 18 viteve të para të jetës (variabli kryesor) me karakteristikat demografike dhe socio-ekonomike, si dhe stilin e jetesës/faktorët e sjelljes. Të gjitha variablat (faktorët socio-demografikë dhe karakteristikat e stilit të jetesës) të paraqitura në Tabelën 2, u kontrolluan njëkohësisht në modelet e regresionit logjistik binar. Prandaj, vlerësimet përfaqësojnë kontributin (rolin) e pavarur të secilit faktor në lidhje me nivelin e abuzimit fizik të përjetuar të studentëve gjatë fëmijërisë.

Bazuar në këtë analizë, lidhur me lidhjen (shoqërimin) e abuzimit fizik të përjetuar gjatë fëmijërisë dhe karakteristikave socio-demografike të studentëve dhe prindërve të tyre, spikatën gjetjet e mëposhtme:

- Ekzistonte një ndryshim statistikisht i rëndësishëm i diferencave gjinore në nivelet e vetë-raportuara të abuzimit fizik, ku meshkujt raportuan një prevalencë më të lartë të abuzimit fizik sesa femrat (OR = 1.3, 95% CI = 1.1-1.7).
- Nga ana tjetër, nuk kishte asnjë lidhje (shoqërim) të abuzimit fizik me grup-moshën e studentëve.
- Si vendlindja, ashtu edhe vendbanimi rural ishin të lidhura pozitivisht me dhunën fizike të përjetuar të studentëve (përkatesisht OR = 1.4, 95% CI = 1.0-2.0 dhe OR = 1.6, 95% CI = 1.1-2.1).
- Niveli i ulët arsimor për të dy prindërit ishte i lidhur pozitivisht me abuzimin fizik të përjetuar të studentëve (përkatesisht OR = 2.1, 95% CI = 1.4-2.9 dhe OR = 1.9, 95% CI = 1.5-2.9).
- Papunësia e babait ishte e lidhur pozitivisht me abuzimin fizik të studentëve (OR = 1.7, 95% CI = 1.2-2.3), gjetje e cila nuk u has për statusin e punësimit së nënës.

- Për më tepër, niveli i ulët i të ardhurave ishte një parashikues i rëndësishëm i abuzimit fizik midis studentëve (OR = 1.6, 95% CI = 1.2-2.6).
- Gjithashtu, kishte një lidhje (shoqërim) të fortë pozitive të abuzimit fizik të studentëve me të qenit dëshmitar i dhunës në familje gjatë fëmijërisë (OR = 2.7, 95% CI = 2.3-3.5).

Nga ana tjetër, lidhur me lidhjen (shoqërimin) e abuzimit fizik gjatë fëmijërisë me karakteristikat e stilit të jetesës/sjelljes së studentëve, u konstatuan gjetjet kryesore:

- Kishte një lidhje të fortë pozitive të abuzimit fizik me duhanpirjen aktuale (OR = 3.2, 95% CI = 2.8-4.6).
- Për më tepër, kishte prova të një lidhjeje (shoqërimi) shumë të fortë me përdorimin problematik të alkoolit (OR = 4.2, 95% CI = 2.9-6.2).
- Përdorimi i drogave ishte gjithashtu i lidhur në mënyrë të konsiderueshme me abuzimin fizik të përjetuar të studentëve gjatë fëmijërisë së tyre (OR = 1.9, 95% CI = 1.2-3.1).
- Lidhja (shoqërimi) midis abuzimit fizik të studentëve me kryerjen e marrëdhënieve seksuale gjatë gjithë jetës ishte mjaft e fortë (OR = 14.6, 95% CI = 10.6-17.3).
- Fillimi i hershëm i marrëdhënieve seksuale ishte gjithashtu i lidhur pozitivisht me abuzimin fizik midis studentëve (OR = 1.8, 95% CI = 1.1-2.3).
- Për më tepër, pasja e më shumë se 3 partnerëve seksualë ishte e lidhur në mënyrë të konsiderueshme me abuzimin fizik të studentëve (OR = 1.6, 95% CI = 1.2-2.7).

Tabela 2. Lidhja (shoqërimi) e pavarur e abuzimit fizik me faktorët socio-demografikë dhe ata të lidhur me sjelljen e studentëve; modelet e regresionit logjistik të kontrolluar për shumë ndryshore

KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE FAKTORËT E STILIT TË JETESËS	OR*	95%CI*	P*
Gjinia:			
Meshkuj	1.34	1.09-1.72	0.041
Femra	1.00	Referencë	
Grup-mosha:			0.571 (3)[†]
18-19 vjeç	0.89	0.57-1.63	0.734
20-21 vjeç	1.17	0.69-1.72	0.462
22-23 vjeç	1.04	0.37-1.92	0.894
≥24 vjeç	1.00	Referencë	-
Vendlindja:			
Zonë rurale	1.41	1.03-1.96	0.042
Zonë urbane	1.00	Referencë	
Vendbanimi:			
Zonë rurale	1.62	1.12-2.06	0.028
Zonë urbane	1.00	Referencë	

Arsimimi i babait:			<0.001 (2)
I ulët (0-8 years)	2.14	1.37-2.93	0.001
I mesëm (9-12 years)	1.37	0.94-1.63	0.087
I lartë (>12 years)	1.00	Referencë	-
Arsimimi i nënës:			<0.001 (2)
I ulët (0-8 years)	1.94	1.47-2.91	<0.001
I mesëm (9-12 years)	1.12	0.77-1.49	0.538
I lartë (>12 years)	1.00	Referencë	-
Statusi i punësimit të babait:			
I papunë	1.72	1.23-2.26	<0.001
Pjesa tjetër	1.00	Referencë	
Statusi i punësimit të nënës:			
E punësuar	1.14	0.82-1.93	0.341
Pjesa tjetër	1.00	Referencë	
Niveli i të ardhurave:			0.001 (2)
I ulët	1.62	1.18-2.63	<0.001
I mesëm	1.04	0.79-1.82	0.640
I lartë	1.00	Referencë	-
Dëshmitar i dhunës në familje gjatë 18 viteve të para të jetës:			
Po	2.74	2.31-3.47	<0.001
Jo	1.00	Referencë	
Duhanpirje aktuale:			
Po	3.21	2.78-4.57	<0.001
Jo	1.00	Referencë	
Probleme me alkoolin:			
Po	4.19	2.94-6.16	<0.001
Jo	1.00	Referencë	
Përdorimi i drogës:			
Po	1.94	1.22-3.05	0.003
Jo	1.00	Referencë	
Kryerja e marrëdhënieve seksuale gjatë gjithë jetës:			
Po	14.61	10.63-17.28	<0.001
Jo	1.00	Referencë	
Fillim i hershëm i marrëdhënieve seksuale			
≤16 vjeç	1.75	1.06-2.32	0.002
>16 vjeç	Referencë	-	
Numri i partnerëve seksualë gjatë gjithë jetës			
>3 partnerë	1.63	1.19-2.67	0.001
≤3 partnerë	Referencë	-	

* Raporti i Gjasave (OR: abuzim fizik përkundrajt jo abuzim fizik), intervali i besimit 95% (95%CI) vlerat e p-së nga analiza e Regresionit Logjistik Binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur. Të gjithë ndryshorët e paraqitur në tabelë u përfshinë njëherësh në modelet e regresionit logjistik.

*Vlera e përgjithshme e P-së dhe shkallët e lirisë (në kllapa).

Vlerat mesatare të pavarura të Përvojave Negative gjatë Fëmijërisë (PNF) me faktorët socio-demografikë dhe ata të lidhur me sjelljen e studentëve; – gjetje nga Modelet e Përgjithshme Lineare të kontrolluara për shumë ndryshore

Tabela 3 paraqet vlerat mesatare të kontrolluara për shumë ndryshore të përvojave Negative gjatë Fëmijërisë (PNF) sipas karakteristikave socio-demografike dhe faktorëve të lidhur me sjelljen e studentëve. Të gjithë ndryshorët e paraqitur në Tabelën 3 u kontrolluan njëkohësisht në Modelin e Përgjithshëm Linear (GLM). Prandaj, vlerësimet e paraqitura në Tabelën 3 përfaqësojnë kontributin (rolin) e pavarur të secilit faktor në lidhje me numrin mesatar të PNF-ve të përjetuar nga studentët gjatë fëmijërisë së tyre.

Përsa i përket lidhjes (shoqërimit) të numrit të PNF-ve të studentëve me karakteristikat socio-demografike të studentëve dhe prindërve të tyre, u konstatuan gjetjet e mëposhtme:

- Mesatarja e numrit të PNF-ve ishte dukshëm më e lartë tek meshkujt krahasuar me studentet femra (përkatesisht 2.29 përkundrejt 1.73; $P < 0.01$).
- Anasjelltas, mesatarja e numrit të PNF-ve nuk ishte e lidhur në mënyrë të konsiderueshme me grup-moshën e studentëve, pavarësisht hasjes së një mesatareje më të lartë të PNF-ve tek djemtë e moshës ≥ 24 vjeç.
- Studentët e lindur në zonat rurale dhe veçanërisht ata që banojnë në këto zona shfaqën vlera më të larta të numrit mesatar të PNF-ve krahasuar me shokët e tyre që banojnë në zonat urbane (të dyja $P < 0,01$).
- Mesatarja e PNF-ve ishte dukshëm më e lartë tek studentët, prindërit e të cilëve ishin me një nivel të ulët arsimor, (si për nënën ashtu edhe për babain) krahasuar me ata që i kishin prindërit me arsim të mesëm, dhe veçanërisht me ata me arsim të lartë (të dy $P < 0,01$).
- Mesatarja e PNF-ve ishte dukshëm më e lartë tek studentët që i kishin baballarët të papunë krahasuar me ata që i kishin të punësuar (përkatesisht 2,63 përkundrejt 1,71; $P < 0,01$).
- Gjithashtu, mesatarja e PNF-ve ishte dukshëm më e lartë tek studentët që vinin nga familje me nivel të ulët të ardhurash krahasuar me ata që vinin nga familje me nivel të lartë të ardhurash (përkatesisht 2,64 përkundrejt 1,67; $P < 0,01$).

Nga ana tjetër, lidhur me lidhjen (shoqërimin) e numrit të PNF-ve të përjetuar gjatë fëmijërisë së studentëve me karakteristikat e stilit të jetësës (sjelljes) të tyre, u konstatuan gjetjet e mëposhtme:

- Numri mesatar i PNF-ve ishte dukshëm më e lartë tek studentët duhanpirës krahasuar me ata që nuk pinë duhan (përkatesisht 3.04 përkundrejt 1.59; $P < 0.01$).
- Lidhja (shoqërimi) me alkoolin ishte edhe më e fortë: numri mesatar i PNF-ve ishte dukshëm më e lartë tek studentët që raportuan probleme me alkoolin krahasuar me ata që nuk kishin ndonjë problem të tillë (respektivisht 4.16 përkundrejt 1.57; $P < 0.01$).
- Lidhja e përdorimit të drogave ishte edhe më e fortë: numri mesatar i PNF-ve ishte dukshëm më e lartë tek studentët që konsumonin drogë krahasuar me ata që nuk e përdornin atë

(përkatësisht 5,09 përkundrejt 1,67; $P < 0,01$).

- Për më tepër, numri mesatar i PNF-ve ishte dukshëm më i lartë tek studentët që raportuan kryerjen e marrëdhënieve seksuale gjatë gjithë jetës krahasuar me shokët e tyre që nuk kishin kryer kurrë marrëdhënie seksuale (përkatësisht 2.93 përkundrejt 0.91; $P < 0.01$).
- Gjithashtu, numri mesatar i PNF-ve ishte dukshëm më i lartë tek studentët që raportuan fillim të hershëm të marrëdhënieve seksuale (para moshës 16 vjeç) krahasuar me ata që kishin filluar jetën seksuale pas kësaj moshe (përkatësisht 3.27 përkundrejt 2.63; $P < 0.01$).
- Për më tepër, numri mesatar i PNF-ve ishte më i lartë tek studentët që raportuan pasjen e më shumë se 3 partnerëve seksualë krahasuar me ata që raportuan më pak partnerë të tillë (përkatësisht 3.39 përkundrejt 2.27, $P < 0.01$).

Tabela 3. Vlerat mesatare (Modeli i Përgjithshëm Linear i kontrolluar për shumë ndryshorë) të Përvojave Negative gjatë Fëmijërisë (PNF) sipas karakteristikave socio-demografike dhe faktorëve të lidhur me sjelljen

KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE DHE FAKTORËT E STILIT TË JETESËS	MESATARJA *	95%CI *	P *
Gjinia:			
Meshkuj	2.29	1.98-2.87	0.002
Femra	1.73	1.68-2.09	
Grup-mosha:			0.642[†]
18-19 vjeç	1.77	1.62-1.95	0.096
20-21 vjeç	1.89	1.68-2.18	0.245
22-23 vjeç	1.93	1.80-2.21	0.413
≥24 vjeç	2.27	1.91-2.73	-
Vendlindja:			
Zonë rurale	2.37	2.09-2.81	0.002
Zonë urbane	1.78	1.63-2.03	
Vendbanimi:			
Zonë rurale	2.69	2.23-3.04	0.001
Zonë urbane	1.86	1.71-2.19	
Arsimimi i babait:			<0.001
I ulët (0-8 years)	2.39	2.28-2.81	<0.001
I mesëm (9-12 years)	1.84	1.81-2.08	0.087
I lartë (>12 years)	1.68	1.54-1.87	-
Arsimimi i nënës:			<0.001
I ulët (0-8 years)	2.49	2.28-2.92	<0.001
I mesëm (9-12 years)	1.91	1.71-2.18	0.657
I lartë (>12 years)	1.79	1.65-1.97	-
Statusi i punësimit të babait:			
I papunë	2.63	2.36-2.81	<0.001
Pjesa tjetër	1.71	1.59-1.79	

Statusi i punësimit të nënës:			
E punësuar	1.82	1.72-2.13	0.425
Pjesa tjetër	1.94	1.75-2.19	
Niveli i të ardhurave:			
I ulët	2.64	2.31-2.93	<0.001
I mesëm	1.92	1.79-2.09	0.083
I lartë	1.67	1.44-1.89	-
Duhanpirje aktuale:			
Po	1.59	1.34-1.66	<0.001
Jo	3.04	2.88-3.21	
Probleme me alkoolin:			
Po	1.57	1.48-1.67	<0.001
Jo	4.16	3.29-4.39	
Përdorimi i drogës:			
Po	1.67	1.61-1.79	<0.001
Jo	5.09	4.86-5.67	
Kryerja e marrëdhënieve seksuale gjatë gjithë jetës:			
Po	0.91	0.73-0.99	<0.001
Jo	2.93	2.76-3.29	
Fillim i hershëm i marrëdhënieve seksuale			
≤16 vjeç	3.27	2.91-3.19	0.007
>16 vjeç	2.63	2.57-3.05	
Numri i partnerëve seksualë gjatë gjithë jetës			
>3 partnerë	2.27	2.19-2.76	0.001
≤3 partnerë	3.39	2.97-3.64	

* Vlerat mesatare (variacioni i totalit të PNF-ve ishte nga 0 [asnjë] në 8 [tetë ngjarje negative]), 95% intervali i besimit (95%CI) dhe vlerat e p-së sipas Modelit të Përgjithshëm Linear (GML) të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur. Të gjithë ndryshorët e paraqitur në tabelë u përfshinë njëherësh në modelet e GLM.

† Vlera e përgjithshme e p-së.

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE TË ANALIZËS SEKONDARE (TË THELLUAR) TË STUDIMIT PNF NË SHQIPËRI, 2011-12

Më poshtë janë përmbledhur gjetjet kryesore të analizës sekondare (të thelluar) të studimit PNF të kryer në Shqipëri, 2011-2012.

- Prevalenca e abuzimit fizik dhe seksual gjatë 18 viteve të para të jetës (gjatë fëmijërisë) ishte përkatësisht 41.5% dhe 14.7%.
- Rreth 30% e studentëve kanë qenë dëshmitarë të dhunës në familje gjatë 18 viteve të para të jetës.
- Lidhje (shoqërime) të rëndësishme dhe të pavarura të të qenit dëshmitar i dhunës tek studentët e përfshirë në këtë analizë kanë të bëjnë me: vendlindjen dhe/ose vendbanimin rural, nivelin e ulët të arsimit të prindërve, papunësinë e babait, të ardhurave të ulëta

familjare, duhanpirjes aktuale, problemeve me alkoolin, përdorimin e drogave, dhe marrëdhëniet seksuale *gjatë gjithë jetës*.

- Nga ana tjetër, lidhjet (shoqërimet) e pavarura të abuzimit fizik të studentëve përfshinin gjininë mashkullore, vendlindjen dhe/ose vendbanimin rural, nivelin e ulët arsimor të prindërve, papunësinë e babait, të ardhurat e ulëta familjare, të qëniet dëshmitar i dhunës në familje, duhanpirjen aktuale, problemet me alkoolin, përdorimin e drogave, marrëdhëniet seksuale *gjatë gjithë jetës*, fillimin e hershëm të marrëdhënieve seksuale dhe një numër të lartë të partnerëve seksualë.
- Në mënyrë të ngjashme, lidhjet (shoqërimet) pozitive të numrit mesatar të PNF-ve përfshinë gjininë mashkullore, vendlindjen dhe vendbanimin rural, nivelin e ulët arsimor të prindërve, papunësinë e babait, të ardhurat e ulëta familjare, të qëniet dëshmitar i dhunës në familje, duhanpirjen aktuale, problemet me alkoolin, përdorimin e drogave, marrëdhëniet seksuale *gjatë gjithë jetës*, fillimin e hershëm të marrëdhënieve seksuale dhe një numër të lartë të partnerëve seksualë.

5.3 MIRËQENIA DHE SIGURIA E GRAVE, 2018

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM MBI STUDIMIN “MIRËQENIA DHE SIGURIA E GRAVE”, KRYER NË SHQIPËRI NË 2018

Studimi “Mirëqenia dhe siguria e grave” u krye në Shqipëri në vitin 2018, duke përfshirë një komponent sasior (studim transversal), dhe një cilësor (intervista me persona kyçë, intervista të thelluara me gra dhe diskutime në fokus grupe).

Studimi transversal (komponenti sasior) përfshiu një mostër përfaqësuese prej 1,858 grash shqiptare të moshës 18-74 vjeç. Qëllimi i këtij studimi ishte të vlerësonte prevalencën dhe pasojat e dhunës nëpërmjet një modeli kampionimi me shumë faza, të shtresëzuar dhe me probabilitet rastësor.

Disa gjetje interesante (përshkruese) të studimit transversal, bazuar në vetë-raportimin e grave janë përmbledhur më poshtë: (burimi: OSBE, 2019)³⁷:

- Prevalenca e çdo forme dhune ndaj grave të përjetuar që nga mosha 15 vjeç ishte 67%, ndërsa dhuna e përjetuar gjatë 12 muajve të fundit para studimit ishte 39%.
- Prevalenca e dhunës psikologjike nga partneri intim e përjetuar nga gratë që nga mosha 15 vjeç ishte 62%, dhe 29% për 12 muajt e fundit para studimit.
- Prevalenca e ngacmimit seksual të përjetuar nga gratë që nga mosha 15 vjeç ishte 34%, dhe 17% për 12 muajt e fundit para studimit.
- Prevalenca e dhunës fizike dhe/ose seksuale nga partneri intim ose jo-partneri, të përjetuara nga gratë që nga mosha 15 vjeç ishte 22%, dhe 8% për 12 muajt e fundit para studimit.

37 OSBE-led survey on violence against women: Well-being and safety of women. Albania, 2019. ISBN: 978-3-903128-20-0. https://www.OSBE.org/files/f/documents/c/8/434849_1.pdf.

- Prevalenca e përndjekjes së përjetuar nga gratë që nga moshë 15 vjeç ishte 13%, dhe 4% për 12 muajt e fundit para studimit.
- Prevalenca e *dhunës fizike dhe/ose seksuale* nga partneri jo intim të përjetuara nga gratë që nga moshë 15 vjeç ishte 11%, dhe 3% për 12 muajt e fundit para studimit.
- Dhuna psikologjike nga partneri intim ishte forma më e përhapur e dhunës së raportuar nga gratë e përfshira në studim. Shantazhi/abuzimi i fëmijëve përbënte 11%, dhuna ekonomike 22%, sjelljet abuzive 41% dhe sjelljet kontrolluese 50%.
- Prevalenca e dhunës fizike nga partneri intim e përjetuar nga gratë që nga moshë 15 vjeç ishte 19%. Kështu, një në pesë gra të intervistuar raportuan se kishin përjetuar dhunë fizike nga partnerët e tyre intimë.
- Prevalenca e dhunës seksuale nga partneri intim e përjetuar nga gratë që nga moshë 15 vjeç ishte 4%.

QËLLIMI I ANALIZËS SEKONDARE (TË THELLUAR) TË ANKETËS SË DREJTUAR NGA OSBE-JA

Qëllimi kryesor i kësaj analize sekondare (të thelluar) është që të vlerësojë lidhjet (shoqërimet) kryesore të pavarura të formave kryesore të dhunës ndaj grave sipas informacionit të vetë-raportuar në studimin e drejtuar nga OSBE-ja mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave, i cili u krye në Shqipëri në vitin 2018.

Fokusi kryesor i kësaj analize sekondare (të thelluar) të të dhënave është identifikimi i faktorëve të pavarur të cilët lidhen me forma të ndryshme të dhunës ndaj grave në Shqipëri.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Objektivat specifike të analizës sekondare të studimit të drejtuar nga OSBE-ja mbi dhunën ndaj grave përfshihen më poshtë:

- Vlerësimi i lidhjeve të pavarura të çdo forme dhune të përjetuar nga gratë shqiptare që nga moshë 15 vjeç;
- Vlerësimi i lidhjeve të pavarura të çdo forme dhune të përjetuar nga gratë shqiptare në 12 muajt e fundit para kryerjes së studimit;
- Vlerësimi i lidhjeve të pavarura të dhunës fizike të përjetuar nga gratë shqiptare që nga moshë 15 vjeç;
- Vlerësimi i lidhjeve të pavarura të dhunës fizike të përjetuar nga gratë shqiptare në 12 muajt e fundit para kryerjes së studimit;

METODOLOGJIA

Analiza e thelluar aktuale përbëhet nga teknikat dhe testet e mëposhtme statistikore:

- Regresioni Logjistik Binar, i cili u përdor për të vlerësuar lidhjen midis variablave kryesore që lidhen me pasojat e interesit (çdo formë e dhunës ndaj grave/dhuna fizike) dhe faktorëve përcaktues (determinantëve) të interesit duke përfshirë karakteristikat demografike dhe socio-ekonomike të grave të përfshira në studimin e drejtuar nga OSBE-ja në vitin 2018. Gjithashtu u llogaritën dhe u raportuan raportet e gjasave (OR), intervalet e tyre të besimit (95% CI) dhe vlerat e rëndësisë statistikore (vlerat e P-së). Modelet e kontrolluara për të gjithë ndryshorët e pavaruar paraqesin vlerësimet e pavaruara (të kontrolluara) (OR-të, 95% CI dhe vlerat e P-së) për secilin faktor (faktorët demografikë dhe karakteristikat socio-ekonomike) me forma të ndryshme të dhunës ndaj grave. Në të gjitha modelet e kontrolluara për të gjithë ndryshorët, u aplikua testi Hosmer-Lemeshow (goodness-of-fit test) për të testuar përshtatshmërinë e përgjithshme të modelit.

REZULTATET

Kjo pjesë analizon lidhjet (shoqërimet) kryesore të formave të ndryshme të dhunës ndaj grave në Shqipëri.

LIDHJET (SHOQËRIMET) E PAVARUARA TË NDOJË LLOJI DHUNE KUNDËR GRAVE QË NGA MOSHA 15 VJEÇ

Në total, 1231 gra (modeli i ponderuar: 67%) raportuan të kenë përjetuar ndonjë lloj dhune (nga një partner ose jo-partner) që nga mosha 15 vjeç.

Lidhja (shoqërimi) e ndonjë lloji dhune ndaj grave që nga mosha 15 vjeç me faktorët demografikë dhe karakteristikat socio-ekonomike të tyre paraqitet në Tabelën 1.

Në modelin e regresionit logjistik binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur (variabli kryesor: ndonjë lloj dhune ndaj grave që nga mosha 15 vjeç), lidhjet e pavaruara ishin këto më poshtë:

- Pas kontrollit të njëkohshëm për të gjithë ndryshorët me karakteristikat e tjera socio-demografike, gratë që raportuan ndonjë lloj dhune që nga mosha 15 vjeç kishin më shumë gjasa të jetonin në zonën qendrore krahasuar me ato jugore të Shqipërisë (OR=1.3, 95% CI=1.0-1.6). Nga ana tjetër, nuk kishte ndryshime të rëndësishme statistikore midis zonave veriore dhe jugore të vendit.
- Vendbanimi paraqiti një lidhje (shoqërim) statistikisht të rëndësishëm në kufi: gjasat për të banuar në zonat urbane ishin rreth 30% më të larta tek gratë që raportuan ndonjë lloj dhune që nga mosha 15 vjeç krahasuar me homologet e tyre që nuk kanë përjetuar dhunë (OR = 1.2), 95% CI = 1.0-1.5).

- Anasjelltas, kishte prova të një lidhjeje (shoqërim) të fortë negative dhe të qëndrueshme me grup-moshën e grave: gjasat për të qenë më të reja në moshë ishin 2.5 herë më të larta tek gratë që raportonin ndonjë lloj dhune që nga moshë 15 vjeç, një gjetje e cila ishte statistikiqisht shumë domethënëse (OR_[18-29 vjeç perkundrejt 60-74 vjeç] =2.5, 95% CI=1.8-3.5).
- Varfëria ishte një parashikues i fortë dhe i rëndësishëm i dhunës së përjetuar: gjasat për të qenë shumë e privuar ekonomikiqisht në krahasim me ato që nuk kishin një privim të tillë ishin 2.2 herë më të larta tek gratë që raportuan ndonjë lloj dhune që nga moshë 15 vjeç (OR = 2.2, 95% CI = 1.6-3.0). Vlen të theksohet se lidhja (shoqërimi) pozitive me mungesën e të ardhurave ishte e fortë dhe e qëndrueshme.
- Për më tepër, gjasat për të qenë aktualisht të martuara ose në një lidhje civile ishin rreth 80% më të larta tek gratë që raportuan ndonjë lloj dhune që nga moshë 15 vjeç (OR = 1.8, 95% CI = 1.4-2.4).
- Çuditërisht, gjasat për të mos qenë të papunë (përfshirë kategoritë e mëposhtme: të punësuar, studente ose pensioniste) ishin rreth 30% më të larta tek gratë që raportuan ndonjë lloj dhune që nga moshë 15 vjeç (OR = 1.3, 95% CI = 1.1-1.7), duke treguar që dhuna e përjetuar mund të jetë më e lartë tek gratë më të fuqizuara për sa i përket mundësive të punësimit.
- Nga ana tjetër, pas kontrollit të njëkohshëm për të gjithë ndryshorët e pavarur, nuk u gjet ndonjë lidhje e rëndësishme me nivelin arsimor të grave (OR = 1.1, 95% CI = 0.8-1.4).

Tabela 1. Lidhja (shoqërimi) e pavaruar e ndonjë lloji dhune kundër grave që nga moshë 15 vjeç me faktorët socio-demografikë; modelet e regresionit logjistik të kontrolluar për shumë ndryshorë

KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE TË GRAVE (N=1858)	OR*	95%CI*	P*
Rajoni:			0.129 (2)[†]
Verior (n=568)	1.12	0.87-1.43	0.390
Qendror (n=716)	1.29	1.01-1.65	0.044
Jugor (n=574)	1.00	Referencë	-
Vendbanimi:			
Zonë urbane (n=1006)	1.21	0.98-1.49	0.078
Zonë urbane (n=852)	1.00	Referencë	
Grup-moshë:			<0.001 (4)[†]
18-29 vjeç (n=362)	2.53	1.82-3.54	<0.001
30-39 vjeç (n=282)	2.07	1.47-2.91	<0.001
40-49 vjeç (n=391)	1.40	1.04-1.88	0.027
50-59 vjeç (n=350)	1.21	1.04-1.93	0.026
60-74 vjeç (n=473)	1.00	Referencë	-

Varfëria:			<0.001 (3)[†]
Mungesë shumë e theksuar e të ardhurave (n=540)	2.20	1.60-3.03	<0.001
Mungesë e theksuar e të ardhurave (n=390)	2.11	1.49-2.98	<0.001
Mungesë të ardhurash (n=640)	1.03	0.77-1.38	0.846
	1.00	Referencë	-
Pa kufizime të ardhurash (n=286)			
Aktualisht e martuar ose në një lidhje:			
Po (n=1419)	1.84	1.42-2.38	<0.001
Jo (n=438)	1.00	Referencë	
E papunësuar:			
Jo (n=1375)	1.34	1.06-1.70	0.015
Po (n=483)	1.00	Referencë	
Niveli arsimor:			
Arsim i mesëm i ulët ose më shumë (n=1351)	1.08	0.85-1.37	0.535
Arsim fillor apo më pak (n=507)	1.00	Referencë	

* Raporti i Gjasave (OR: përjetim i ndonjë lloji dhune që nga mosha 15 vjeç përkundrejt jo përjetim dhune), intervali i besimit 95% (95% CI) dhe vlerat e p-së nga analiza e Regresionit Logjistik Binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur. Të gjithë ndryshorët e paraqitur në tabelë u përfshinë njëherësh në modelet e regresionit logjistik.

[†] Vlera e përgjithshme e P-së dhe shkallët e lirisë (në kllapa).

LIDHJET (SHOQËRIMET) E PAVARUARA TË NDONJË LLOJI DHUNE KUNDËR GRAVE GJATË VITIT TË KALUAR

Në total, 709 gra (modeli i ponderuar: 39%) raportuan se kishin përjetuar ndonjë lloj dhune (nga një partner ose jo-partner) në 12 muajt e fundit para studimit.

Lidhja (shoqërimi) e ndonjë lloji dhune ndaj grave në 12 muajt e fundit me faktorët demografikë dhe karakteristikat socio-ekonomike të tyre paraqitet në Tabelën 2.

Në modelin e regresionit logjistik binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur (variabli kryesor: ndonjë lloj dhune ndaj grave në 12 muajt e fundit), lidhjet (shoqërimet) e pavaruara ishin këto më poshtë:

- Pas kontrollit të njëkohshëm për të gjithë ndryshorët e karakteristikave të tjera socio-demografike, nuk kishte ndryshime të rëndësishme statistikore midis rajonit dhe ndonjë lloji dhune të përjetuar nga gratë në 12 muajt e fundit para kryerjes së studimit (vlera e përgjithshme e P-së: P=0.64).
- Nga ana tjetër, vendbanimi paraqiti një lidhje të rëndësishme të pavarur: gjasat për të jetuar në zonat urbane ishin 28% më të larta tek gratë që raportuan të kishin përjetuar ndonjë lloj dhune në 12 muajt e fundit (OR = 1.3, 95% CI = 1.0-1.6).

- Për më tepër, kishte prova të një lidhjeje (shoqërim) të fortë negative me grup-moshën: gjasat për të qenë më të rinj ishin 4.4 herë më të larta tek gratë që raportuan ndonjë lloj dhune në 12 muajt e fundit (OR $_{18-29 \text{ vjeç perkundrejt } 60-74 \text{ vjeç}}$ = 4.4, 95% CI = 3.1-6.1).
- Për më tepër, varfëria ishte një faktor tjetër përcaktues i rëndësishëm: gjasat për të qenë shumë e privuar ekonomikisht në krahasim me ato që nuk kishin një privim të tillë ishin të paktën dy herë më të larta tek gratë që raportuan se kishin përjetuar ndonjë lloj dhune në 12 muajt e fundit (OR = 2.1, 95% CI = 1.5-2.8).
- Gjithashtu, kishte prova për një lidhje (shoqërim) të rëndësishme me statusin martesor: gjasat për të qenë aktualisht të martuara ose në një lidhje civile ishin 2.4 herë më të larta tek gratë që raportuan se kishin përjetuar ndonjë lloj dhune gjatë vitit të kaluar (OR = 2.4, 95% CI = 1.8-3.2).
- Statusi i punësimit ishte gjithashtu i lidhur në mënyrë të konsiderueshme me rezultatin e interesit: gjasat për të mos qenë e papunë ishin 54% më të larta tek gratë që raportuan se kishin përjetuar ndonjë lloj dhune në 12 muajt e fundit (OR = 1.5, 95% CI = 1.2-1.9)
- Nga ana tjetër, nuk u gjet ndonjë lidhje e rëndësishme me nivelin arsimor të grave (P=0.1).

Tabela 2. Lidhja (shoqërimi) e pavarur e ndonjë lloji dhune kundër grave në 12 muajt e fundit me faktorët socio-demografikë; modelet e regresionit logjistik të kontrolluar për shumë ndryshore

KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE TË GRAVE (N=1858)	OR [*]	95%CI [*]	P [*]
Rajoni:			0.639 (2)[†]
Verior (n=568)	1.07	0.83-1.38	0.603
Qendror (n=716)	1.12	0.88-1.43	0.344
Jugor (n=574)	1.00	Referencë	-
Vendbanimi:			
Zonë urbane (n=1006)	1.28	1.04-1.58	0.019
Zonë urbane (n=852)	1.00	Referencë	
Grup-mosha:			<0.001 (4)[†]
18-29 vjeç (n=362)	4.36	3.12-6.10	<0.001
30-39 vjeç (n=282)	2.63	1.90-3.64	<0.001
40-49 vjeç (n=391)	1.51	1.12-2.03	0.008
50-59 vjeç (n=350)	1.32	0.96-1.81	0.084
60-74 vjeç (n=473)	1.00	Referencë	-

Varfëria:			<0.001 (3)[†]
Mungesë shumë e theksuar e të ardhurave (n=540)	2.06	1.50-2.83	<0.001
Mungesë e theksuar e të ardhurave (n=390)	1.73	1.22-2.44	0.002
Mungesë të ardhurash (n=640)	1.28	0.94-1.74	0.115
Pa kufizime të ardhurash (n=286)	1.00	Referencë	-
Aktualisht e martuar ose në një lidhje:			
Po (n=1419)	2.42	1.83-3.20	<0.001
Jo (n=438)	1.00	Referencë	
E papunësuar:			
Jo (n=1375)	1.54	1.22-1.95	<0.001
Po (n=483)	1.00	Referencë	
Niveli arsimor:			
Arsim i mesëm i ulët ose më shumë (n=1351)	0.82	0.65-1.04	0.096
Arsim fillor apo më pak (n=507)	1.00	Referencë	

* Raporti i Gjasave (OR: përjetim i ndonjë lloj dhune gjatë 12 muajve të fundit kundrejt jo përjetim dhune), intervali i besimit 95% (95%CI) dhe vlerat e p-së nga analiza e Regresionit Logjistik Binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur. Të gjithë ndryshorët e paraqitur në tabelë u përfshinë njëherësh në modelet e regresionit logjistik.

[†] Vlera e përgjithshme e P-së dhe shkallët e lirisë (në kllapa).

LIDHJET (SHOQËRIMET) E PAVARUARA TË DHUNËS FIZIKE KUNDËR GRAVE QË NGA MOSHA 15 VJEÇ

Lidhja (shoqërimi) e dhunës fizike ndaj grave që nga mosha 15 vjeç me faktorët demografikë dhe karakteristikat socio-ekonomike të tyre paraqitet në Tabelën 3.

Në modelin e regresionit logjistik binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur (variabli kryesor: dhunë fizike ndaj grave që nga mosha 15 vjeç), lidhjet e pavaruara ishin këto më poshtë:

- Pas kontrollit të njëkohshëm për të gjithë ndryshorët me karakteristikat e tjera socio-demografike, nuk kishte ndonjë ndryshim të rëndësishëm në përhapjen e dhunës fizike të raportuar që nga mosha 15 vjeç midis zonave veriore, qendrore ose jugore të vendit (vlera e përgjithshme e P-së: $P = 0,76$).
- Në mënyrë të ngjashme, vendbanimi nuk ishte i lidhur në mënyrë të rëndësishme me dhunën fizike të raportuar që nga mosha 15 vjeç ($P = 0.33$).
- Anasjelltas, kishte prova të një lidhjeje (shoqërim) negative me grup-moshën e grave: gjasat për të qenë 30-39 vjeç ishin rreth 90% më të larta tek gratë që raportonin dhunë fizike që nga mosha 15 vjeç, një gjetje e cila ishte statistikiqsh e rëndësishme (OR [30-39 vjeç kundrejt 60-74 vjeç] = 1.9, 95% CI = 1.3-2.7).

- Varfëria ishte një parashikues i fortë dhe i rëndësishëm i dhunës fizike të përjetuar: gjasat për të qenë shumë e privuar ekonomikisht në krahasim me ato që nuk kishin një privim të tillë ishin 2.3 herë më të larta tek gratë që raportuan dhunë fizike që nga mosha 15 vjeç (OR = 2.2, 95% CI = 1.6-3.0). Lidhja (shoqërimi) pozitive me mungesën e të ardhurave ishte e fortë dhe e qëndrueshme.
- Pas kontrollit të njëkohshëm për të gjithë ndryshorët, nuk kishte lidhje (shoqërim) domethënëse me statusin martesor të pjesëmarrëseve në studim (P = 0.62).
- Anasjelltas, gjasat për të mos qenë të papuna (përfshirë kategoritë e mëposhtme: të punësuar, studente ose pensioniste) ishin rreth 50% më të larta tek gratë që raportuan dhunë fizike që nga mosha 15 vjeç (OR = 1.5, 95% CI = 1.1- 1.9), duke treguar që dhuna fizike e përjetuar mund të jetë më e lartë tek gratë më të fuqishme përsa i përket mundësive të punësimit (një gjetje e ngjashme me çdo lloj forme dhune).
- Nga ana tjetër, pas kontrollit të njëkohshëm për të gjithë ndryshorët e pavaruar, nuk u gjet ndonjë lidhje e rëndësishme me nivelin arsimor të grave (OR=0.9, 95% CI=0.7-1.2).

Tabela 3. Lidhja (shoqërimi) e pavaruar e dhunës fizike kundër grave që nga mosha 15 vjeç me faktorët socio-demografikë; modelet e regresionit logjistik të kontrolluar për shumë ndryshorë

KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE TË GRAVE (N=1858)	OR*	95%CI*	P†
Rajoni:			0.760 (2)†
Verior (n=568)	1.11	0.83-1.48	0.479
Qendror (n=716)	1.03	0.78-1.36	0.851
Jugor (n=574)	1.00	Referencë	-
Vendbanimi:			
Zonë urbane (n=1006)	1.13	0.89-1.43	0.328
Zonë urbane (n=852)	1.00	Referencë	
Grup-mosha:			0.021 (4)†
18-29 vjeç (n=362)	1.40	0.96-2.06	0.082
30-39 vjeç (n=282)	1.89	1.30-2.73	0.001
40-49 vjeç (n=391)	1.43	1.01-2.03	0.042
50-59 vjeç (n=350)	1.38	0.96-1.99	0.079
60-74 vjeç (n=473)	1.00	Referencë	-

Varfëria:			0.001 (3)[†]
Mungesë shumë e theksuar e të ardhurave (n=540)	2.33	1.60-3.40	<0.001
Mungesë e theksuar e të ardhurave (n=390)	1.78	1.18-2.68	0.006
Mungesë të ardhurash (n=640)	1.08	0.74-1.58	0.692
Pa kufizime të ardhurash (n=286)	1.00	Referencë	-
Aktualisht e martuar ose në një lidhje:			
Po (n=1419)	1.08	0.80-1.46	0.619
Jo (n=438)	1.00	Referencë	
E papunësuar:			
Jo (n=1375)	1.46	1.11-1.93	0.007
Po (n=483)	1.00	Referencë	
Niveli arsimor:			
Arsim i mesëm i ulët ose më shumë (n=1351)	0.95	0.72-1.24	0.687
Arsim fillor apo më pak (n=507)	1.00	Referencë	

* Raporti i Gjasave (OR: përjetim i dhunës fizike që nga moshë 15 vjeç perkundrejt jo përjetim dhune), intervali i besimit 95% (95%CI) dhe vlerat e p-së nga analiza e Regresionit Logjistik Binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur. Të gjithë ndryshorët e paraqitur në tabelë u përfshinë njëherësh në modelet e regresionit logjistik.

[†] Vlera e përgjithshme e P-së dhe shkallët e lirisë (në kllapa).

LIDHJET (SHOQËRIMET) E PAVARUARA TË DHUNËS FIZIKE KUNDËR GRAVE GJATË VITIT TË KALUAR

Lidhja (shoqërimi) e dhunës fizike ndaj grave në 12 muajt e fundit para kryerjes së studimit me faktorët demografikë dhe karakteristikat socio-ekonomike të tyre paraqitet në Tabelën 4.

Në modelin e regresionit logjistik binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur (variabli kryesor: dhunë fizike ndaj grave në 12 muajt e fundit), lidhjet (shoqërimet) e pavaruara ishin këto më poshtë:

- Pas kontrollit të njëkohshëm për të gjithë ndryshorët me karakteristikat e tjera socio-demografike, gjasat për të jetuar në zona veriore krahasuar me zonat jugore të Shqipërisë ishin të paktën dy herë më të larta tek gratë që raportuan dhunë fizike gjatë 12 muajve të fundit para kryerjes së studimit (OR=2.1, 95% CI=1.3-3.2). Gjithsesi, nuk kishte ndryshime të rëndësishme me zonat qendrore të vendit.
- Nga ana tjetër, vendbanimi (zonat urbane perkundrejt zonave rurale) nuk ishte i lidhur në mënyrë të rëndësishme me dhunën fizike të raportuar në 12 muajt e fundit (P = 0,41).
- Anasjelltas, kishte prova për një lidhje (shoqërim) lineare negative me grup-moshën e grave: gjasat për të qenë më të reja ishin më shumë se katër herë më të larta tek gratë që raportuan dhunë fizike në 12 muajt e fundit, një gjetje e cila ishte statistikisht shumë e rëndësishme (OR [18-29 vjeç perkundrejt 60-74 vjeç] = 4.2, 95% CI = 2.3-7.7).

- Për më tepër, varfëria ishte një parashikues shumë i fortë dhe domethënës i dhunës fizike të përjetuar: gjasat për të qenë shumë e privuar ekonomikisht në krahasim me ato që nuk kishin një privim të tillë ishin 3.8 herë më të larta tek gratë që raportuan dhunë fizike në 12 muajt e fundit (OR = 3.8, 95% CI = 1.9-7.5). Lidhja pozitive me mungesën e të ardhurave ishte e fortë dhe e qëndrueshme.
- Pas kontrollit të njëkohshëm për të gjithë ndryshorët e pavarur, gjasat për të qenë aktualisht të martuar ose në një lidhje civile ishin më shumë se dy herë më të larta tek gratë që raportuan se kishin përjetuar dhunë fizike në 12 muajt e fundit para studimit (OR = 2.2, 95% CI = 1.3-3.8).
- Anasjelltas, gjasat për të mos qenë të papuna (përfshirë kategoritë e mëposhtme: të punësuar, studente ose pensioniste) ishin 74% më të larta tek gratë që raportuan dhunë fizike në 12 muajt e fundit (OR = 1.7, 95% CI = 1.1-2.7) , duke treguar që dhuna fizike e përjetuar mund të jetë më e lartë tek gratë më të fuqizuara për sa i përket mundësive të punësimit (një gjetje e cila ishte e ngjashme me “çdo formë dhune”).
- Për më tepër, pas kontrollit të njëkohshëm për të gjithë ndryshorët e pavarur, gjasat për të pasur një nivel më të lartë arsimor ishin rreth 40% më të ulëta tek gratë që raportuan dhunë fizike në vitin e kaluar (OR = 0.6, 95% CI = 0.4-0.9), i cili është një tregues tjetër i mundësisë së dhunës të tepruar fizike të përjetuar nga gratë më të fuqizuara socio-ekonomikisht.

Tabela 4. Lidhja (shoqërimi) e pavarur e dhunës fizike kundër grave në 12 muajt e fundit me faktorët socio-demografikë; modelet e regresionit logjistik të kontrolluar për shumë ndryshorë

KARAKTERISTIKAT SOCIO-DEMOGRAFIKE TË GRAVE (N=1858)	OR*	95%CI*	P*
Rajoni:			<0.001 (2)[†]
Verior (n=568)	2.09	1.35-3.22	0.001
Qendror (n=716)	0.70	0.43-1.16	0.165
Jugor (n=574)	1.00	Referencë	-
Vendbanimi:			
Zonë urbane (n=1006)	1.17	0.80-1.70	0.413
Zonë urbane (n=852)	1.00	Referencë	
Grup-mosha:			<0.001 (4)[†]
18-29 vjeç (n=362)	4.23	2.32-7.73	<0.001
30-39 vjeç (n=282)	2.90	1.60-5.26	<0.001
40-49 vjeç (n=391)	1.89	1.06-3.40	0.032
50-59 vjeç (n=350)	1.35	0.71-2.59	0.364
60-74 vjeç (n=473)	1.00	Referencë	-

Varfëria:			<0.001 (3)[†]
Mungesë shumë e theksuar e të ardhurave (n=540)	3.80	1.92-7.51	<0.001
Mungesë e theksuar e të ardhurave (n=390)	2.36	1.10-5.04	0.027
Mungesë të ardhurash (n=640)	1.80	0.90-3.64	0.099
Pa kufizime të ardhurash (n=286)	1.00	Referencë	-
Aktualisht e martuar ose në një lidhje:			
Po (n=1419)	2.19	1.28-3.78	0.005
Jo (n=438)	1.00	Referencë	
E papunësuar:			
Jo (n=1375)	1.74	1.12-2.72	0.015
Po (n=483)	1.00	Referencë	
Niveli arsimor:			
Arsim i mesëm i ulët ose më shumë (n=1351)	0.57	0.38-0.85	0.006
Arsim fillor apo më pak (n=507)	1.00	Referencë	

* Raporti i Gjasave (OR: përjetim i dhunës fizike në 12 muajt e fundit perkundrejt jo përjetim dhune), intervali i besimit 95% (95%CI) dhe vlerat e p-së nga analiza e Regresionit Logjistik Binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur. Të gjithë ndryshorët e paraqitur në tabelë u përfshinë njëherësh në modelet e regresionit logjistik.

[†] Vlera e përgjithshme e P-së dhe shkallët e lirisë (në kllapa).

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE TË ANALIZËS SEKONDARE TË STUDIMIT TË DREJTUAR NGA OSBE PËR MIRËQENIEN DHE SIGURINË E GRAVE, 2018

Gjetjet kryesore të analizës sekondare (të thelluar) të studimit mbi mirëqenien dhe sigurinë e grave në Shqipëri në vitin 2018 janë përmbledhur më poshtë:

- *Korrelacionet kryesore të pavarura të çdo forme dhune të përjetuar nga gratë shqiptare që nga moshë 15 vjeç janë si më poshtë:*
 - Banimi në zonat qendrore të vendit; vendbanimi në zonat urbane; moshë më e re e grave; varfëria; të qëniet e martuar ose në një lidhje; dhe të jesh e fuqizuar për sa i përket mundësive të punësimit.
- *Korrelacionet kryesore të pavarura të çdo forme dhune të përjetuar nga gratë shqiptare në 12 muajt e fundit para studimit të udhëhequr nga OSBE-ja janë si më poshtë:*
 - Vendbanimi në zonat urbane; moshë më e re e grave; varfëria; të qëniet e martuar ose në një lidhje; dhe të jesh e fuqizuar për sa i përket mundësive të punësimit.
- *Korrelacionet kryesore të pavarura të dhunës fizike të përjetuar nga gratë shqiptare që nga moshë 15 vjeç janë si më poshtë:*
 - Grup-moshë 30-39 vjeç e grave; varfëria; dhe të jesh e fuqizuar për sa i përket mundësive të punësimit

- *Korrelacionet kryesore të pavarura të dhunës fizike të përjetuar nga gratë shqiptare në 12 muajt e fundit para kryerjes së studimit janë si më poshtë:*
 - Banimi në zonat veriore të vendit, mosha më e re grave; varfëria; të qëniet e martuar ose në një lidhje; dhe të jesh e fuqizuar për sa i përket mundësive të punësimit dhe/ose arsimit.

Në thelb, shumica e formave të dhunës të përjetuara nga gratë shqiptare duken më të përhapura tek gratë më të reja, atyre që janë aktualisht të martuara ose në një lidhje, atyre që janë të varfëra dhe, janë pothuajse të barabarta, tek gratë që janë më të fuqizuara në lidhje me mundësitë e punësimit dhe arsimit.

Këto gjetje mbartin implikime të rëndësishme për politikëbërësit dhe vendimmarrësit në Shqipëri të cilët duhet të jenë të vetëdijshëm për efektet e rëndësishme shëndetësore, por edhe për pasojat negative socio-ekonomike të dhunës ndaj grave.

5.4 DHUNA NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE NË SHQIPËRI

VROJTIM KOMBËTAR ME BAZË POPULLATËN, INSTAT 2019

VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I VROJTIMIT KOMBËTAR MBI DHUNËN NDAJ GRAVE DHE VAJZAVE, KRYER NË SHQIPËRI NË 2018 (botuar në vitin 2019)

Vrojtimi Kombëtar për Dhunën ndaj Grave dhe Vajzave (VKDhNGV) në Shqipëri për vitin 2018 u bë për të matur natyrën dhe shkallën e pesë llojeve të ndryshme të DhNG-së:

- dhuna në familje ushtruar nga partneri intim,
- dhuna gjatë marrëdhënies dashurore,
- dhuna nga jo-partneri,
- ngacmimi seksual,
- përndjekja,
- disa norma shoqërore të lidhura me DhNGV-në.

Që prej vitit 2007, Instituti Kombëtar i Statistikave ka kryer dy Vrojtime Kombëtare mbi Dhunën në Familje, respektivisht në vitin 2007 (Vrojtimi i pare i Dhunës në Familje³⁸), dhe në vitin 2013, (Vrojtimi i dytë i Dhunës në Familje³⁹).

Vrojtimi aktual u krye në periudhën Tetor-Nëntor 2018. Studimi përfshiu një vrotim kombëtar të familjeve me bazë popullatën, të kryer në secilën nga 12 prefekturat e Shqipërisë. U përdor modeli

38 Haarr, R.N. & L. Dharmo (2009), Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtimi kombëtar me bazë popullatën. Tiranë, Shqipëri: PNUD-i.

39 Haarr, R.N. (2013), Dhuna në familje në Shqipëri: Vrojtimi kombëtar me bazë popullatën 2013. INSTAT/PNUD: Tiranë, Shqipëri.

i kampionit me shtresëzim për përzgjedhjen e grave. Qëllimi ishte të nxirrej një kampion grash të moshës 18-74 vjeç, i cili do të bënte të mundur nxjerrjen e vlerësimeve të besueshme kombëtare statistikore për përhapjen e DhNGV-së.

Kampioni përfundimtar i grave përfshiu 3.443 familje dhe gra të moshës 18-74 vjeç. Kampioni nuk ishte i barabartë në të gjitha prefekturat, duke qenë se kampioni i marrë në Tiranë përfshinte një numër më të madh grash (27,1%), për faktin se Tirana është kryeqyteti dhe ka një popullsi shumë më të madhe, në Fier (11,5%) dhe në Elbasan (10,6%), krahasuar me Kukësin (3,0%) dhe Gjirokastrën (2,6%), ku kampioni përfshinte një numër shumë më të vogël grash.

Shpërndarja e grave që u mor për kampion ishte disi e barabartë në secilën grupmoshë. Gratë ishin të moshës 18 deri në 74 vjeç, me moshë mesatare 43,6 vjeç. Shpërndarja e grave dhe vajzave sipas grupmoshës paraqitet në tabelën 2.

Përsa i takon arsimin, 42,4% e grave kishin arsim të mesëm të ulët, 27,8% kishin arsim të mesëm të lartë dhe 19,7% arsim universitar; vetëm 7,7% e grave kishin vetëm arsimin fillor apo më pak.

Shumica e grave të marra në kampion ishin aktualisht të martuara dhe/ose jetonin me një partner mashkull; në veçanti, 73,3% e tyre ishin aktualisht të martuara dhe jetonin bashkë me një mashkull; 20,3% nuk ishin aktualisht të martuara apo nuk jetonin me një partner mashkull. Vetëm 4,1% ishin të veja, 1,2% ishin të shkurorëzuara dhe 0,2% ishin të ndara apo nuk jetonin më me bashkëshortin/ të dashurin aktual mashkull. Moshë kur shumica e grave ishin martuar fillimisht apo kishin filluar të jetonin bashkë me një burrë ishte 18-24 vjeç.

Në lidhje me situatën e gjendjes së punësimit të grave, 38,2% e tyre ishin në punë, 29,5% e grave po kërkonin punë, por ishin aktualisht të papuna, dhe 18,2% ishin në pension. Vetëm 4,5% ishin studente dhe 1,4% e grave ishin me aftësi të kufizuara ose ishin të sëmurë prej një kohe të gjatë.

Shpërndarja e karakteristikave demografike dhe socio-ekonomike të grave dhe vajzave të përfshira në studim është përmbledhur në Tabelën 1.

Tabela 1: Karakteristikat demografike dhe socio-ekonomike të grave dhe vajzave të përfshira në studim

Prefekturat	Numri i grave sipas prefekturave (të dhëna të paponduara: N= 3443)
Berat	163
Dibër	166
Durrës	323
Elbasan	364
Fier	396
Gjirokastrë	88
Korçë	264
Kukës	104
Lezhë	168

Shkodër	264
Tiranë	932
Vlorë	211
Grup-mosha	Totali (%)
18-24 vjeç	16.1%
25-34 vjeç	19.6%
35-44 vjeç	16%
45-54 vjeç	18.6%
55-64 vjeç	18.4%
65-74 vjeç	11.2%
Niveli i arsimimit	Totali (%)
Arsim më i vogël se arsimi fillor	0.6%
Arsim fillor	7.1%
Arsim i mesëm i ulët (8-9 vjeçar)	42.4%
Arsim i mesëm i lartë	27.8%
Arsim mbi arsimin e mesëm por jo universitar	2.4%
Arsim universitar	19.7%
Statusi martesor	Totali (%)
Aktualisht të martuara dhe jetonin bashkë me një mashkull	73.3%
Nuk ishin aktualisht të martuara apo nuk jetonin me një partner mashkull	20.3%
Të veja	4.1%
Të divorcuara	1.2%
Të ndara apo nuk jetonin më me bashkëshortin/të dashurin aktual mashkull	0.2%
Punësimi	Totali (%)
Në punë	38.2%
Duke kërkuar për punë/e papunë	29.5%
Në pension	18.2%
Studente/duke ndjekur studimet	4.5%
Me aftësi të kufizuara/sëmure për një kohë të gjatë	1.4%
Tjetër	8%

QËLLIMI I ANALIZËS SEKONDARE (TË THELLUAR) TË STUDIMIT DHNGV

Qëllimi kryesor i kësaj analize sekondare (të thelluar) është që të vlerësojë lidhjet (shoqërimet) kryesore të pavarura të formave kryesore të dhunës ndaj grave dhe vajzave gjatë periudhës së fëmijërisë sipas informacionit të vetë-raportuar në studimin e drejtuar nga INSTAT-i, i cili u krye në Shqipëri në vitin 2018.

Fokusi kryesor i kësaj analize sekondare (të thelluar) të të dhënave është identifikimi i faktorëve të pavarur të cilët lidhen me forma të ndryshme të dhunës ndaj grave në Shqipëri.

OBJEKTIVAT SPECIFIKE

Objektivat specifikë të analizës sekondare të studimit të drejtuar nga INSTAT-i mbi dhunën ndaj grave dhe vajzave përfshihen më poshtë:

- Vlerësimi i lidhjeve të pavarura të dhunës fizike të përjetuar nga gratë dhe vajzat shqiptare që prej moshës 15 vjeç;
- Vlerësimi i lidhjeve të pavarura të dhunës seksuale të përjetuar nga gratë dhe vajzat shqiptare gjatë fëmijërisë së tyre.

METODOLOGJIA

Analiza e thelluar aktuale përbëhet nga teknikat dhe testet e mëposhtme statistikore:

- Regresioni Logjistik Binar, i cili u përdor për të vlerësuar lidhjen midis variablave kryesore që lidhen me pasojat e interesit (abuzimi fizik që prej moshës 15 vjeç dhe abuzimi seksual gjatë fëmijërisë) dhe faktorëve përcaktues (determinantëve) të interesit duke përfshirë karakteristikat demografike dhe socio-ekonomike të grave dhe vajzave të përfshira në studimin e drejtuar nga INSTAT-i në vitin 2018. Gjithashtu, u llogaritën dhe u raportuan raportet e gjasave (OR), intervalet e tyre të besimit (95% CI) dhe vlerat e rëndësisë statistikore (vlerat e P-së). Modelet fillestare përfshinë llogaritjen bruto (të pa kontrolluar/përshtatur) të OR-ve, 95% CI dhe vlerat e P-së. Më pas, modelet e kontrolluara për të gjithë ndryshorët e pavaruar paraqitën vlerësimet e pavarura (të kontrolluara/përshtatura) (OR, 95% CI dhe vlera e P-së). Për të testuar përshtatshmërinë e modeleve të Regresionit Logjistik Binar të përdorur, u aplikua testi Hosmer-Lemeshow (goodness-of-fit test).

REZULTATET

Kjo pjesë paraqet gjetjet kryesore nga analiza e thelluar e studimit e dhunës ndaj grave në Shqipëri.

ANALIZA PËRSHKRUESE

- Abuzimi fizik gjatë fëmijërisë

Gratë u pyetën nëse që nga moshën 15-vjeçare, dikush tjetër përveç bashkëshortit/partnerit/të dashurit i kishte goditur, goditur me shuplakë apo me shkelm, ose kishte kryer ndonjë veprim tjetër që t'i kishte lënduar fizikisht. Në total, vetëm 17.3% e grave dhe vajzave raportuan se ishin dhunuar fizikisht që nga moshën 15 vjeç nga dikush tjetër përveç bashkëshortit/partnerit/të dashurit. Në 13.9% të rasteve kjo gjë kishte ndodhur para moshës 18 vjeç.

Gratë dhe vajzat raportuan se autorët kryesorë të dhunës fizike jo nga partneri para moshës 18 vjeç ishin prindërit (nëna 32.7% dhe babai 25%), të pasuar nga mësuesit (15.3%) dhe motrat/vëllezërit (12%).

- **Abuzimi seksual gjatë fëmijërisë**

Gratë dhe vajzat që morën pjesë në studim u pyetën nëse nëse dikush i kishte prekur ndonjëherë seksualisht pa dëshirën e tyre, ose i kishte detyruar të bënin ndonjë veprim seksual pa dëshirën e tyre kur ishin të vogla, ndërmjet moshës 0 - 17 vjeç. Në total, vetëm 3.1% e grave dhe vajzave raportuan se ishin abuzuar seksualisht gjatë fëmijërisë.


Në mënyrë të përmbledhur, gjetjet kryesore të abuzimit gjatë fëmijërisë paraqiten në Tabelën 2.

Tabela 2: Shpërndarja e formave të ndryshme të abuzimit gjatë fëmijërisë

Abuzim fizik që nga moshën 15 vjeç	Totali
Po	17.3%
Jo	82.3%
Nuk e di	0.4%
Moshë e përjetimit të abuzimit fizik	Totali
< 18 vjeç	13.9%
≥18 vjeç	1.6%
Para dhe pas moshës 18 vjeç	1.6%
Nuk e mbaj mend	0.1%
Autori i ushtrimit të dhunës fizike gjatë fëmijërisë	
Nëna/njerka	32.7%
Babai/njerku	25%
Motra/Vëllai	12%
Mësues	15.3%
Shokë shkolle	4.8%
Fqinjë	3.1%
Të tjerë (jo familjarë)	7.1%
Abuzimi seksual gjatë fëmijërisë (0-17 vjeç)	
Po	3.1%
Jo	95.9%
Nuk e di	1%

- **Të qenit viktimë e dhunës në familje**

Gratë dhe vajzat që morën pjesë në studim u pyetën nëse në dijeninë e tyre babai kishte goditur apo rrahur ndonjëherë nënën e tyre. Në total, 18.6% e grave dhe vajzave raportuan se ishin në dijeni që babai i tyre kishte abuzuar fizikisht me nënën e tyre (Grafiku 1).



KORRELACIONET E ABUZIMIT TË FËMIJËVE

- Abuzimi fizik që prej moshës 15 vjeç

Gjetjet nga analiza e regresionit logjistik binar univariat janë paraqitur në Tabelën 3.

- Kishte prova të një lidhjeje (shoqërim) të fortë negative me grup-moshën e grave: gjasat për të qenë 25-34 vjeç ishin 3 herë më të larta tek gratë që raportuan se ishin dhunuar fizikisht që prej moshës 15 vjeç, një gjetje e cila ishte statistikisht shumë e rëndësishme (OR [perkundrejt 65-74 vjeç]_{25-34 vjeç}]=3.1, 95% CI=3.0-3.3).
- Arsimimi i grave ishte i lidhur fuqishëm, në mënyrë lineare negative me abuzimin fizik që prej moshës 15 vjeç. Niveli i ulët arsimor i grave ishte i lidhur pozitivisht me dhunën e përjetuar që në moshën 15 vjeç (OR=1.4, 95% CI=1.3-1.6).
- Nga ana tjetër, kishte një lidhje pozitive me statusin martesor të grave. Gjasat për të qenë e martuar ishin më të larta tek gratë që raportuan se ishin dhunuar fizikisht që prej moshës 15 vjeç, një gjetje e cila ishte statistikisht shumë domethënëse (OR=1.1, 95% CI=1.1-1.2).
- Anasjelltas, kishte prova të një lidhjeje negative me nivelin e të ardhurave. Gjasat për të patur nivelin më të ulët të të ardhurave ishin rreth 10% më të ulëta tek gratë që raportuan se ishin dhunuar fizikisht që prej moshës 15 vjeç, duke treguar kështu se përjetimi i dhunës fizike mund të jetë më i lartë tek gratë që janë më të fuqizuara përsa i përket nivelit ekonomik.
- Për më tepër, papunësia ishte një faktor tjetër i rëndësishëm i abuzimit fizik që prej moshës 15 vjeç. Gjasat për të qenë e punësuar ishin rreth 20% më të pakta tek gratë dhe vajzat që raportuan se ishin dhunuar fizikisht që prej moshës 15 vjeç (OR=0.8, 95% CI=0.84-0.88).
- Gjithashtu, kishte një lidhje të fortë pozitive midis abuzimit fizik të përjetuar që prej moshës 15 vjeç dhe të qenit dëshmitar i dhunës në familje gjatë fëmijërisë (OR=6.6, 95% CI=6.4-6.7).

Tabela 3. Korrelacionet e abuzimit fizik të grave që prej moshës 15 vjeç, studimi DHNGV, 2018 (analiza univariate)

FAKTORI	OR	95%CI	P*
Grup-mosha:			<0.001 (5)*
18-24 vjeç	3.079	2.951-3.212	<0.001
25-34 vjeç	3.196	3.088-3.308	<0.001
35-44 vjeç	1.954	1.890-2.019	<0.001
45-54 vjeç	1.391	1.348-1.435	<0.001
55-64 vjeç	1.623	1.576-1.670	<0.001
65-74 vjeç	1.000	Referencë	-
Arsimimi			<0.001 (2)
Arsim i ulët	1.482	1.371-1.602	<0.001
Arsim i mesëm	1.237	1.202-1.273	<0.001
Universitet	1.000	Referencë	-
Statusi martesor aktual			
E martuar/jetoj me një burrë	1.181	1.122-1.244	<0.001
Jo e martuar/ nuk jetoj me një burrë	1.000	Referencë	-
Punësimi			
Në punë	0.863	0.846-0.881	<0.001
Tjetër (pa punë; pensioniste)	1.000	Referencë	-
Gjendja financiare			<0.001 (2)
< 26,000 lekë	0.911	0.884-0.940	<0.001
26,000 – 60,000 lekë	0.816	0.794-0.838	<0.001
>60,000 lekë	1.000	Referencë	-
Dëshmitar i dhunës në familje:			
Po	6.623	6.493-6.757	<0.001
Jo	1.000	Referencë	-

* Vlera e përgjithshme e P-së dhe shkallët e lirisë (në kllapa)

Analiza multivariate

Lidhja (shoqërimi) e përjetimit të dhunës fizike që nga mosha 15 vjeç me faktorët demografikë dhe karakteristikat socio-ekonomike të tyre paraqitet në Tabelën 4:

Në modelin e regresionit logjistik binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur (variabli kryesor: dhunë fizike që nga mosha 15 vjeç), lidhjet e pavaruara ishin këto më poshtë

- Kishte prova të një lidhjeje (shoqërim) të fortë negative midis përjetimit të dhunës fizike që prej moshës 15 vjeç dhe moshës së pjesëmarrëseve në studim: gjasat për të përjetuar dhunë fizike ishin më të vogla tek gratë më të moshuara krahasuar me ato më të reja (OR [65-74 perkundrejt 18-24 vjeç] =0.32, 95% CI=0.31-0.34).
- Niveli i ulët i arsimimit ishte një faktor përcaktues i përjetimit të dhunës fizike që prej moshës 15 vjeç: gjasat për të pasur një nivel arsimor më të ulët ishin 60% më të larta tek gratë që raportuan dhunë fizike që nga mosha 15 vjeç (OR=1.6, 95%CI=1.5-1.7).

- Nga ana tjetër, gjasat për të qenë e martuar ishin më shumë se dy herë më të larta tek gratë që raportuan se kishin përjetuar dhunë fizike që nga moshën 15 vjeç (OR=2.1, 95% CI=2.0-2.2).
- Për më tepër, gjasat për të qenë e punësuar ishin më të larta tek gratë që raportuan dhunë fizike që nga moshën 15 vjeç (OR = 1.1, 95% CI = 1.13-1.18), duke treguar që dhuna fizike e përjetuar mund të jetë më e lartë tek gratë më të fuqizuara për sa i përket mundësive të punësimit.
- Kishte prova të një lidhjeje (shoqërimi) të paqëndrueshme me nivelin e të ardhurave: gjasat për të përjetuar dhunë fizike ishin më të lartat tek gratë me të ardhura mesatare dhe më të ulta tek ato që kishin nivel më të lartë të të ardhurave (OR = 1.23, 95% CI = 1.19-1.26).
- Gjithashtu, të qenit dëshmitar i dhunës në familje ishte një faktor përcaktues shumë i fortë dhe domethënës i përjetimit të dhunës fizike që nga moshën 15 vjeç: gjasat për të qenë dëshmitar i dhunës në familje ishin 6 herë më të larta tek gratë që raportuan dhunë fizike që nga moshën 15 vjeç (OR=6.6, 95% CI=6.5-6.7).

Tabela 4: Lidhja (shoqërimi) e pavarur e përjetimit të dhunës fizike që nga moshën 15 vjeç me faktorët socio-demografikë; modelet e regresionit logjistik të kontrolluar për shumë ndryshore

FAKTORI	OR [*]	95%CI [*]	P [†]
Grup-mosha:			<0.001 (5)*
18-24 vjeç	0.325	0.311-0.339	<0.001
25-34 vjeç	0.313	0.302-0.324	<0.001
35-44 vjeç	0.512	0.495-0.529	<0.001
45-54 vjeç	0.719	0.697-0.742	<0.001
55-64 vjeç	0.616	0.599-0.634	<0.001
65-74 vjeç	1.000	Referencë	-
Arsimimi			<0.001 (2)
Arsim i ulët	1.651	1.587-1.717	<0.001
Arsim i mesëm	1.286	1.250-1.322	<0.001
Universitet	1.000	Referencë	-
Statusi martesor aktual			
E martuar/jetoj me një burrë	2.154	2.070-2.242	<0.001
Jo e martuar/ nuk jetoj me një burrë	1.000	Referencë	
Punësimi			
Në punë	1.158	1.135-1.182	<0.001
Tjetër (pa punë; pensioniste)	1.000	Referencë	
Gjendja financiare			<0.001 (2)
< 26,000 lekë	1.097	1.064-1.131	<0.001
26,000 – 60,000 lekë	1.226	1.194-1.259	<0.001
>60,000 lekë	1.000	Referencë	-
Dëshmitar i dhunës në familje:			
Po	6.633	6.512-6.756	<0.001
Jo	1.000	Referencë	

*Raporti i Gjasave (OR: përjetim i dhunës fizike që nga moshën 15 vjeç përkundrejt jo përjetim dhune fizike), intervali i besimit 95% (95% CI) dhe vlerat e p-së nga analiza e Regresionit Logjistik Binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur. Të gjithë ndryshorët e paraqitur në tabelë u përfshinë njëherësh në modelet e regresionit logjistik.

† Vlera e përgjithshme e P-së dhe shkallët e lirisë (në kllapa).

- **Abuzimi seksual jetësor gjatë fëmijërisë**

Gjetjet nga analiza univariate e regresionit logjistik binar janë paraqitur në Tabelën 5.

- Gjasat për të qenë 18-24 vjeç, 35-44 vjeç dhe 55-64 vjeç ishin pothuajse 60% më të ulëta tek gratë që raportuan se kishin përjetuar abuzim seksual gjatë fëmijërisë (përkatësisht $OR_{[18-24 \text{ vjeç}]} = 0.4$, 95% CI=0.40-0.49; $OR_{[25-34 \text{ vjeç}]} = 0.4$, 95% CI=0.42-0.50 dhe $OR_{[55-64 \text{ vjeç}]} = 0.4$, 95% CI=0.42-0.49).
- Arsimiti i grave ishte i lidhur fuqishëm, në mënyrë negative me abuzimin seksual gjatë fëmijërisë. Niveli i ulët i edukimit të grave u shoqërua pozitivisht me abuzimin seksual gjatë fëmijërisë (OR=1.5, 95% CI=1.3-1.8)
- Nga ana tjetër, ekzistonte një lidhje (shoqërim) pozitive me statusin martesor të grave. Gjasat për të qenë e martuar ishin më të larta tek gratë që raportuan abuzim seksual gjatë fëmijërisë, një gjetje e cila ishte shumë e rëndësishme nga ana statistikore (OR=1.8, 95% CI=1.7-1.9)
- Anasjelltas, kishte prova të një lidhjeje (shoqërim) të fortë negative dhe të qëndrueshme me nivelin e të ardhurave. Gjasat për të pasur një nivel më të ulët të të ardhurave ishin rreth 80% më të ulëta tek gratë që raportuan abuzim seksual gjatë fëmijërisë (OR = 0.2, 95% CI = 0.1-0.2), duke treguar që abuzimi seksual mund të jetë më i lartë tek gratë më të fuqizuara për sa i përket nivelit të të ardhurave.
- Për më tepër, punësimi ishte një faktor shumë i rëndësishëm i abuzimit seksual gjatë fëmijërisë. Gjasat për të qenë e punësuar ishin rreth 60% më të larta tek gratë që raportuan abuzim seksual gjatë fëmijërisë (OR = 1.6, 95% CI = 1.5-1.6).
- Gjithashtu, kishte një lidhje (shoqërim) të fortë pozitive të abuzimit seksual të grave gjatë fëmijërisë me të qenit dëshmitar i dhunës në familje (OR=1.98, 95% CI=1.91-2.0).

Tabela 5: Korrelacionet e abuzimit seksual jetësor gjatë fëmijërisë në gra/vajza (analiza univariate)

FAKTORI	OR	95%CI	P*
Grup-mosha:			<0.001 (5)*
18-24 vjeç	0.448	0.409-0.491	<0.001
25-34 vjeç	0.139	0.128-0.150	<0.001
35-44 vjeç	0.464	0.426-0.505	<0.001
45-54 vjeç	0.334	0.309-0.361	<0.001
55-64 vjeç	0.458	0.424-0.494	<0.001
65-74 vjeç	1.000	Referencë	-
Arsimimi			<0.001 (2)
Arsim i ulët	1.569	1.344-1.832	<0.001
Arsim i mesëm	0.804	0.754-0.857	<0.001
Universitet	1.000	Referencë	-
Statusi martesor aktual			
E martuar/jetoj me një burrë	1.838	1.713-1.973	<0.001
Jo e martuar/ nuk jetoj me një burrë	1.000	Referencë	-
Punësimi			
Në punë	1.590	1.530-1.652	<0.001
Tjetër (pa punë; pensioniste)	1.000	Referencë	-
Gjendja financiare			<0.001 (2)
< 26,000 lekë	0.209	0.191-0.230	<0.001
26,000 – 60,000 lekë	0.262	0.240-0.287	<0.001
>60,000 lekë	1.000	Referencë	-
Dëshmitar i dhunës në familje:			
Po	1.988	1.916-2.062	<0.001
Jo	1.000	Referencë	-

* Vlera e përgjithshme e P-së dhe shkallët e lirisë (në kllapa)

Analiza multivariate

Lidhja (shoqërimi) e abuzimit seksual të grave gjatë fëmijërisë me faktorët demografikë dhe karakteristikat socio-ekonomikë të tyre paraqitet në Tabelën 6. Në modelin e regresionit logjistik binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur (variabli kryesor: abuzimi seksual gjatë fëmijërisë), lidhjet (shoqërimet) e pavaruara ishin këto më poshtë:

- Kishte prova të një lidhjeje (shoqërim) të fortë me grupmoshën e grave: gjasat për të qenë 25-34 vjeç ishin 7 herë më të larta tek gratë që raportuan abuzim seksual gjatë fëmijërisë, një gjetje e cila ishte shumë e rëndësishme nga ana statistikore (OR _[25-34 vjeç perkundrejt 65-74 vjeç] =7.2, 95% CI=6.6-7.7).
- Niveli arsimor i mesëm ishte një faktor përcaktues i rëndësishëm i abuzimit seksual gjatë fëmijërisë: gjasat për të pasur një nivel arsimor të mesëm ishin rreth 50% më të larta tek gratë që raportuan abuzim seksual gjatë fëmijërisë (OR = 1.4, 95% CI = 1.3-1.5)
- Nga ana tjetër, gjasat për të qenë e martuar ishin më shumë se 30% më të larta tek gratë që raportuan abuzim seksual gjatë fëmijërisë (OR=1.3, 95% CI=1.2-1.4).

- Për më tepër, papunësia ishte një faktor përcaktues i rëndësishëm i abuzimit seksual gjatë fëmijërisë. Shanset për t'u punësuar ishin rreth 40% më të ulëta tek gratë që raportuan abuzim seksual gjatë fëmijërisë (OR=0.62, 95% CI=0.60-0.64).
- Varfëria ishte një parashikues i fortë dhe domethënës i abuzimit seksual gjatë fëmijërisë: gjasat për të pasur një nivel më të ulët të të ardhurave në krahasim me nivelin më të lartë të të ardhurave ishin 4.7 herë më të larta tek gratë që raportuan abuzim seksual gjatë fëmijërisë (OR = 4.7, 95% CI = 4.3-5.2). Shoqërimi pozitiv me nivelin e ulët të të ardhurave ishte i fortë dhe i qëndrueshëm.
- Gjithashtu, të qenit dëshmitar i dhunës në familje ishte një përcaktues i fortë dhe domethënës i abuzimit seksual gjatë fëmijërisë: shanset për të qenë dëshmitar i dhunës në familje ishin pothuajse dy herë më të larta në tek gratë që raportuan abuzim seksual gjatë fëmijërisë (OR = 1.98, 95% CI = 1.91- 2.0)

Tabela 6: Lidhja (shoqërimi) e pavaruar e abuzimit seksual gjatë fëmijërisë me faktorët socio-demografikë; modelet e regresionit logjistik të kontrolluar për shumë ndryshore

FAKTORI	OR*	95%CI*	P†
Grup-mosha:			<0.001 (5)*
18-24 vjeç	2.231	2.037-2.444	<0.001
25-34 vjeç	7.205	6.668-7.784	<0.001
35-44 vjeç	2.154	1.978-2.346	<0.001
45-54 vjeç	2.995	2.768-3.240	<0.001
55-64 vjeç	2.184	2.023-2.358	<0.001
65-74 vjeç	1.000	Referencë	-
Arsimimi			<0.001 (2)
Arsim i ulët	1.244	1.166-1.326	<0.001
Arsim i mesëm	1.466	1.373-1.565	<0.001
Universitet	1.000	Referencë	-
Statusi martesor aktual			
E martuar/jetoj me një burrë	1.349	1.240-1.467	<0.001
Jo e martuar/ nuk jetoj me një burrë	1.000	Referencë	
Punësimi			
Në punë	0.629	0.605-0.654	<0.001
Tjetër (pa punë; pensioniste)	1.000	Referencë	
Gjendja financiare			<0.001 (2)
< 26,000 lekë	4.777	4.347-5.249	<0.001
26,000 – 60,000 lekë	3.814	3.484-4.175	<0.001
>60,000 lekë	1.000	Referencë	-
Dëshmitar i dhunës në familje:			
Po	1.988	1.915-2.063	<0.001
Jo	1.000	Referencë	

*Raporti i Gjasave (OR: abuzim seksual gjatë fëmijërisë përkundrejt jo abuzim seksual), intervali i besimit 95% (95%CI) dhe vlerat e p-së nga analiza e Regresionit Logjistik Binar të kontrolluar për të gjithë ndryshorët e pavarur. Të gjithë ndryshorët e paraqitur në tabelë u përfshinë njëherësh në modelet e regresionit logjistik.

† Vlera e përgjithshme e P-së dhe shkallët e lirisë (në kllapa).

PËRMBLEDHJE E GJETJEVE KRYESORE TË ANALIZËS SEKONDARE TË STUDIMIT DHNGV, SHQIPËRI 2018

Gjetjet kryesore të analizës së thelluar të studimit DHNGV të kryer në Shqipëri në 2018 janë përmbledhur më poshtë:

- Në total, prevalenca e abuzimit fizik që nga moshë 15 vjeç ishte 17.3%, ndërsa prevalenca e abuzimit seksual gjatë fëmijërisë ishte 3.1%.
- Rreth 19% e grave dhe vajzave kanë qenë dëshmitare të dhunës në familje gjatë 18 viteve të para të jetës.
- Ushtruesit kryesorë të dhunës fizike nga jo-partneri para moshës 18 vjeç ishin prindërit (nëna 32.7% dhe babai 25%), pasuar nga mësuesit (15.3%) dhe vëllezërit e motrat (12%).
- Korrelacione të rëndësishme të pavarura të përjetimit të abuzimit fizik që nga moshë 15 vjeç tek gratë dhe vajzat përfshinin: moshën e re të pjesëmarrëseve femra, një nivel më të ulët të arsimit, papunësisë, statusin martesor, nivelin e lartë të të ardhurave dhe të qenit dëshmitar i dhunës në familje.
- Në mënyrë të ngjashme, korrelacionet pozitive të abuzimit seksual gjatë fëmijërisë përfshinin: një nivel më të ulët të arsimit, papunësisë, statusit martesor, një nivel më të ulët të të ardhurave dhe të qenit dëshmitar i dhunës në familje.

REKOMANDIME



Raporti i analizës së thelluar të disa studimeve për dhunën ndaj adoleshentëve dhe të rinjve hedh dritë edhe një herë mbi të gjithë ata faktorë përcaktues të lidhur me abuzimin fizik, emocional dhe seksual ndaj tyre. Ai, gjithashtu, paraqet një analizë të detajuar të kuadrit ligjor dhe thekson rëndësinë e marrjes së masave të tilla në luftën kundër dhunës ndaj fëmijëve dhe të rinjve.

Rekomandimet kryesore të këtij raporti janë detajuar më poshtë dhe bazohen në gjetjet nga analiza e thelluar e katër studimeve kombëtare të kryera gjatë dekadës së fundit.

- I gjithë kuadri ligjor dhe i politikave në mbrojtje të të drejtave të fëmijëve vajza dhe djem në Shqipëri, duhet të rishikohet në mënyrë që të përmbajë një gjuhë të ndjeshme (dhe jo neutrale apo të verbër) nga këndvështrimi gjinor. Adresimi thjeshtë në mënyrë të përgjithshme si “fëmijë”, “të mitur”, të “dëmtuar” jo në pak raste mund të lerë jashtë vëmendjes fëmijët vajza, të mitura apo të dëmtuara. Gjithashtu, edhe evidentimi i fëmijëve vajza vetëm në disa raste (psh “nëse ato nuk kanë arritur pjekurinë seksuale”) dhe lënia jashtë vëmendjes e fëmijëve djem, mund të çojë në të një trajtim të diferencuar në mënyrën se si ofrohet mbrojtja në rast të abuzimit të tyre. Rishikimi i legjisllacionit dhe përdorimi i gjuhës së ndjeshme gjinore është, në fakt, një rekomandim që duhet të konsiderohet për legjisllacionin në tërësi, duke filluar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
- Pavarësisht përmirësimeve të kuadrit ligjor kombëtar dhe tendencës për ta harmonizuar atë gjithmonë e më tepër me instrumentet ndërkombëtare të ratifikuara, ka ende nevojë për përmirësime dhe për saktësime të cilat do t’i kushtonin më shumë rëndësi mbrojtjes së fëmijëve vajza e djem në rrezik, të cilët shfrytëzohen për qëllime prostitucioni, goditjes së trafikimit të brendshëm të fëmijëve vajza e djem, mbrojtjes së fëmijëve nga dhuna dhe ngacmimi online, etj... Në veçanti, ka nevojë që të veprohet sa më shpejt të jetë e mundur për: ndryshimin e nenit 100 të Kodit Penal, në mënyrë që ai (neni) të sigurojë mbrojtje të barabartë për djemtë dhe vajzat dhe për të hequr dallimin midis marrëdhënieve seksuale dhe homoseksuale; ndryshimin e dispozitave ligjore për prostitucionin, për të penalizuar në mënyrë të qartë blerjen e shërbimeve seksuale nga fëmijët dhe për t’u siguruar që asnjë fëmijë i shfrytëzuar në prostitucion nuk do të trajtohet si shkelës i ligjit; ndryshimin e një përkufizimi zyrtar të materialit të abuzimit seksual të fëmijëve dhe kriminalizimit të formave të tjera të shfrytëzimit seksual të fëmijëve në internet, siç janë: pastrimi në internet dhe

zhvatja seksuale; ndryshimin e Nenit 128 (b) të Kodit Penal për të penalizuar në mënyrë të qartë trafikimin e brendshëm të fëmijëve; miratimin e dispozitave specifike ligjore për të kriminalizuar shfrytëzimin seksual të fëmijëve në udhëtime dhe turizëm; përcaktimin e moshës 18 vjeç, si moshë ligjore e martesës pa ndonjë përjashtim të mundshëm, etj...

- Qeveria e Shqipërisë duhet të bëjë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të bërë të mundur zbatimin e saktë 'de-fakto' të kuadrit ligjor e të politikave, dhe për të siguruar mbrojtjen e nevojshme të vajzave dhe djemve nga dhuna dhe abuzimi.
- Ekziston një nevojë urgjente për të marrë masa dhe për të siguruar të gjitha shërbimet mbështetëse të specializuara të nevojshme, të përshtatshme e të arritshme të ndihmës për vajzat dhe djemtë e abuzuar, veçanërisht në rastin e dhunës seksuale. Këto shërbime duhet të kenë kapacitete të mjaftueshme për të mbuluar të gjithë territorin e vendit, ato duhet të kenë numrin e duhur të profesionistëve të përshtatshëm, duhet të jenë të mbështetura plotësisht me buxhetin e duhur dhe duhet të funksionojnë gjithmonë bazuar në standardet e kërkuara dhe të përshtatshme. Edhe pse donatorët dhe organizatat ndërkombëtare ose kombëtare mund të ofrojnë mbështetje në këtë drejtim, përgjegjësia kryesore mbetet mbi autoritetet shtetërore (në nivelin qendror dhe vendor).
- Bashkitë duhet të ndërmarrin masa specifike për të forcuar Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, si dhe për të themeluar Njësitë e Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NJVNR-të) në të gjitha njësitë e tyre administrative - me një numër të mjaftueshëm të punonjësve socialë, për krijimin e një mjedisi të mundshëm për identifikimin e fëmijëve të neglizhuar dhe abuzuar, si dhe për referimin e menjëhershëm të rasteve tek NJMF-të. Planet Sociale të miratuara me objektiva specifike të dedikuara për këtë qëllim, si dhe përdorimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor si një mjet për të planifikuar burimet e nevojshme, mund të jenë shumë të dobishëm.
- Strategjitë e reja Kombëtare dhe Planet e Veprimit, të cilat janë në procesin e përgatitjes (me fokus barazinë gjinore, dhunën ndaj grave, të drejtat e fëmijëve, arsimimin, shëndetësinë dhe kështu me radhë), duhet të jenë të koordinuara mirë për të siguruar integrimin e perspektivës gjinore tek të gjitha, për të shmangur mbivendosjen dhe për të siguruar parashikimin e të gjitha veprimeve të nevojshme që mund të adresojnë siç duhet çështjet e neglizhencës, abuzimit dhe dhunës së të gjitha formave.
- Strukturat e qeverisë duhet të monitorojnë rastet e abuzimit të adoleshentëve dhe të rinjve (veçanërisht abuzimin seksual) dhe neglizhencën, si dhe dëmin që ato shkaktojnë. Një monitorim i tillë mund të përbëhet nga mbledhja e rasteve të raportuara, vlerësimi i shërbimeve të ofruara nga punonjësit e mbrojtjes sociale, kryerja e studimeve periodike ose përdorimi i metodave të tjera të përshtatshme, dhe nga ndihma e mundshme e institucioneve akademike, sistemi i kujdesit shëndetësor dhe organizatat joqeveritare.
- Strukturat shtetërore duhet të garantojnë, po ashtu, edhe cilësinë dhe disponueshmërinë e shërbimit social dhe një sistemi miqësor që përgjigjet në mënyrën e duhur ndaj abuzimit dhe neglizhencës së adoleshentëve në përgjithësi.

- Të gjitha standardet e shërbimeve, protokollet e menaxhimit të rasteve dhe procedurat standarde të funksionimit për të vepruar në kuadrin e qasjes multi-disiplinore të koordinuar, përfshirë edhe protokollet e reja që janë në procesin e hartimit (të tilla si: protokollin për menaxhimin e rasteve të fëmijëve të abuzuar seksualisht) duhet të përhapen në të gjithë vendin dhe duhet të organizohen trajnime specifike për përdorimin më të mirë të tyre në punën e përditshme, veçanërisht me specialistët e rinj.
- Organizimi i fushatave kombëtare dhe lokale për të rritur ndërgjegjësimin e përgjithshëm të komunitetit dhe për të përmirësuar njohuritë mbi abuzimin seksual të adoleshentëve dhe të rinjve, për të ndryshuar qëndrimet problematike dhe sjelljen në lidhje me një abuzim të tillë, dhe për të promovuar dhe orientuar individët në iniciativat e lidhura me parandalimin, informacionin dhe shërbimet e kërkimit. Për më tepër, komunitetet dhe shoqëria në përgjithësi duhet të ndalojnë justifikimin e dhunës dhe duhet të bashkohen për tolerancën zero ndaj dhunës. Viktimat/të mbijetuarat duhet të dëgjojnë, të besohen dhe të mbështeten në çdo kohë, pa asnjë paragjykim dhe gjykim. Ata nuk janë fajtorë për dhunën që u ka ndodhur, shkelësit e ligjit duhet të marrin përgjegjësinë dhe ndëshkimin për atë që bënë.
- Zhvillimi i aktiviteteve edukuese dhe parandaluese të ofruara përmes institucioneve parashkollore, shkollore dhe mjediseve të tjera komunitare (shkolla në qendër të komunitetit) që synojnë të rrisin njohuritë e adoleshentëve për abuzimin seksual dhe të ndërtojnë aftësi praktike për të ndihmuar në forcimin e aftësive dhe strategjive të vetëmbrojtjes.
- Rritja e njohurive dhe edukimi i prindërve mbi abuzimin seksual të fëmijëve dhe ndikimet e tij, si dhe ndërtimi i aftësive për të ndihmuar në uljen e rreziqeve të abuzimit seksual të fëmijëve.
- Forcimi i kapaciteteve të të gjithë profesionistëve që ofrojnë shërbime të specializuara (punonjës socialë, oficerë policie, prokurorë, gjykatës, mjekë, psikologë, mësues) mbi mënyrën se si të trajtojnë rastet e abuzimit seksual konsiderohen shumë të rëndësishme për të përmirësuar jo vetëm performancën dhe gadishmërinë e tyre, por edhe për të forcuar bashkëpunimin midis institucioneve.
- Trajnimi i vazhdueshëm i gazetarëve mbi çështje të abuzimit të adoleshentëve dhe të rinjve, sidomos të abuzimit seksual për të rritur nivelin e ndërgjegjësimit, njohurive dhe shprehive të punës që do të çonin në një trajtim më të përgjegjshëm dhe empatik të mediave për rastet e abuzimit seksual të adoleshentëve.
- Hartimi i manualeve dhe udhëzuesve të punës për t'u ardhur në ndihmë profesionistëve nga sektorë dhe agjenci të ndryshme, për mënyrat e ndërhyrjes në rastet e abuzimit seksual të adoleshentëve.
- Përfshirja e lëndës së Edukimit Shëndetësor (në të cilën përfshihen edhe çështje të abuzimit të fëmijëve) në kurrikulën e detyrueshme për nxënësit e moshës 14-18 vjeç.
- Mësuesit dhe autoritetet e shkollës kanë një rol unik së bashku me familjen në lidhje me edukimin gjithëpërfshirës të fëmijëve. Duhet të bëhen përpjekje për të mundësuar një mënyrë efektive për të arritur dhe informuar adoleshentët mbi llojet e ndryshme të abuzimit

dhe neglizhimit së bashku me edukimin shëndetësor në lidhje me stilin e shëndetshëm të jetësës, përfshirë temat e shëndetit riprodhues. E njëjta përmbajtje informacioni duhet t'u ofrohet adoleshentëve që ndjekin shkollën dhe atyre jashtë shkollës, duke pranuar vështirësitë që kanë qasjet e bazuar në kurrikul jashtë shkollës. Ashtu siç rekomandon OBSH-ja, edukimi gjithëpërfshirës për adoleshentët duhet të plotësohet me ndërhyrje të tjera, përfshirë aktivitete që synojnë angazhimin e prindërve, mësuesve dhe aktorëve të tjerë kryesorë.

- Mësuesve shpesh u mungon trajnimi i mirë dhe mbështetja për përmbajtjen e arsimit gjithëpërfshirës, si dhe trajnimi për strategjitë që lidhen me qasjet me pjesëmarrje, lehtësuese, pozitive dhe jo-gjykuese. Prandaj, duhet të bëhen përpjekje të kombinuara për të siguruar mbështetjen e mësuesve dhe shkollave për të dhënë një arsim gjithëpërfshirës në mënyrë efektive dhe për të angazhuar prindërit dhe familjet në këtë proces.
- Adoleshentët kanë nevojë për shërbime të ndryshme shëndetësore, arsimore dhe sociale. E drejta e adoleshentëve nën moshën 18 vjeç p.sh. për shërbimet e shëndetit riprodhues përfshihet në Konventën për të Drejtat e Fëmijëve. Sidoqoftë, në shumë vende, as ofruesit e shërbimeve dhe as sistemet në të cilat ata operojnë nuk punojnë në drejtim të përmbushjes së nevojave dhe të drejtave të adoleshentëve (OBSH, 2018). Për të adresuar këtë problem të njohur gjerësisht, duhet të bëhen përpjekje për të ndërtuar kompetenca dhe empati te mësuesit, punonjësit e kujdesit shëndetësor, punonjësit socialë dhe aktorët e tjerë.
- Sikurse rekomandon OBSH-ja, trajnimi dhe mbështetja e mësuesve dhe ofruesve të shërbimeve dhe riorientimi i sistemeve në të cilat ata janë pjesë, janë themelore për të ofruar shumë ndërhyrje efektive parandaluese dhe trajtuese të cilat janë në dispozicion. Këto përpjekje duhet të shkojnë përtej qasjeve nga lart-poshtë për të përfshirë adoleshentët, prindërit, mësuesit, anëtarët e komunitetit, ofruesit e shërbimeve dhe menaxherët për të identifikuar faktorët që kontribuojnë në cilësinë e dobët dhe arritjen e këtyre shërbimeve dhe për të përcaktuar e zbatuar qasje të bazuara në prova që janë përshtatur në kontekstin lokal.
- Përfshirja domethënëse e adoleshentëve duhet të theksohet në të gjitha ndërhyrjet dhe veprimet e propozuara (OBSH, 2018).
- Komunikimi është thelbësor nëse duam të ndërtojmë marrëdhënie të shëndetshme dhe të barabarta në familje dhe shoqëri. Prindërit duhet të mësojnë të komunikojnë me njëri-tjetrin dhe ata gjithashtu duhet të mësojnë të komunikojnë me fëmijët e tyre që nga dita e parë kur lindin (idealisht ky komunikim fillon që nga dita e parë e shtatzënisë së nënës). Vajzat dhe djemtë duhet të dinë se si të komunikojnë në lidhje me nevojat e tyre, si të diskutojnë mbi shqetësimet e tyre dhe çështjet që lidhen me trupin e tyre dhe si të mbrohen në çdo fazë të zhvillimit të tyre.
- Problematikat në kujdesin shëndetësor, sektorin e ushqimit, arsimit, shërbimeve sociale dhe të mbrojtjes së fëmijëve për shkak të COVID-19-ës, kanë qenë dërrmuese për fëmijët dhe të rinjtë. Efekti i pandemisë do të ndikojë në jetën e fëmijëve në vitet në vijim. Prandaj,

mënyra se si Qeveria Shqiptare i përgjigjet tani rreziqeve të panumërta që paraqet pandemia për fëmijët dhe adoleshentët do të përcaktojë të ardhmen e tyre.

- Gjetjet nga të gjitha sondazhet ekzistuese duhet të përdoren si udhëzime për të gjitha veprimet për të organizuar fushata, për të hartuar strategji të reja dhe plane veprimi, si dhe për të krijuar shërbime të reja mbështetëse të specializuara ose për të zgjeruar ato ekzistuese.

BIBLIOGRAFIA



- Strategjia e Drejtësisë për të Mitur dhe Plani i Veprimit 2018-2021. Shiko: http://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/Strategjia-e-Drejtësisë-per-te-Mitur-PV_2018-2021_miraturar_VKM_nr.541_dt.19.9.2018.pdf
- Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2017-2020. Shiko: <http://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2017/06/Agjenda-kombetare-per-te-drejtat-e-femijeve.pdf>
- Ligj Nr. 37/2017 “Kodi i drejtësisë penale për të mitur”. Shiko: https://drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2017/11/03_Ligj_37_2017_30.03.2017_Kodi_i_Drejtësisë_Penale_per_te_Miturit.pdf
- Udhëzues: Kuvendi i Shqipërisë dhe mbrojtja e të drejtave të fëmijëve. Shiko: <https://www.parlament.al/Files/sKuvendi/Femijet/Guida-e-Parlamentareve-2016-FINALE-version-botimi.pdf>
- Ligji Nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” i ndryshuar. Shiko: <https://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20200207110616Ligji%20per%20masat%20ndaj%20dhunes%20ne%20marredheniet%20familjare.pdf>
- <https://www.ohchr.org/en/professionalinterest/pages/opscrcr.aspx>
- <https://www.coe.int/en/web/conventions/full-list/-/conventions/rms/0900001680084822>
- https://www.echr.coe.int/documents/convention_eng.pdf
- <https://www.un.org/womenwatch/daw/cedaw/text/econvention.htm>
- https://www.un.org/en/events/pastevents/pdfs/Beijing_Declaration_and_Platform_for_Action.pdf
- <https://www.unodc.org/documents/treaties/UNTOC/Publications/TOC%20Convention/TOCebook-e.pdf>
- <https://rm.coe.int/168008482e>
- <https://www.osce.org/files/f/documents/3/2/41888.pdf>
- https://www.legislationline.org/download/id/8235/file/Albania_CC_1995_am2017_en.pdf
- <http://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2017/06/Law-No-18-2017-On-the-rights-and-protection-of-the-child.pdf>
- <https://www.unicef.org/albania/media/2596/file/KODI%20-%20botimi%20dhjetor%202019.pdf>
- <http://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2017/06/Law-No-18-2017-On-the-rights-and-protection-of-the-child.pdf>
- <https://www.osce.org/files/f/documents/4/6/30436.pdf>

- <https://www.vendime.al/ligj-nr-1212016-per-sherbimet-e-kujdesit-shoqeror-ne-republiken-e-shqiperise/>
- <https://www.crca.al/sites/default/files/publications/RESOLUTION%20of%20the%20Albanian%20Parliament%20on%20Protection%20and%20Respect%20of%20Rights%20of%20the%20Child%20in%20Albania.pdf>
- <https://qbz.gov.al/eli/rezolute/2017/12/04/212-1/776876ba-c4b3-4519-b120-cf2b5dd61cf9>
- <https://www.parlament.al/News/Index/11497>
- <https://www.crca.al/en/news-national-register-sexual-crimes-against-children-albania-child-protection-violence/crcaecpat-0>
- <https://childhub.org/en/child-protection-online-library/albanian-national-agenda-childrens-rights-2017-2020>
- <https://www.unicef.org/albania/media/1496/file/National%20Justice%20for%20Children%20Strategy%20Eng.pdf>
- https://www.euro.who.int/__data/assets/pdf_file/0016/181042/e96750.pdf
- <http://www.hbsc.org/publications/>
- https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20albania/attachments/publications/2019/05/web_english_24.pdf?la=en&vs=5249
- <https://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/04/ADHS-2017-18-Complete-PDF-FINAL-ilovepdf-compressed-1.pdf>
- <https://rm.coe.int/albania-study-report-on-bullying-egn/1680732872>
- https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20eca/attachments/publications/2019/11/wave_svreport191119_web.pdf?la=en&vs=2900
- https://www2.unwomen.org/-/media/field%20office%20albania/attachments/publications/2019/05/english_web.pdf?la=en&vs=355
- Maltz, W. (2002). Treating the sexual intimacy concerns of sexual abuse survivors. *Sexual and Relationship Therapy*, 17(4), 321-327.
- Long, L.L., Burnett, J.A., & Thomas, R.V. (2006). *Sexuality counseling: An integrative approach*. Upper Saddle River, NJ: Pearson.
- Qirjako, G., Burazeri, G., Sethi, D., & Miho, V. (2013). Prevalenca e Përvojave Negative gjatë Fëmijërisë në Shqipëri (2011-2012), OBSH.
- Qirjako, G., Burazeri, Agolli, E., & Tocaj, D. (2019). Sjelljet e Shëndetshme të Fëmijëve të Moshës Shkollë (HBSC) 2017-18
- World Vision in Albania. A Study on Child Online Safety in Albania, 2014. <https://www.wvi.org/albania/publication/study-child-online-safety-albania>
- Dragoti E., Ismaili E. National Survey on Bullying and Violent Extremism In the Education System of Albania, 2017
- Burazeri G., Qirjako G., Tahsini I. Abuzimi seksual i fëmijëve brenda rrethit të besimit, 2015.

- <http://femijet.gov.al/wp-content/uploads/2016/11/Studimi-mbi-Abuzimin-Seksual-t%C3%AB-F%C3%ABmij%C3%ABve-Brenda-Rrethit-t%C3%AB-Besimit.pdf>
- Studimi Demografik dhe Shëndetësor, Shqipëri 2017-18. <http://www.ishp.gov.al/wp-content/uploads/2015/04/ADHS-2017-18-Complete-PDF-FINAL-ilovepdf-compressed-1.pdf>.
- Lalor, K. & R. McElvaney (2010). Child Sexual Abuse, Links to Later Sexual Exploitation/High-Risk Sexual Behaviour and Prevention/Treatment Programs. *Trauma, Violence and Abuse* (11), pp. 159-177.
- Humphrey, J.A. & J.W. White (2000). Women's Vulnerability to Sexual Assault from Adolescent to Young Adulthood. *Journal of Adolescent Health*, Vol. 27, No. 6, pp. 419-424
- Dunja A, Gjergji O, Gvineria D, Hallkaj E, and Verzivolli I. 2019 One Click Away: Children's Experience of Internet Use in Albania. UNICEF in Albania & IPSOS Strategic Marketing, Tirana.
- OSCE,(2019). Mirëqenia dhe Siguria e Grave,
- WAVE, (2019). Mapping of sexual violence services in the Western Balkans & Turkey
- Arqimandriti, M., Bulku, A., Lena O.2019. Dhuna në Marrëdhëniet Intime në Adolehencë. Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri (AWEN) publikime.
- <https://awenetwork.org/wp-content/uploads/2019/04/Studimi-shqip-DHUNA-N%C3%8B-MARR%C3%8BDH%C3%8BNIET-INTIME-N%C3%8B-ADOLESHENC%C3%8B-N%C3%8B-SHQIP%C3%8BRI.pdf>
- Inchley J., et al. Growing up unequal: gender and socioeconomic differences in young people's health and well-being. *Health Behaviour in School-aged Children (HBSC) study: International Report from the 2013/2014 survey.*
- Investing in children: the European Child and Adolescent Health Strategy 2015–2020. http://www.euro.who.int/__data/assets/pdf_file/0010/253729/64wd12e_InvestCAHstrategy_140440.pdf?ua=1.
- Inchley J et al. Growing up unequal: gender and socioeconomic differences in young people's health and well-being. *Health Behaviour in School-aged Children (HBSC) study: International report from the 2013/2014 survey.*
- Hallstrom L et al. Breakfast habits and factors influencing food choices at breakfast in relation to socio-demographic and family factors among European adolescents. *The HELENA study. Appetite*, 2011, 56(3):649–657.
- Biddle SJ et al. Physical activity and sedentary behaviours in youth: issues and controversies. *The Journal of the Royal Society for the Promotion of Health*, 2004, 124(1):29–33.
- Johnston LD, O'Malley PM, Miech RA, Bachman JG, Schulenberg JE. Monitoring the future. National survey results on drug use, 1975–2014:overview, key findings on adolescent drug use. Ann Arbor (MI): Institute for Social Research, The University of Michigan; 2015. <http://www.monitoringthefuture.org/pubs/monographs/mtf-overview2014.pdf> (accessed 24 August 2015).
- Engels RCME, terBogt T. Influences of risk behaviours on the quality of peer relations in adolescence. *J Youth Adolesc.* 2001;30(6):675–95.

- Boden JM, Fergusson DM. The short and long term consequences of adolescent alcohol use. In: Saunders J, Rey JM, editors. *Young people and alcohol: impact, policy, prevention and treatment*. Chichester: Wiley-Blackwell; 2011:32–46.
- Kunst A, Giskes K, Mackenbach J. Socioeconomic inequalities in smoking in the European Union. Applying an equity lens to tobacco control policies. Rotterdam: Department of Public Health, Erasmus Medical Center; 2004 (http://old.ensp.org/files/ensp_socioeconomic_inequalities_in_smoking_in_eu.pdf, accessed 24 August 2015).
- Hiscock R, Bauld L, Amos A, Fidler JA, Munafo M. Socioeconomic status and smoking: a review. *Ann NY Acad Sci.* 2012;1248:107–23.
- Preventing tobacco use among youth and young adults: a report of the Surgeon General. Rockville (MD): US Department of Health and Human Services; 2012 (<http://www.surgeongeneral.gov/library/reports/preventing-youth-tobacco-use/full-report.pdf>, accessed 24 August 2015).
- Anderson P, Baumberg B. *Alcohol in Europe. A public health perspective*. Brussels: European Commission; 2006.
- http://ec.europa.eu/health/archive/ph_determinants/life_style/alcohol/documents/alcohol_europe_en.pdf (accessed 24 August 2015).

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Abuzimi i adoleshentëve dhe të rinjve në Shqipëri: një analizë e thelluar / Genc Burazeri,
Gentiana Qirjako, Irida Agolli, Monika Kocaqi. – Tiranë : Barleti, 2020
108 f. ;20x28 cm.
Bibliogr.

ISBN 978-9928-290-69-4

1.Të drejtat e njeriut 2.Fëmijët dhe dhuna 3.Probleme sociale
4.Raporte 5.Shqipëri

316.485.2 -052.3/.5 (048.83)

342.726 .052.3/.5 (048.83)

ADOLESCENT AND YOUTH ABUSE IN ALBANIA

In-depth analysis

